

Ismail Kadare është, padyshim, shkrimtari më i madh në gjuhën shqipe dhe një nga më të mëdhenjtë, më të njohurit dhe më të talentuarit shkrimtarë europianë të gjallë. Veprat e tij të shumta janë përkthyer në më shumë se dyzet gjuhë, përfshirë edhe portugalishten.

Intervista me Ismail Kadarenë u zhvillua gjatë Panairit të 25-të të Librit të Tiranës (nga 16 deri më 20 nëntor 2022) me ndihmën dhe bashkëpunimin e çmuar të botuesit të tij

KADARE, UDHËTIM PËR NË TOKËN E LEGJENDAVE DHE MJEGULLËS

Bisedoi Joaquim Silva Rodrigues (Tiranë, 18 nëntor 2022)

<https://jornalcomunidades.pt/exclusivo-ismail-kadare-viagem-ao-pais-das-lendas-e-do-nevoeiro/>



Qershori i 75-të i Moikom Zeqos nga Enver Kushi

Kam pasur fatin të jem një nga miqtë e tij, që nga vitet studentore, kur ishim bashkë në një dhomë e deri në fund të jetës së tij, ose më saktë deri pasditen e vonë të 14 qershorit 2020, kur pasi i telefonova dhe pyeta si e ndjente veten dhe se do të bëhej më mirë, dëgjova fjalët e tij. Më dukej sikur fliste nga thellësi botërash mistike, ose ndoshta nga hapësira qiellore. (fq. 6)

SHËNIME MBI LIBRAT

Libri i Drita Çomos "Dritë që vjen nga Humnera", Onufri

GJURMË DRITE MBI TERR Nga Yzedin Hima

(fq. 7)

Romani "Shtrati 13" i Petrit Palushit, Ombra GVG, 2016

DASHURI NË SHTRATIN E VDEKJES

Nga Shqiponja Axhami

(fq. 9)

Donika Dabishevi, "E gjithkohshmja Andërr", Littera

NJË METAFORË NË MES JETËS DHE VDEKJES

Nga Maxhun Osmanaj

(fq. 8)

ART HOUSE

Organizon:

EKRANI I ARTIT

Solitude and Multitude

EDICIONI I VII-të

5-9 QERSHOR, 2024

Ekrani i Artit vjen në edicionin e tij të shtatë. Nga data 5 deri më 9 qershor, Shkodra do të mirëpresë vepra të video artit, filmit të shkurtër e të gjatë, dokumentar e fiksjon, punime nga artistë vendas dhe ndërkombëtarë. (fq. 19)



Shqyrtime studimore për romanin
"Lindur së prapthi" të autores Rita Petro

FERRI DHE PARAJSA JANË NË KËTË JETË


nga Behar Gjoka

Pra, në hapësirën e romanit "Lindur së prapthi", janë përfshirë pesëdhjetë e pesë vargje gjithsej, porse paritetin e ka narrativa, figurimi i kohës dhe personazheve, duke sendërtuar një tekst që të grish për ta lexuar, sepse përveç kohës, gjen një pjesë të vetes, qenia njerëzore, e gjendur në rrethakun e dykohësisë. (fq. 4)

Në qershor të vitit 1924, Man Ray realizoi *Violina e Ingresit*, një nga krijimet më të shquara në historinë e fotografisë (fq. 20)

GËZUAR DITËLINDJEN, INGRES

Nga Xhyher Cani PhD



PSE KUNDERA NUK U KTHYE KURRË NË ATDHE

Nga Petr Drulák

ish-zëvendësiministër i Jashtëm i Republikës Çeke
dhe ambasador në Francë

Përktheu Granit Zela

(fq. 22)



BIBLIOTEKË

Bashkim Hoxha (fq. 10)

Shtëpia e verdhë

Shpëtim Selmani (fq. 12)

Kureshtje dhe terror

Xhelal Tosku (fq. 14)

O gjemb, pse ti në trëndafil

Aleko Likaj (fq. 15)

Ariu i vogël

Xheni Shehaj (fq. 16)

Mallkimi i Malit të Harresës

Artur Spanjoli (fq. 17)

Shtegtim nga e ardhmja

Gazmend Bërlajolli (fq. 18)

Cikje shpirtnash

Arben Meksi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Botim i ri nga Minerva

R. W. EMERSON

Vetëbesimi

(fq. 15)

Robert Elsie - in memoriam

MADHËSHTIA E NJË VARRI NË THETH

Nga Enver S. Morina

(fq. 21)

Ismail Kadare është, padyshim, shkrimtari më i madh në gjuhën shqipe dhe një nga më të mëdhenjtë, më të njohurit dhe më të talentuarit shkrimtarë europianë të gjallë. Veprat e tij të shumta janë përkthyer në më shumë se dyzet gjuhë, përfshirë edhe portugalishten.

Intervista me Ismail Kadarenë u zhvillua gjatë Panairit të 25-të të Librit të Tiranës (nga 16 deri më 20 nëntor 2022) me ndihmën dhe bashkëpunimin e çmuar të Bujar Hudhrit, themelues dhe drejtor i "Onufri", botuesi ekskluziv i veprave të Ismail Kadare.

Në atë kohë, kisha përfunduar përkthimin në frëngjisht të librit të Saramago-s, "Udhëtimi në Portugali", që Fondacioni José Saramago kishte dëshiruar t'ia dhuronte me një dedikim të veçantë Kadaresë. Talentit i shkrimtarit shqiptar gjithmonë është vlerësuar nga Pilar del Rio dhe vetë Saramago arriti të propozojë emrin e tij për Çmimin Nobel të Letërsisë. Mesazhi personal i Pilar del Rio i transmetuar me gojë për Kadare e emocionoi atë dhe të dyja këto gjeste ishin "thyerësi më i mirë i akullit" për një bisedë me një personazh të konsideruar enigmatik dhe disi të padepërtueshëm.


Pasi u futëm në hapësirën e tij personale — që në të vërtetë, është disi misterioze dhe legjendare, si shkrimi i tij — kuptuam ndrojtjen e tij, seriozitetin dhe disa hezitime të dukshme. Është, në fund të fundit, një profil i ndërtuar gjatë gati shtatëdhjetë viteve të jetës letrare me shkrime nën forma të ndryshme — gazetari, poezi, ese, roman — por me një kërkesë të vazhdueshme: militant pa qenë propagandues, ndërhyrës pa u shteruar në luftën politike, shkatërrues dhe inteligjent në dekonstruksionimin e një regjimi të ashpër dhe diktatorial.

I lindur në Gjirokastrë, në jug të

ISMAIL KADARE, UDHËTIM PËR NË TOKËN E LEGJENDAVE DHE MJEGULLËS

Bisedoi Joaquim Silva Rodrigues,
ish-fotografi personal i nobelistit Hose Saramago

Përktheu Andreas Dushi



Shqipërisë, në 1936, Ismail Kadare është gjithashtu bashkëqytetar i Enver Hoxhës (1908-1985), udhëheqës dhe diktator shqiptar. Si për ironi, edhe vepra e tij bashkëjeton me atë që mund të mendohet si arsyeja e vetë pamundësisë së saj, regjimi diktatorial komunist shqiptar.

Në fakt, Kadare qëndroi shumicën e jetës së tij, si dhe të karrierës së tij si shkrimtar, në syrin e stuhisë staliniste të diktatorit Enver Hoxha, duke u larguar vetëm në fund të asaj periudhe diktature, kur ndjeu se jeta e tij dhe e familjarëve të tij ishte në rrezik të madh. Gjatë asaj kohe, ai mishëroi dhe ilustroi rolin më të lartë të shkrimtarit, me të shkruarën si arma e vetme, duke ndërhyrë në historinë e vendit të tij, të popullit të tij dhe të njerëzimit, për t'u dëgjuar nën peshën e shtypjes. Ajo që në fillim ishte vetëm një mërmërim, u shndërrua në

një zë të qartë dhe të dalluar — për të përfunduar në një thirrje për çlirim.

Ismail Kadare beson se letërsia, në duart e shkrimtarit, është një armë shumë më e fuqishme sesa ajo që zotëron diktatori. Vepra e shkrimtarit është e përhershme, e përdetshme; arma e diktatorit vdes me të.

Ismail Kadare është njeri me pak fjalë. Siç pranoi gjatë bisedës sonë, vepra e tij është bërë nga shumë fjalë dhe e ka lënë atë me pak të tilla. Si të ishte misioni i tij, detyra ndaj jetës dhe historisë së kohës së tij, të popullit të tij, të vendit të tij, u përmbush dhe ai u shkrua në histori. Në thelb, në historinë tonë.

Gjatë bisedës u përmendën disa tema kryesore: legjendat e Ballkanit dhe Shqipërisë, mjegulla që rëndoi mbi popullin dhe mbi territorin shqiptar gjatë periudhës së diktaturës dhe talenti

(ose "arti", sipas Kadaresë) i shkrimtarit për të kapërcyer dramën ose dilemën e fillimit të një romani të ri.

Ismail Kadare iu përgjigj gjithçkaje, pa u shmangur nga asnjë pyetje, edhe pse vetëm me fjali të shkurtra.

Në fillim të një prej librave të tij "La légende des légendes" (Flammarion, 1995), Kadare shkruan: "Në fillim të viteve '70, gjatë një pritjeje në Paris, ambasadori i Shqipërisë komuniste pati një takim të shkurtër me Miguel Asturias, në atë kohë ambasador i Guatemalës në Francë. Në fillim, biseda mund të dukej krejt formale, veçanërisht duke marrë parasysh që dy vendet e vogla nuk kishin dhe nuk mendonin të kishin ndonjë lloj marrëdhënieje, përfshirë marrëdhëniet diplomatike. Miguel Asturias, ambasador, por edhe shkrimtar i njohur dhe fitues i Çmimit Nobel të Letërsisë (1967) sigurisht që i dukeshin



Joaquim Silva Rodrigues Ai solli dhuratë dy libra të nobelistit, nënshkruar nga e veja e Saramagos, Pilar del Rio e cila, gjithashtu, e kishte autorizuar që t'i përcillte Kadaresë një sekret të nobelistit: Saramago kishte propozuar Kadarenë për çmimin Nobel!

Bar Juvenilja, Tiranë. 18 nëntor 2022

Një takim i veçantë sot në Juvenilja, midis Kadaresë dhe portugezit Joaquim Silva Rodrigues, ish fotografit personal të nobelistit José Saramago. Qëllimi i vizitës së z. Rodrigues ishte një intervistë për procesin krijues të shkrimtarit tonë. Ai solli dhuratë dy libra të nobelistit, nënshkruar nga e veja e Saramagos, Pilar del Rio e cila, gjithashtu, e kishte autorizuar që t'i përcillte Kadaresë një sekret të nobelistit: Saramago kishte propozuar Kadarenë për çmimin Nobel!

Ndërkohë z. Rodrigues na rrëfeu se si kishte lindur një nga kryeveprat e tij nobelistit:

Një ditë Saramago ishte indinjuar sepse në restorantin ku ai shkonte përherë, kamerierët shkonin e vinin, por jo në tavolinën e tij. Mos ndoshta jam bërë transparent dhe nuk më shohin kamerierët, mendoi shkrimtari. Apo ishin të gjithë të verbër? Kështu lindi romani „Verbëri“ (botuar në shqip nga Dudaj)

Nga facebook i Bujar Hudhrit
Tiranë, 18 nëntor 2022


të mërzitshme ato lloj takimesh dhe prandaj pyeti ambasadorin shqiptar: "Ah, Shqipëria, kam dëgjuar për vendin tuaj. Kam kureshtjen të di nëse në vendin tuaj ka shumë mjegull. Dhe nuk jua bëj këtë pyetje rastësisht. Sepse, nëse ka mjegull, duhet të ketë edhe shumë legjenda". Miguel Asturias vdiq pak kohë më vonë, duke mos i dhënë mundësinë Ismail Kadaresë, gjatë një prej udhëtimeve të tij në Francë, të thellonte dhe eksploronte kuptimin e këtij shkëmbimi të shkurtër fjalësh.

Ismail Kadare konfirmon që Shqipëria dhe Ballkani gjithmonë kanë jetuar brenda kësaj mjegulle të legjendave. Dhe vazhdojnë të jetojnë. Sepse nga legjendat, gjithmonë del e vërteta dhe kjo është unike dhe e pavdekshme, beson shkrimtari. Megjithatë, kjo analizë nuk mund të ketë ose nuk duhet të ketë një efekt reduktues: vepra e shkrimtarit shkon shumë përtej kësaj. Ismail Kadare, përmes më shumë se 50 romaneve dhe eseve, tregon se si ka qenë dhe është e mundur të romanizohet pa hyrë domosdoshmërisht në realmin e trillimeve, duke i dhënë fakteve rëndësinë dhe kuptimin që vetëm faktet kanë në pasqyrimin e realitetit të Ballkanit dhe Shqipërisë.

Në këtë pikë, lind një pyetje: pse shkrimtari nuk kërkoi azil, zgjedhje e bërë nga pjesa më e madhe e disidentëve, veçanërisht atyre që vinin nga vendet socialiste në shekullin XX? Ky aspekt mund të na çojë në tundimin për ta parë Ismail Kadarenë si "shkrimtar të regjimit", bashkëpunues, komplotues, ndërkohë që ky profil i ka sjellë lehtësi. Por, Kadare e shpjegoi qartë zgjedhjen e tij, gjithashtu e mbështetur nga Helena Kadare, gruaja e tij, në një moment tjetër të bisedave tona gjatë Panairit të 25-të të Librit të Tiranës. Azili i shkrimtarit, për shkak të papajtueshmërisë me regjimin e Enver Hoxhës dhe për pamundësinë për të vazhduar detyrën e tij si shkrimtar "engagé", do të ishte gjithmonë një zgjidhje e lehtë, megjithëse do të vendoste në një situatë jashtëzakonisht kritike dhe madje të rrezikshme anëtarët e familjes së tij që do të mbeteshin përgjithmonë të etiketuar si "armiq dhe tradhtarë të popullit shqiptar". Sipas Helena Kadaresë, do të ishte t'i ofroje një martir diktatorit, gjë që kurrë nuk ishte as në objektivat e shkrimtarit dhe as të familjes.

Kështu, duhej gjetur një "modus vivendi" që të lejonte të shkruaje për të dekonstruktuar regjimin, për të lënë për të ardhmen dëshmi se çfarë do të thoshte të jetoje nën zgjedhjen e diktatorit dhe të regjimit të tij. Ismail Kadare kishte burime të pashtershme – siç theksoi vazhdimisht gjatë bisedës sonë – për të përcjellë mendimet dhe energjinë e tij luftarake: legjendat ballkanike dhe historia e rajonit dhe vendit ku është ankoruar prania, shtrirja kohore dhe gjeografike e Perandorisë Osmane.

Pikërisht në këto dy burime shkrimtari "kamufilon" vizionin e tij për gjërat. Nëse legjendat shërbejnë për të justifikuar veprimet dhe faktet që, në përgjithësi, përbëjnë strukturën e romaneve të tij (disa prej tyre me prekje të romaneve autentike policore), Perandoria Osmane shërbeu në mënyrë të përsosur për të përshkruar (si kopje



karboni) regjimin e Enver Hoxhës si të ishte regjimi i Sulltanit osman. Kështu, korniza kohore e narrativës ndaloi së qeni e rëndësishme, pasi ajo që vërtet kishte rëndësi për Ismail Kadarenë ishte të denonconte regjimin stalinist të Enver Hoxhës nga brenda, në veprimin e tij real, të vërtetë, gati të përditshëm, e konkret.

Ismail Kadare është ndërgjegjja e asaj që përfaqëson letërsa dhe të shkruarit për popujt. Në këtë rol ai u ngjit në shkallën më të lartë, duke shpërbërë pasionet dhe kundërshtimet, veçanërisht ato me rrënjë etnike, shoviniste që, sipas shkrimtarit, nuk korrespondojnë - ose nuk duhet të korrespondojnë, shton ai - me mentalitetin e burrave dhe grave të epokës sonë. Përballë konflikteve të kohës së tij, Kadare shpreson që popujt që hedhin hapin e parë drejt të tjerëve, në kërkim të paqes dhe zgjidhjes së konflikteve, do të përfundojnë duke u ngjitur në një shkallë më të lartë. Kështu ishte rasti i konfliktit të Kosovës; kështu është në mosmarrëveshjet mes njerëzve në përgjithësi.

"Arti" i Kadaresë përdor metafora dhe figura të stilit letrar, merr nga historitë dhe legjendat e Ballkanit. Por, më e rëndësishmja, ai e bën këtë me mjeshtëri dhe talent që e dallon nga shkrimtarët e romaneve historike.

Megjithatë, ishte e nevojshme të sigurohej ushtrimi letrar i gjatë prej më shumë se gjashtëdhjetë vjetësh dhe të krijoheshin kushte për të publikuar

një vepër që, pavarësisht artificave të ndryshme të dekonstruksionit, nuk shpëtonte nga kthetrat e censurës. E gjithë vepra e Ismail Kadare iu nënshtrua censurës në Shqipëri.

Me kontakte jashtë vendit, ishte e nevojshme të arrinte në një "port të sigurt" ajo që po prodhohej. Origjinalet ishin në rrezik dhe t'i mbanin në shtëpi ishte, siç rrëfeu gruaja e tij, Helena Kadare, si të kishe një bombë me sahat. Ishte urgjent dërgimi i shkrimeve jashtë vendit. Kështu filloi veprimtaria e "kontrabandës". Miqtë e Kadare (kryesisht francezë), që e vizitonin rregullisht, sillnin në Francë, në fund të bagazhit të tyre, origjinalet e daktilografuara nga Helena (Ismaili vetëm diktonte ose shkruante me dorë). U vendos, në një moment të caktuar, që origjinalet e kontrabanduara përmes kësaj rruge të depozitoheshin në një kasafortë që vetëm një nga miqtë (nga botuesi Fayard, Paris), i identifikuar në aktin noterial, mund të hapte në rast se ndodhte "diçka e papritur dhe jonormale" ndaj shkrimtarit. Kështu filloi të grumbullohej vepra letrare e Ismail Kadaresë jashtë Shqipërisë, pa përjashtuar formula të tjera gjithashtu të shpejta, por me më pak përdorim, si për shembull, t'i atribuonte disa prej shkrimeve të tij autorëve të tjerë të famshëm.

Me përkthime në më shumë se dyzet vende, vepra e Ismail Kadaresë është e njohur, duke marrë disa çmime: Çmimi Botëror Cino del Duca (1992),

Man Booker International Prize (2005), Çmimi Príncipe de Asturias (2009) dhe Çmimi Jerusalemi (2015). Ismail Kadare vazhdon të jetë një kandidat i vazhdueshëm për Çmimin Nobel të Letërsisë, i nominuar disa herë (i propozuar nga José Saramago, siç është përmendur). Ai është anëtar i asociuar i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike të Francës, duke marrë në maj të 2016, nga Presidenti francez François Hollande, Komandën e Legjionit të Nderit.

I pyetur për faktin se ende nuk ka marrë Çmimin Nobel të Letërsisë, Ismail Kadare thotë se nuk ndihet i zhgënjyer. Ai e di që fakti se media flet shumë për të bën që shumë lexues të mendojnë se ai tashmë e ka marrë Çmimin. Ai është i vetëdijshëm që është pjesë e "familjes së të propozuarve" dhe kjo është shumë e rëndësishme. Do të ishte e vogël nga ana e tij, mendon Ismail Kadare, të mbante inat për mosmarrjen e Çmimit Nobel. Sidoqoftë, shtoi Helena Kadare në bisedën tonë anësore gjatë Panairit të Librit, çdo vit, në ditën e vendimit të Komitetit Nobel, në orën 13:00 të saktë, kur Ismail është në vendin e tij të zakonshëm për kafën e mëngjesit, restorantin Juvenilja, në Tiranë (ku zhvilluam bisedën tonë), i gjithë shtypi shqiptar mbledhet pranë Kadaresë për të zbuluar nëse është ajo hera kur do të festojnë ngjarjen më të madhe të letërsisë shqiptare.

Ismail Kadare nuk e konsideron veten shkrimtar të romaneve historike.

Megjithëse Ismail Kadare lejon të udhëzohet dhe inspirohet nga mitet dhe faktet historike, pothuajse të gjithë romanet e tij marrin një dimension politik.

Këtu duhet theksuar roli që luan në veprën e tij konceptet që ai mbledh nga tradita, veçanërisht gjakmarrja dhe besa - parimet e nderit dhe moralit të përfshira në kodin zakonor të Kanunit që rregullon periudhën e armëpushimit midis akteve të gjakmarrjes. Duke iu referuar këtyre koncepteve dhe legjendave me origjinë më të errët dhe më të largët, Ismail Kadare është investuar si udhëheqës i një etape të re të rilindjes shqiptare, ballkanike dhe europiane.

Studiues i Eskilit - babai i tragjedisë greke - por edhe i Shekspir, Kadare eksploron të gjitha aspektet themelore dhe esenciale të besës që i jep ligjit të gjakut dhe detyrës së gjakmarrjes një rregullore të hollësishme që ngjan me zhvillimin e tragjedisë së lashtë. Ky është studimi që Kadare zhvillon në mënyrë të apasionuar, por rigoroz, në esenë "Eschyle ou le grand perdant" (ed. Fayard, 1985).

Romane nga vitet shtatëdhjetë deri në vitet nëntëdhjetë - si "Gjenerali i Ushtrisë së Vdekur", "Kështjella", "Prilli i Thyer", "Pallati i Endrrave", "Piramida", "Aksidenti", "Lulet e Ftohta të Marsit", "Tri këngë zi për Kosovën", "Ra ky mort e u pamë", "Koncerti", "Ura me Tri Harqe", "Legjenda e Legjendave", "Dimri i Madh" janë vetëm disa nga kryeveprat e veprës shumë më të gjerë dhe plot substancë, histori, dekonstruksion idesh të imponuara, dekonstruksion sistemesh dhe regjimesh. Janë, përmbledhur sipas vetë fjalëve të Ismail Kadare, "arti si arma më e fuqishme e shkrimtarit".

Ndjesia që mbetet në mendje kur mbaron së lexuari romanin “Lindur së prapthi”, të parin tekst në prozën e gjatë të autores Rita Petro, poetes kontraverse, botuese së njohur dhe kualitative, është se qenia njerëzore, nuk merr asgjë në amshim. Kalimi në lëvrimin e romanit, shënon një cak tjetër të lidhjes së ngushtë me letërsinë, e prandaj kërkon një vëmendje të shtuar për të rrokur qasjen romanore. Kuptohet që kalimi në lëvrimin e romanit, pasi ka gjezdisur në poezi me disa libra, me jo pak shkëlqim në shkrimin e lirikës erotike, e cila ndërkaq ka zgjuar debate letrare dhe jashtëletrare, gjë që ka thëlluar “betejën” autoriale me letërsinë. Romani, në letërsinë e sotme shqipe, pamëdyshje që është njëri nga llojet letrar me të parapëlqyer, njëherit mbetet një zhanër i hapur. Varësisht botimeve, pas viteve '90, romani, formësohet në larmi formash dhe shprehësie, ndërkaq romani e mbizotëron ligjërimin letrar të shqipes. Nivelet e formësimit të zhanrit, edhe pse janë shfaqur antiromani apo postromani, ende vijojnë të jenë të pashterrura, pra gjithsesi vijon të mbetet një zhanër i hapur. Teoritë mbi romanin, si zhanër i hapur, theksojnë: “Vetëm në roman dhe në disa forma të tjera epike të afërta me të ndodh kujtimi krijues, i cili e qëllon dhe transformon lëndën...”[1], si një ndër aspektet thelbësore, të lavrimit të prozës së gjatë. Teksti i romanit “Lindur së prapthi”, shpërfaqet disi ndryshe nga romanet e botuara, në kuptimin që kërkon rrugën e lëvrimin autorial. Shënimet e shpërfaqura kanë të bëjnë me qenien, me universin ekzistencial, i cili rreket në mes heshtjes dhe ligjërimin, për të ndarë me të tjerët, sidomos me lexuesin, me gjasë për të zbuluar dritëhijet e qenies. Romani, është thirrje për jetën, për dashurinë, sepse pikërisht në këtë jetë, është ferri dhe paraajsa, e në amshim nuk marrim me vete asgjë. Letërsia dhe shpirti, shtegtojnë pandalshëm për te qenie njerëzore, gjer në pambarim.

DYKOHËSIA E REALITETIT LETRAR

Parashtrimi subjektiv, pra shikimi i botës me sytë e vetë, nuk ka penguar, madje derdhur në qerthullin e personalizimit të skajmë, vijnë e konturohen në hijedritat e veta, të dy kohët:

Së pari: E djeshmja, jo fort e largët, por që ende na ngatërrohet nëpër këmbë e nër tru, shpesh herë gjer në makth shkatërrimtar, e cila vjen me detaje të imtësuar, por edhe me ngjyime nëntekstuale. Në frazën: “Nuk mund të kishim në shtëpi vezë sa të duam. As djathë. As mish.”(2022: 13), ku mungesat sjellin imazhin e së djeshmes, kredhur në mjerim. Sfondi tjetërsues, i kohës moniste shpërfaqet edhe në dialogun e personazheve: “I paskan internuar... ai që ka gruan bullgare?”(2022: 23), si një gjurmë e privimit të lirive të njeriut. Ka edhe situata të tjera, që e sjellin të djeshmen, si nënkuptim: “... çimkat brenda nëpër tuba...”(2022: 61). Për të ardhur deri të eufemizmi e pazakontë: “... shoh Udhëheqësin e Madh.”(2022: 77), në vend të emërtimit të përdorur gjerësisht, diktatori Hoxha, ku përcaktimi “Udhëheqësi i Madh”, përdoret nga G. Oruell, në romanin 1984.

Së dyti: E tanishmja, e cila konturohet në marrëdhënie të ndërsjellë, me të kaluarën e djeshme, duke e vendosur qenien në një zgrip ekzistencial. Koha e tanishme, aktualiteti ku jetojmë, përçohet përmes detajesh, që e bëjnë të prekshme si gjendje letrare. Tanishmëria, si kohë konkrete, përgjithësisht shpërfaqet me shenja dhe elementë realë. E folmja e brendshme, e autores-narratore: “Të kaloj kontrollin e sigurisë dhe atë të pasaportës dhe do të jemi rehat pastaj”, - po i thosha vetes.”(2022: 20), të fusin në klimën e kohës aktuale. Situata e kohës së tanishme, shpallet edhe në komunikimin përmes mesazheve: “Faleminderit, zemër, për mesazhin.

Shqyrtime studimore për romanin “Lindur së prapthi” të autores Rita Petro, botim i shtëpisë botuese “Onufri”

FERRI DHE PARAJSA JANË NË KËTË JETË

nga Behar Gjoka

Prindërit më paskan marrë në Shtëpinë e Fëmijës. (2022: 33), e cila paraqet një formë të re komunikimi. Po ashtu pohimi: “Të gjitha shtëpitë e rrugicës janë shembur e janë ndërtaur pallatet!”(2022: 40), që sjellë për lexuesin pasazhin e transformuar të qyteteve, sidomos të Tiranës, së kthyer në kantier ndërtimi, ku lartësohen kulla pafundësisht. Në faqet e romanit kemi edhe përcjelljen e kronikës së zezë: “...për një vajzë të mitur...që e goditi skafi i një polici të luante në breg të detit!”(2022: 53), duke ofruar një fakt tronditës të viteve të fundit. Ndryshimet që kanë ndodhur me qenien, në këtë periudhë, vijnë edhe në frazën: “Shkruhem herë pas herë, i bëjmë like dhe zemra njëra-tjetrës.”(2022: 67), si tregues zhvillimi, por edhe si një dëshmi e automatizimit të qenies. Pa harruar marrëdhënien komplekse me rrafshet e leximit: “Entuziazmi ideologjik nuk prodhon as shkrimtarë e as lexues të mirë-përkundrazi, shkakton keqformimin e tyre...”[2], si një sinjal e bjerres së letrares, jo fort rrallë në ndërkohë.

Dykohësia, e djeshmja dhe e sotmja,

vendosur enkas në marrëdhënie të ndërsjellë, është sfondi dinamik ku luhen ngjarjet, përzihen hapësirat dhe ku shpërfaqen personazhet, veçmas të tjerëve, protagonistja e romanit, që është narrator dhe epiqendër e realitetit letrar.

ROMAN REALIST DHE POSTMODERN

Nga fryma tërësore e ngjarjeve, episodeve të pranishëm në hapësirën tekstologjike të romanit “Lindur së prapthi”, në thelbin sendërtues, është realist. Madje, duhet theksuar, nuk ka lidhje me realizmat, që kanë shëtitur në letrat shqipe, më tepër jemi në kahjet e një neorealizmi, që domosdoshmërisht lidhet me rrethanat e reja, të ekzistencës së qenies sonë, si individ apo komunitet. Tiparet e realizmit, të kapërthimit të botës romanore, shpërfaqen si shenjë artistike, në figurimin e të dyja kohëve, të cilat janë fokusuar në hapësirën e këtij teksti. Në projektimin e së djeshmes, që shpallet edhe në një shprehje tjetër, në dukje rastësore: “Me atë mund ta kishe mirë, vetëm po ta pyesje për koleksionin e pullave.



“(2022: 71), një rrymim konkret, e cila shkonte dikur, gjer në mani, e të dikurshmes, ku koleksionimi i pullave, ishte një garë për t’u identifikuar, si prani ekzistencial. Fryma realiste, mbizotëron edhe në kohën e tanishme, siç ngjet në pasazhin: “Në gazeta lexova se në këtë gjendje, ku kishin mbetur të vdekur dy persona, ishte dhe djali i një ministreje. Ai ishte plagosur. Nuk ishte hera e parë që djali i ministres përmendej në media si kriminel.”(2022: 165), që sjellë atmosferën e të tanishmes, e kohës aktuale, në të cilën jetojmë. Në të dyja kohët, e djeshmja, që ende na sillet nëpër këmbë, edhe në këto ditë, me të tanishmen, jo më pak të rrëmujshme, shpalosen përmes kamerës realiste, të vërtetave konkrete. Ndërkaq, krahas frymës realiste, sidomos në plasimin e të djeshmes, në faqet e librit kemi të shqiptuar edhe një nuancë tjetër, sjelljen e të djeshmes, ndonëse me doza tallje dhe ironie. Kjo prani e shtrirë në të gjithë hapësirën, ku figurohet e djeshmja, vetvetiu shpërndërrohet në një tipar esencial. Vështrimi i të kaluarës, me sy tallës dhe përqeshës, vetiu të sjellë ndërmend idenë e U. Eco-s, mbi “ironinë interetskultuale”, që këtë tekst, e shpërndërron në një roman me gjurmë postmoderne. Distanca kohore, me të djeshmen, e sidomos përjetimi i asaj kohe, në kontekste të reja, së paku të një lirie të shpallur, ka mundësuar thurjen e një proze edhe me tone postmoderne, në thelbin dhe ngjyresat kumtuese. Gjurmë të shenjave postmoderne, ndeshen jo pak në libër, si në rastin: “Dhe, në atë hapësirë aq të vogël, babi ngjante si gjigand...”(2022:10), kemi të pohuar, si nëntekst mbijetesën shqiptare, me shtëpitë si kutiçka, një botë absurde që shihet në sytë e narratoreve fëmijë. Ka edhe momente, kur e vërteta jetësore, thuhet pa doreza, si në shprehjen: “Ata, kishin dhe televizor, ndryshe nga familjet e tjera që kishin vetëm radio.”(2022: 27). Në një rrezatim tjetër, vjen mbyllja e një episodi: “Të nesërmen ishte e diel dhe gjithë ditën përkundëm kukullat binjake që lindën ngaqë fjetëm bashkë natën e kaluar.”(2022: 38), ku rimerret tema tabu, e heshtur gjer në marrëzi, për mënyrën se si lindin fëmijët, në kohën e moskurrit. Nënteksti, si prani e ngjyresave postmoderne, e përtalljes së kohës tjetër, zbulohet në frazën: “... drejt daljes së rrugicës duke vështruar majën e kishës që ishte bërë kino.”(2022: 58), si tregues i marrëzisë allashqiptarçe, zhytur në makabritetin e shkatërrimit të kishave e xhamive. Propaganda e kohës, kishte shkuar deri në sajime të mbrapshta, që sillet si klimë e plotë në pohimin: “- Po, na kanë thënë. Po pse priftërinjtë mbanin në libër një revolver?”(2022: 79), që skicon pafytyrësinë dhe hipokrizinë e së kaluarës. Po kaq, në pohimin: “Mësova shumë parulla përmendësh, ndonëse nuk ua dija kuptimin.”, si një fakt i trushplarjes ideologjike. Emërtimi i diktatorit, me një formë që edhe e kujton edhe e largon, me përcaktimin “Udhëheqësi i Madh”, diku përfundon në tallje”UDHËHEQËSI I SHQYER”, vetëm sa e përforcon ngjyrën e ligjërimin postmodern, në faqet e këtij romani.



NARRATIVA E DYFISHTË

Ekzistenca e prozës, edhe zhanrit të romanit, varet nga narrativa, pentagrami rrëfimor, si dhe nga tipologjia e narratorit. Bashkëlidhja e materies së rrëfyer, me pozicionin e narratorit, mishëron atë që T. Todorov, më herët e pati përcaktuar si poetika e prozës. Në rastin e romanit "Lindur së prapthi", jemi në ngjizje autoriale, të tipologjisë së dyfishtë. Narrativa e dyfishtë në pikëpamje të shkrimit, pra të mishërimit estetik, sendërtohet si materie:

E para: Shtjellimi i ndodhive, episodeve, i mjedisve të ndryshme, figurimi i personazheve kryesorë dhe rastësorë, pashmangshëm ndërvarët nga dykohësia, e djeshme dhe e sotme, që shpesh ndërthuren dhe kacavaren në njëra – tjetrën, sa për një çast faniten gati të njëjta. Vetëdija e atmosferës narrative, vetiu e bën diferencën, me gjasë ndryshimin ndërmjet tyre konteksteve. Rruga me tre shetitore (Rruga e Kavajës), dy anash dhe një në mes, pavarësisht llojit të luleve apo pemëve, është po ajo sepse është ngurtësuar në kujtesë si e tillë, ku madje kisha dikur ishte kthyer në kinema, e në këtë kohë, sërish në kishë, për të ardhur të pohimi befasues: "Jemi të bekuar se e kemi shtëpinë mes Kishës Ortodokse, Kishës Katolike dhe Xhamisë..." (2022: 75), ku qartësisht skicohet larmia e vlerave shpirtërore të besimit, si harmoni e besimit, si dhe një tregues i bashkëjetesës fetare, të epiqendrës së romanit.

E dyta: Pozicioni i narratorit/narratores si shenjë e formësimit estetik të prozës. Teksti i këtij romani, ka si tip ligjërimi, narrator autoriale, që e bën të rrokshme klimën autoriale, subjektive, me një çlirësi befasuese, aq sa rrëfimi mbetet pezull, si të jetë vjerrë në qiellin e harrimit dhe mbijetesës. Autorja-rrëfimtare, që përveç ngjyrsën personale, formëson zërin e kohës, me gjasë të dy kohëve, ku dëshmimi dhe përjetimet, janë projektuar në ekulibër të pazakontë. Rrëfimtaria-autore, megjithatë shpërfaqet si narratore e dyfishtë:

A – Rrëfimtare e të djeshmes, ku realiteti përthyeret në ëndrrat dhe zhgjedhërrat e narratores femijë, si dhe bart, bëmat dhe çmenduritë e adoleshencës, kohë e artë e ëndrrave të çmendura, të asaj që francezët e shpallin *c'est la vie, c'est l'amour*. Narrativa autoriale, e një distance kohore, shpalolet gati e ngrirë në kujtesë, për ta nginjur materien e tekstit me jetë, me sharmin e botës feminare dhe të moshës së adoleshencës. Narratorja e librit "Lindur së prapthi", sjellë pranë lexuesit një realitet të shumëngjyrtë. Vështrimi me sytë e femijës së dikurshme, shpalolet qysh në epilog: "Kështu unë fillova të ecja me duar dhe kokëposhtë... Sa i bukur, i madh dhe i paanë ishte qielli për mua." (2022: 7), që lajmëton pafajsinë dhe këndshikimin mbi botën përqark. Në këtë vazhde vijon situata edhe në frazën e narratores, kur thotë: "Çfarë më lejohej të bëja dhe çfarë e kisha të ndaluar të bëja." (2022: 11), si një sfond i kohës së frenimit të lirive të njeriut. Mjafton fraza: "Unë do të mbaja çelësin në qafë...", për të kuptuar se kemi të bëjmë me një femijë që tregon ngjarjet, situatat absurde të jetës së ndryme në kafaz. Rrëfimi i narratores – femijë, sjellë klimën e ndëshkimeve, dënimeve, sikur ngjet në situatën: "pra, Milin unë nuk do ta shihja më kurrë prapa atyre harqeve prej hekuri të lakuara..." (2022: 24). Megjithatë, ka raste që autorja-narratore, del nga zhgualli i femijës, sikur ngjet në këtë shprehje: "Në shkollë na kishin mësuar se është shumë turp të lypësh." (2022: 30), e kjo nuk zbeh praninë e botës feminare, me ëndrra e trazime të pafund, gjë që përforcohet nga pohimi: "Unë dhe Ariana e kishin zakon të luanim shpiash!", një lodrim i përjetshëm i femijëve. Koha e vrazhdë i zgjon ëndrrash dhe femijët, ku mjafton të sjellësh në mend ligjërimin e narratores: "Fjala përgjim erdhi në veshin tim pikërisht



kur ende po vuaja ikjen e shokut tim të dashur..." (2022: 60), ku skicohet absurdi i monizmit, sepse përgjimi ishte rregull dhe normë morale. Në dialogun mes narratores dhe së jëmës: "Të kanë ardhur ato, njëlloj si mua dhe si motrës." (2022: 87), pra narratorja, po rritet dhe fiton vetëdije. Në frazën tjetër: "Unë i thosha se gocat kanë qejf që çunat të jenë pak vagabondë." (2022: 91), si një zbulësë dëshirash, të cilat nuk shpjegohen. Atmosfera e kohës, përcillet me navitetin e narratores: "Si ka mundësi që rreth Udhëheqësit të Madh të mblidhen kaq shumë gjarpërinj, siç i quan ai..." (2022: 107). Në pentagramin rrëfimor ndeshim edhe ëndrrën për letërsinë, të trembur atëbotë, kur shprehet: "Edhe sikur t'i shkruaja, do të mbylleshin me çelës në sirtar." (2022: 155), si tregues i mungesës së lirisë.

B – Rrëfimtaria – autore, e kohës së tanishme, që vetvetiu ka ndërruar tonin e logjërimit, ka fituar seriozitet. Narratorja e kohës së tanishme, shfaqet kur shkruan: "Të kaloj kontrollin e sigurisë dhe atë të pasaportës dhe do të jem rehat pastaj, -po i thoshte vetes." (2022: 20), ku vëmë re narrativën e përmbysur, sepse rrëfëhet për një kohë tjetër. Narrativa e së tanishmes, ndërkaq bart edhe misterin e të djeshmes: "Çfarë të bëja tani? T'i thosha që e kam ditur me kohë këtë..." (2022: 34). Nga dialogu i rrëfimtares: "Të gjitha shtëpitë e rrugicës janë shembur e janë ndërtuar pallate.", si një transformim rrokopujë i kryeqytetit. Po ashtu, kohën e tanishme sjellë fraza: "Më poshtë lexova lajmërimin për protestë nga Shoqata e Gruas..." (2022: 63). Sërish kemi një shkas që përkon me kohën e tanishme, kur shprehet: "Të nesërmen, si përherë, ata do të shkonin në meshën e Kishës Katolike, ku vajza ime është pagëzuar." (2022: 74-75). Futja në atmosferën e tanishme, bëhet edhe më tronditëse, kur shkruan: "Dhe ja ku na vjen lajmësi i parë me presionin e parë, që të tërhiqeshim nga tenderi.", që zbulon fytyrën e kohës që po jetojmë. Pohimi: "Është i njëjti, veçse i është shtuar shumë bukuria nga pemët e kumbullës të mbjella anash trotuarit dhe korsia e kalimit për biçikleta..." (2022: 157). Pra, në faqet e romanit "Lindur së prapthi", prozeshkrimi, sendërtohet nëpërmjet narratores-autore, e cila ndërkaq përfaqëson dhe mishëron botën romanore. Me vlerë është përfundimi i dijetarit, kur theksonte: "...na

në jetën e protagonistes-autores-narratores. Edhe kjo ndarje, ndërkaq përbëhet nga dy elementë:

- Pjesë pa titull, e cila përfshin gjashtë episode.

- Pjesët që janë emërtuar me tituj të caktuar, që ngërthen dymbëdhjetë episode.

Në radhë të katërtë: Epilogu ku takohën dy kohët, mbase edhe protagonistët e tyre, që shpalolet më tepër si një simfoni, se jeta duhet jetuar.

Pra, struktura romanore, zë fill me prologun, me Ndarjen e Parë, e cila përbëhet nga dyzet episode, nga Intermexo, me tetëmbëdhjetë pjesë dhe mandej ulet sipari me epilogun. Vihet re, që kompozimi strukturor, vjen i përndarë në gjashtëdhjetë episode, duke endur një shkapërderdhje emocionale, që vë në zgrip shpalimin strukturor, gati të mungesës komponuese, me gjasë të një fragmentarizimi, sikur në sekuenat filmike, por varësisht tipologjisë romanore, ndërkaq shndërrohet në skenë aktive, konkrete dhe letrare, që shmanë veprimin, logjikën e rrjedhës organike, por edhe duke formësuar një paralele ndërkohore, e djeshme – e sotme, që grimcon veprimin dhe kompozimin e romanit.

NUMRI SHTATË DHE POEZIA

Shfaqja e numrit shtatë dhe poezia, numrat magjik të logjërimit gojor dhe libror, në faqet e romanit, shënon befasi. Shtata, në librin "Lindur së prapthi", shpërfaqet me dy forma:

- Parodizimi i numrit shtatë, për të nxjerrë në pah kushtet e vështira të jetesës, gjë që theksohet në situatën: "Ua kisha ngulur sytë shtatë pjatave që kishite renditur nana Merjem për shtatë femijët e saj..." (2022: 140). Për të ardhur te parodizim real kur shkruan: Shtatë pjatat m'u dukën si shtatë e pjatat e xhuxhëve dhe vetja si Borëbardha..." (2022: 15).

- Shtata mitike, e pranishme në poetikën gojore, që në tekst lidhet me përrallat e hallës, teksta shkruan: "I tregonte aq ëmbël, sa edhe skenat më të tmerrshme të kuçudrës që kishite shtatë kokë, shtatë gojë që nxjerrin shtatë flakë dhe që në të njëjtën kohë hanin shtatë njerëz, nuk më frikësonin fare." (2022: 92), ku prania e kuçudrës, qenies mitologjike, e kthjellon situatën e kësaj marrëdhënie. Bartja e poezisë në hapësirën e romanit, është tregues domethënës se autorja, pavarësisht se është hedhur në lëvrimin e prozës, me gjasë të romanit, gjithnjë ka për zemër poezinë. Atmosfera e poezisë së sirtarit, pëson ngjitje të pazakontë, në shqiptimin e një lirizmi të beftë: "Nëse natën vij./të futem në shtrat./ Ti mos u frikso./vij e iki prapë." (2022: 118), si dëshmi e lëvrimin të lirikës erotike. Në faqet e romanit, përgjithësisht mbizotërojnë vargjet e lira, si në rastin e poezisë "Çlirim nga ankthi", apo në vargjet: "Dola lakuriq në rrugë./Dhe njerëzit e vegjël/Të kërrusur nga thesi i thasethemeve/Ngritën gishtin e thanë: Ajo është/Ajo është fajtorja!" (2022: 205), e poezisë "Guximi i moshës së rinisë". Thelbi i shkrimit letrar, në lëvrimin e poezisë, por që ruhet edhe në faqet e këtij romani, të ndërmend idenë e Jan Mukafovský: "... kundërvënja e qëllimshmerisë dhe e paqëllimshme është antinomia bazë e artit". Pra, në hapësirën e romanit "Lindur së prapthi", janë përfshirë pesëdhjetë e pesë vargje gjithsej, porse paritetin e ka narrativa, figurimi i kohës dhe personazheve, duke sendërtuar një tekst që të grish për ta lexuar, sepse përveç kohës, gjen një pjesë të vetes, qenia njerëzore, e gjendur në rrethakun e dykohësisë.

[1] Gjergj Llukash: *Teoria e romanit*, Prishtinë, shb Rilindja, 1983, f. 127.

[2] Harold Bloom: *Si dhe përse shkruajmë*, Tiranë, Botime Dudaj, 2000, f. 170.

[3] Umberto Eco, *Gjashtë udhëtime narrative*, Shkup, Asdreni, 1997, f. 149.

TIRANA. VITET E PARA TË NJOHJES

Tirana, kur zbrita nga treni i parë që vinte nga Rrogozhina dhe nxitova duke ndjekur njerëzit e shumtë për të dalë në bulevardin e gjerë, m'u duk jo vetëm qytet shumë i madh, por edhe i gjelbëruar dhe i pastër. Vjeshta e parë ishte në gjysmën e saj. Kisha lënë pas qytetin e vogël të Rrogozhinës, familjen time të dashur, shkollën, kujtimet e shumta dhe tani do të nisja një jetë të re, atë të studentit. Nuk e di se përse kujtimet e atyre viteve me vijnë me aroma dhe ngjyra të ndryshme, si në ato të poezisë së Rembosë. Bulevardi i madh. Sheshi "Skënderbej", Pallati i madh i Kulturës dhe godina e bukur e disi hijerëndë e Komitetit Ekzekutiv, ndërtuar në kohën e Mbretërisë. Rruga e Elbasanit me vilat dy a tri katëshe, që ishin në krahun e majtë dhe me oborre e kopshtije me lule, nga ku vinin aromata e vjeshtës. Godina e Fakultetit të Historisë e Filologjisë dhe më lart, Qyteti Studenti. Pikërisht këtu në godinën e dytë dhe katin e dytë të saj dhe me një dhomë që ishte në mes të këtij kati, fati e desh që të jetoja për katër vite me Shefki Karadakun, Tomorr Domin (nga Elbasani), Niko Kacalidhën, që vinte nga zona e minoritetit grek të Sarandës dhe Moikom Zeqon. Nuk njihja asnjërin prej tyre, por emrat e Shefkiut, Nikos e veçmas të Moikomit, ishin për mua të njohura nga poezitë që lexoja në shtypin letrar të kohës. Këtu nisi shoqëria ime me ta, që vazhdon, por me Moikomin që në ato vite u lidha më shumë, ndonëse ishim natyra të ndryshme. Unë shumë i përmbajtur, i heshtur dhe i qetë, ndërsa ai i gjallë, i shkathët, më i afruar dhe shumë shoqëror jo vetëm me ne, por me të gjithë studentët e tjerë.

Lexonte shumë, jo vetëm libra që përfshiheshin në programet e degës gjuhë – letërsi, por edhe libra të tjerë. Ishte Moikomi që më solli nga Durrësi romanin "Të kesh a të mos kesh", të Hemingueit, që më pëlqeu shumë. Pastaj romanin "Lamtumirë armë" dhe "Plaku dhe deti", që i lexova disa herë dhe mbaj mend që në një bllok te vogël shkruaja fragmente që më bënin më shumë përshtypje. Ishte Moikomi pra që më dha të lexoj kryeveprat e këtij shkrimtari, me të cilin që nga ato vite jam i dashuruar marrëzisht me veprën e tij të madhe. Më pas ai më rekomandoi leximin e Remarkut, veçanërisht romanin "Tre shokët" ...etj etj.

Moikomi dallohej nga ne, edhe në debatet që bënim në seminare për tema dhe vepra të shumta të letërsisë shqiptare dhe botërore. Edhe në provime, mbaj mend që ai ishte i vetmi student, i cili pasi i përgjigjej pyetjeve të tezave, vazhdonte të diskutonte me pedagogët, që ishin autoritete në fushat e letërsisë dhe gjuhësisë, si Myzafer Xhaxhiu, Mark Gurakuqi, Drita Siliqi, Dalan Shaplllo, Ali Xhiku, Jorgji Doksan, Nasho Jorgaqi, Shaban Demiraj, Anastas Dodi, Jani Thomai, Remzi Përnaska, Et'hem Lika ...etj etj. Nuk do të harroj kurrë leksionet e veçanta që shkrimtari i madh Ismail Kadare, dha për kursin tonë të Degës Gjuhë-Letërsi, për poezinë dhe prozën moderne, europiane dhe botërore. Këto leksione ishin të veçanta dhe na hapën një dritare, nga e cila ne, të rinjtë e asaj kohe, në kushtet e izolimit, njohëm një letërsi tjetër, që shkruhej përtej kufijve të Shqipërisë. Moikom Zeqo e kishte mik, që në atë moshë Kadarenë dhe e mbaj mend, që kur mbaronin leksionet e tij, ai e shoqëronte shkrimtarin e madh. Nuk e shihnim me zili këtë marrëdhënie, por bëheshim kurioz, se çfarë bisedonin, se çfarë shkruante Kadareja etj.etj. Unë, i ndrojtur, kisha dëshirë ta takoja, ose të paktën t'i jepja dorën Kadaresë. Dhe këtë s'e bëra asnjëherë, duke e parë dhe admiruar nga larg, idhullin e brezit tim. Kjo më kujton Markesin, i cili e pa nga larg Heminguejin në Paris dhe e përshëndeti po nga larg, duke mos iu afruar mjeshtrit të madh të prozës botërore.

Unë i jam mirënjohës Moikom Zeqos,

Qershori i 75-të i Moikom Zeqos

nga Enver Kushi

Moikom Zeqo ka lindur në qytetin e Durrësit, më 3 qershor të vitit 1949.

Për personalitetin e tij të papërsëritshëm të kulturës shqiptare, është shkruar dhe do të shkruhet akoma më shumë në të ardhmen, kur brezi ynë, që e ka njohur nga afër nuk do të jetë më. Qershori është datëlindja dhe datëvdekja e Moikom Zeqos. Kam patur fatin të jem një nga miqtë e tij, që nga vitet studentore, kur ishim bashkë në një dhomë e deri në fund të jetës së tij, ose më saktë deri pasditen e vonë të 14 qershorit 2020, kur pasi i telefonova dhe pyeta si e ndjente vehten dhe se do të bëhej më mirë, dëgjova fjalët e tij. Më dukej sikur fliste nga thellësi botërash mistike, ose ndoshta nga hapësira qiellore. Tha këto fjalë: "Ah Veri, Veri, Veri im!"

Nuk e mendoja kurrë, që këto do të ishin fjalët e fundit, që do të dëgjoja prej tij. Nuk e mendoja kurrë, që atëhere kur copat e fundit të natës po largoheshin nga kryeqyteti shqiptar dhe dielli ishte akoma i fshehur pas Dajtit, Moikom Zeqo do të largohej nga kjo jetë. Ishte një largim i shpejtë, i qetë, pa zhurmë, duke lënë pas dritën dhe frymën e dhjetra veprave, nga më të çuditshmet në Letrat shqipe e më gjerë. Me të drejtë shkrimtari dhe publicisti i mirënjohur, Bedri Islami, ka shkruar: "Moikom Zequa ishte si prekje e mahnitshme e dritës. Më shumë se njeri, ai ishte frymë..."

Duke botuar në formë kujtimesh në 75 vjetorin e lindjes së tij, dua t'u sjell lexuesve, një pjesë të jetës së tij të vrullshme.

Shkrimi le të jetë një homazh për jetën dhe veprën e Moikom Zeqos.

sepse ishte ai që pasi lexoi tregimin tim të parë, më inkurajoi që të shkruaja. Mbaj mend që ishim në vitin e dytë, kur një pasdite i jap për të lexuar një tregim të shkurtër timin të titulluar «Atë e vrau deti», pa i thënë se kush e kishte shkruar. E lexoi menjëherë

dhe më pyeti: "Ti e ke shkruar këtë tregim?". Unë heshta duke mos pohuar e as mohuar. Ai përsëri pyeti: "Veri thuaj të vërtetën. Ti e ke shkruar?". Po, i thashë. M'u afrua dhe pasi më dha doren, tha duke qeshur: "Veri. Që nesër këtë tregim do ta çosh tek gazeta



Ne vitet studentore: Lart, Moikom Zeqo, Tomorr Domi, Enver Kushi. Poshte, ne mes Niko Kacalidha



"Drita", ndërsa sot do të dalim të gjithë si dhomë dhe do të na qerasësh..." Dhe nga ajo kohë e largët vazhdimisht kam patur ndihmën e tij të pakursyer miqësore dhe nxitjen për të shkruar. Ishte ai, që pasi botova në vitin 1975 tregimin "Çminimi" te "Drita" dhe më dhane çmimin e tretë për atë vit, këmbënguli që tregimet e shkruara ti përmbledhja në një libër e ti çoja për botim në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Ishte miku im i shtrenjtë Moikom, që pas përgjigjeve negative që vinin nga redaksia e tregimit dhe pse jo shqetësimin tim, më nxiste që të mos dekurajohesha, derisa në vitin 1988 doli libri im i parë me tregime "Porta e madhe".

Që në vitet studentore, njoha nga afër nënën e tij, Pandorën, një grua dhe nënë e rrallë, punëtore dhe shumë e heshtur. Ishte ajo, që pas vdekjes së parakohshme të bashkëshortit të saj, Zihniut, me origjinë nga Libohova, ndonëse shumë e re mori drejtimin e shtëpisë duke rritur me sakrificë tre djem: Moikomin, Manushin dhe Fredin. Moikomi ka lindur dhe është rritur në një shtëpi jo shumë larg nga porti dhe deti, në një nga rrugët më të bukura të Durrësit. Nga ballkoni i katit të dytë të shtëpisë së tij dukeshin një pjesë e mureve të vjetër të qytetit të dikurshëm e pak më tutje ishte shtëpia e Aleksandër Moisiut. Sa herë që shkoja atje, Moikomi ishte guida ime, duke më futur në lashtësinë e Durrësit dhe qindra e qindra histori që ai më tregonte.

Dua të përmend edhe një fakt tjetër, që e përmenda më lart, për miqësinë e tij të hershme me shkrimtarin e madh Ismail Kadare, që brezi ynë e adhuronte. Moikomi ishte takuar me Kadarenë mos gabo, që në moshën 14-vjeçare. Kur ishim student ai ulej dhe pinte kafe me shkrimtarin e madh, apo shkante si mik në shtëpinë e tij. Kadareja e ka vlerësuar talentin e Moikomit si poet, që kur ishte fare i ri. Kadareja vlerësonte gjithashtu edhe kulturën e gjerë të Moikomit. Mbaj mend, që nga krijuesit e rinj të kursit tonë, edhe Thanas Dino u lidh ngushtë me Kadarenë.

NË SHKODËR

Ishte gusht i vitit 1971, kur pasi u diplomuam në degën gjuhë – letërsi, nisëm në qytetin verior të Shkodrës zborin e detyrueshëm ushtarak. Mbaj mend, që gushti i atij viti ishte shumë i nxehtë dhe në kapanonin e madh ku flinim, edhe nata ishte e tillë, mbytëse. Në këtë qytet të jashtëzakonshëm, historia dhe kultura e tij janë të dukshme dhe të prekshme. Edhe stinët e këtij qyteti, janë sa të veçanta, aq edhe befasisë. Atje, në një farë kuptimi, une përjetova ditët dhe netët me qiejt e verës, vjeshtës dhe fillim dimrit, apo erërat që vinin nga alpet, lumenjtë, liqeni dhe brigjet jo të largëta të detit Adriatik. Janë dy momente që dua t'i nënvizoj në këto kujtime për Moikomin dhe Shkodrën.

E para, në këtë qytet ai pati një "shpërthim" të befte dhe të veçantë krijues, jo se i mungonte kjo gjatë viteve studentore në Tiranë, ku shkruante dhe botonte cikle të shumta në shtypin letrar të kohës. Në Shkodër ai ka shkruar ndoshta poezitë më të bukura, me një figuracion të çuditshëm,

apo metafora, që si ca kuaj të hazdisur, duke sikur hingëllin në hapësirat qiellore sa shqiptare, aq edhe ballkanike apo europiane. Më vonë, në bisadat e shumta me të, ia kam kujtuar poezitë, sinopsset, vargjet e rralla, që pasi i shkruante në ca blloqe të vegjël, kisha fatin t'i lexoja unë i pari.

Në Shkodër ai shkruante si në jerm. Shkruante pa pushim, atje në një repart të vetmuar ushtarak, që ndodhej në periferinë veriore të qytetit të çuditshëm e befasues të Shkodrës. Atje janë shkruar edhe këto vargje, që janë botuar në librin "Miscellanea 1":

Heshtje dhe vetmi,
Zërat janë thërrmuar,
Nga vapa dhe acari i braktisjes,
Vetëm koha si piramida ka mbetur.

Në Shkodër janë shkruar qindra vargje nga Moikomi dhe shumë prej tyre u botuan në shtypin e kohës në vitet 1972-73. Këtyre poezive në vitin 1973 ju bë një nga gjyqet më absurd në historinë e kulturës shqiptare dhe ato gati u bënë "varri" i Moikom. E megjithatë ai nuk ndali së shkruari pas goditjes që pësoi dhe poezia metaforike dhe e çuditshme e tij, sfidoi kohërat. Këto ditë, duke shfletuar botimin ku përmbledhen poezitë e viteve 1964-89, në dedikimin për librin që më ka dhuruar, lexova këto fjalë kuptimplotë: "Verit tim, për kujtim këtë sagë poetike, që dëshmon se koha s'kthehet më nga kalendari, por metaforat po! Me dashuri Moikom Z. 6 tetor 2006".

E dyta, në Shkodër ai shkante shpesh në shtëpinë e poetit brilant, Frederik Rreshpja. Moikomi pritej në atë familje, si të ishte pjestar i saj. Mbaj mend, që një pasdite, pasi morëm leje në komandën e repartit ushtarak, u nisëm për në shtëpinë e Fredit. Ishte Moikomi që nguli këmbë, këtë herë që të vija edhe unë me të, për të njohur nënën e Frederik Rreshpjes dhe për t'u takuar me Fredin. Kisha emocion. Moikomi trokiti dhe pasi motra e Fredit hapi portën, që mua m'u duk e madhe si portë kështjelle, hymë në një oborr me shumë lule e pemë. Moikomi i puthi duart nënës së Fredit, ndërsa ajo e puthi në ballë. Më pas ai më prezantoi me Frederikun, i cili më hodhi një vështrim të shpejtë dhe me sa duket emri im atij nuk i kujtonte asgjë, ndonëse Moikomi i tha, që shkruaja tregime.

Në fillim të viteve '90, pasi Frederik Rreshpja botoi në numrin e parë të gazetës "Evropa", tregimin tim të gjatë "E hëna e vitit Zero" (10 janar 1993), ndërsa e falenderova një ditë më pas, ai më kujtoi vizitën time të parë në shtëpinë e tij në Shkodër dhe tha: "Sa i ndrojtur ishe atëherë... Edhe shumë i gjatë m'u duke". Më vjen keq, që nuk kam hedhur në letër bisadën e Moikomit me Fredin, atë pasdite të vonë, të gushtit të vitit 1971, kur unë takova për herë të parë poetin e madh Frederik Rreshpja.

Miqësia e Moikom Zeqos me Frederik Rreshpjen, që ka nisur ndoshta para vitit 1971, është shembull i veçantë në letrat shqipe. Kam shkruar për këto lidhje dhe marrëdhënie të dy njerëzve të shquar të Botës Shqiptare. Gjatë kohës së zborit 5 mujor në qytetin e Shkodrës, siç thashë më lart, Moikom rrinte dhe bisëdonte shpesh me Fredin.

Sa shkrova më lart, janë një pjesë e kujtimeve të mia gjatë rinisë dhe jetës studentore, me mikun tim Moikom Zeqo.

Tashmë ai nuk është më dhe unë e kam të vështirë ta besoj dhe të mësohem me këtë fakt të trishtë. Në një bga poezitë e shkruara në Durrës, në vitin 1993, këto ditë lexova këto vargje befasuese: "Vdekjes dhe harrimit u bërtas: "Unë jam këtu! - S'kthehem mbrapsht".

Kuptimplotë këto vargje. Jeta, vepra, krijimtaria e shumanëshme e mikut tim të shtrenjtë Moikom Zeqo, e largojnë vdekjen dhe harrimin e Tij. Ai është këtu, më i gjallë dhe vital se ne të gjallët.

Libri i Drita Çomos "Dritë që vjen nga Humnera"

Gjurmë drite mbi terr

nga Yzedin Hima



Libri i Drita Çomos "Dritë që vjen nga humnera" është ndër librat më të trishtë që kam lexuar. Nëse Ditarin e Drita Çomos do ta pranvëm me librin e famshëm "Ditari i Ana Frankut", libër që ka trishtuar botën, do vëmë re se të dy tekstet kanë disa përqasje: janë dy vajza të ndjeshme, të brishta në situata tejet absurde, ku dhuna që vjen nga rrethimi i dy diktaturave, asaj naziste dhe asaj komuniste, shenjon e godet shpirtat e tyre të brishtë në një terr pa asnjë dritë shprese.

Ana Franku, me Ditarin e saj ia tregoi botës plagët e tmerrshme, genocidin që shkaktoi nazizmi mbi krijesat e pafajshme njerëzore. Ditari dhe poezia e Drita Çomos po u tregon qytetarëve shqiptarë dhe më gjerë për dhunën, burgjet, privimet, varfërinë, mjerimin fizik dhe shpirtëror që pësuan banorët e këtij trualli gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Dy diktaturat ngajnë me njera - tjetrën për fatin e keq të njerëzimit që i përjetoi. Të dy vajzat kanë një fund të trishtë.

Ndryshe nga Ana Frank që jetoi ferrin nazist, Drita Çomo jetoi ferrin e dyfishtë, komunizmin dhe kancerin. Duke lexuar ditarin e saj të bën përshtypje se shpesh sëmundja tërhiqet për pak kohë, për t'i lënë vajzës disa çaste gëzimi, kur analizat e saj shëndetsore dilnin në parametra normale dhe vajza i gëzohet qetësisë dhe mungesës së dhimbjeve trupore. Ndërsa diktatura që një ferr pa mbarim, me dhunën, fyerjen, varfërinë dhe mjerimin, poshtërimin, burgosjet e internimet e prindërve dhe njerëzve të afërm të saj. Nëse kanceri i shkatonte dhimbje të tmerrshme fizike, diktatura i drejtohej posaçërisht shpirtit dhe mendjes, duke shkaktuar dhimbje të tmerrshme shpirtërore dhe tronditje të thella psikologjike. Në ditarin e saj Drita Çomo shkruan: "O Zot më shpëto nga dhimbjet fizike, se nga ato shpirtërore shpëtoj vetë".

Pikërisht, kjo vajzë e ndjeshme, me interesa dhe kureshtje për shkencën, letërsinë, u gjend në situatën më absurde: e rrethuar nga dy diktatura, ajo e vdekjes dhe ajo staliniste. Në ditarin e saj gjen refleksione të tilla si: "Tragjedia në jetën e njeriut fillon atëherë kur ai e kupton se nuk i nevojitet askujt". Marrëdhëniet e Dritës me diktaturën në ditar shënohen si mjaft absurde. Kur ajo kërkon të dijë se ku e kanë flakur babain e saj pa asnjë adresë, zyrtari i shtetit i kumton: "Përgjigjia është: nuk përgjigjemi!".

Në faqet e ditarit dallohet rrjedhshmëria e tekstit, pasuria e fjalorit dhe teksti herë - herë merr nuancat e prozës poetike: "Dukej sikur qielli i kish rrëzuar yjet në tokë. Ai ishte i errët, gati i zi dhe vetëm tek - tuk dridheshin siluetat e zbehta të yjeve, si një reflektim i dobët i gjithçkaje që shndriste në tokë. Diku, midis dritave, mbi një oxhak të përskuqur digjej një flakë e blertë, e qetë dhe e pastër, që të kujtonte tempujt e lashtë me

kurbanet dhe flakëritjen e tyre të ftohtë, kushtuar qiellit."

Kjo gjuhë mjaft e latuar vjen si rrjedhojë e leximeve të shumta të letërsisë artistike nga Drita Çomo. Në përgjigje të pyetjes, që i drejtoi dikush se cila ishte më e fortë dashuria apo urrejtja, Ajo i përgjigjet me një thënie të Gollsuorthit: "Vetëm neveria është e përjetshme". Drita Çomo shkruan në ditarin e saj se ajo shkante në bibliotekë dhe lexonte literaturë mjeksore dhe me një kurajo të pazakontë shkruan se po lexonte e njihej me vdekjen e saj. Përballja e saj me vdekjen është tejet kurajoze, ndërsa përballja me diktaturën më tepër është një shpërfillje elegante nga ana e saj.

Një nga mungesat lemeritëse në diktaturë ka qënë mungesa e humanizmit. Kjo vajzë e dashuruar me librat, me njerëzit e thjeshtë që vuanin, natyrën, kalonte midis rrugës e shigjetuar nga sy plot urrejtje. Lufta e klasave, e predikuar nga diktatura, i shkretoi shpirtat njerëzorë, ndaj vajza e bukur me emrin Drita Çomo ndihet më e qetë në pavionet e kancerozëve, se sa në mjediset publike të qyteteve. Herë - herë ajo të trondit me fjalët e ditarit të saj: "Dhe një njeri i vetëm s'ka se ç'bën - i duhet t'i nënshtrohet fatit dhe ndoshta vetëm të përpiqet që të paktën imagjinata e tij të ecë krahas botës së madhe." Ditari është ndërtuar me mjaft pyetje retorika e dilema që ia brejnë shpirtin e pafajshëm autores: "Po kur nuk ka kurrfarë ritme dhe gjithçka është rrokullisje pa fund?"

Në tekstet poetikë të Drita Çomos trishtimi, dhimbja, brenga janë shenja kuptimore. Poezia e saj është një klithmë e bukur ekzistenciale. Ndonëse ajo ishte në pranverën e moshës, në tekstet e poezisë së saj takojmë vjeshtën, shiun dhe dimrin. Në poezinë me titull "Vjeshtë" autorja i drejtohet vjeshtës: *Dhe po më mbyty ky qiell i errët.../Dua ta pyes përse më mban mëri/ Dua t'i lutem të mos jetë kaq e egër-/Edhe pa të në shpirt kam kaq mërzë./* Në poezinë



me titull "K..." Drita Çomo, pasi vizaton me fjalë plot ngjyra portretin e vogëlushes Kledia, bijë e dy prindërve të internuar si armiq të diktaturës, bën pyetjen: Çdo të ndodhë me të? Dhuna mbi të bukurën është dy herë dhunë: *Ajo kish fëshfërimën e barit në sy/ Pafundësinë e detit në diell/ Në misterin e qenies së saj e bukura./ Si pluhur yjesh dridhej.* Dhuna mbi të bukurën, mbi femrën është dyfish dhunë.

Leximet e kishin bërë të lirë shpirtërisht dhe mendërisht Drita Çomon. Ajo e shikon botën me vështrim hamletian, kur thotë se tragjeditë e Shekspirin nuk luhen vetëm në skenat e teatrove të botës, por edhe në realitetin e njëmendët të vendeve të ndryshëm. A nuk i takon kohës së diktaturës thënia e mrekullueshme e Hamletit se ardhka një kohë, kur virtyti i kërkon ndjesë vesit?!

Në poezinë "Gjyshes" autorja e portretizon gjyshen e saj fatkeqe me figurën mitike të Niobes, nënës që u shndërrua në gur nga dhimbja për bijtë e vrarë në mitologjinë greke. Gjyshes së Drita Çomos iu dënua bijtë me 140 vjet burg e internime. Edhe ajo nga dhimbja e thellë që shndërruar në gur: *Niobe fatkeqe ngurosur nga dhimbja./ Ç'zemërim perëndish mbi supe të ra, Ç'hyjneshë ke fyer me lumturinë tënde/ Që pa dritën e syve të la./* Më tej ligjërimi shndërohet në një klithmë ekzistenciale: *Shtegtim i pafund nga një tmerr në tjetrin/ Tragjedi niobiane e shndërrimit në gur/ ulërin drejt tokës, ulërin drejt qiellit/ Deri kur? Deri kur?!*

Drita Çomo shfaqet në ditarin e saj si një vajzë e re e bukur, e zgjuar, plot dinjitet. Ajo, ndonëse jetoi ferrin e dyfishtë, kultivoi te vetja shije të holla estetike, dhembshurinë, humanizmin dhe qëndrueshmërinë. Ndonëse jetoi në një kohë kur hipokrizia, dhuna, spiunimi, urrejtja kishin mbërthyer shoqërinë, ajo eci në drejtim të kundërt duke kërkuar, krijuar e përjetuar të bukurën në një kohë të shëmtuar. Në tekstin e poezisë "Ca lule" ajo e sfidon dhunën me dhimbjen dhe dashurinë njerëzore: *Ca lule të bardha këputa në kopsht./ Si pikëllim i bardhë kanë ulur kokën/ E duket se më thonë, po përse./ Ç'faj kishim ne, ç'faj kishim ne.../ Ç'bëra, them me vete, veten shaj./ Po ja dhe unë vuaj dhe pa faj.../Petalet e bardha nis i shkund./ Si dhembje të vogla në dhembjen e pafund./ Po unë e dija, them me vete, veten shaj./ Se çdo të thotë të vuash, kur s'ke faj.*

Është ndër poezitë e arrira, e cila mund të qendrojë me dinjitet artistik në çdo antologji poetike. Dhimbja e ka bërë të bukur fjalën e Drita Çomos. Në vargun *Si pikëllim i bardhë kanë ulur kokën* kemi një krahasim befasues, një epitet metaforik dhe një metaforë, ku figurat nuk errësojnë njera - tjetrën, por shkëmbejnë dritën midis tyre.

Tekstet e Drita Çomos janë gjurmë dritë në pëlhurën e terrtë të kohës që ajo jetoi.

Në vend të hyrjes

Pas një çerek shekulli, (pasi mbaroi Lufta në Kosovë, (1998-1999), na vjen para lexuesve një vëllim poetik, paksa i veçantë për nga tipologjia dhe uniteti strukturor, nga poetja e mirënjohur, Donika Dabishevci, “E gjithkohshmja Andërr”. Derisa në librin e saj poetik, “Kam me ardhë si deka” (2015), autorja shpalos një temë qendrore, të “zjarrtë”, dashurinë me zjarrminë që bart, me vibrimet eksplozive, ndërsa në veprën “E gjithkohshmja Andërr”, kemi një temë krejt tjetër: luftën me format më të dhimbshme, më të errta, në mes, qëndron NJERIU, përballë Jetës dhe Vdekjes. Kjo përballje me vdekje është jo e natyrshme, sepse manifestimet rrëfimore- poetike brenda këtij libri janë të trishta, të përshkallëzuara, të paparashikuara; janë çaste dhe momente që i përjeton heroi lirik, Njeriu, por s’ke fuqi t’i ndryshosh.

Lufta dhe forca shpirtërore

Mbi dy dekada jemi ndeshur me rrëfime për luftën në prozë, skica, tregime, në këngë, piktura, vizatime, por edhe në copëza të shkapërderdhura poetike në vëllime poetike. Autorja vjen para lexuesve me një kod tjetër leximi, me një brumë të ngjeshur poetik, unikat në narracionin kontinuitet, fund e krye librit. **Lufta**, kjo fantazmë e tmerrshme “kafshon” helmon, kapërdin çdo gjë para vetes dhe prapë jeta i kundërvihet me fuqinë e rrënjëve të shpresës, se edhe nga lufta shpëton diçka..., sepse tek e fundit “Jeta e mund luftën, e mund vdekjen, me çmim shumë të madh” (fq.10. Dr. Gëzim Aliu recension, po aty). Në gjeografinë letrare-poetike të këtij libri shtrihet lufta si stuhitë shkatërrimtare mbi njerëzit, familjen, kolektivitetin dhe natyrën që i rrethon. Brenda qiellit plumb dhe tokës stërgjyshore gëlon jeta dhe vdekja.

Andrra - kodi i leximit, si ta lexojmë?!

Në cilin kod leximi ta lexojmë këtë togfjalësh “E gjithkohshmja Andërr”? Ta lexojmë si metaforë, ta lexojmë si parabolë jete, si ëndërr e përjetshme që duhet jetuar në liri, sepse liria ka çmim fundamental apo si requem elegjiak si atmosferë funebre me “Krisma, britma, zhurmë, heshtje plot ankth, përdoren në funksion të krijimit të ritmit të rëndë të veprës” (fq. 12. Dr. Gëzim Aliu, po aty). Ky libër, mendoj se mund të lexohet në dy-tre rrafshet: si rrëfim poetik, si dhimbje-përjetim i rëndë. Kodi i leximit kalëron në “kalanë” shpirtërore të librit në linjat ideore: vërtetësia e rrëfimit si prohim lufte, dashuria sublime e poetes për heroin lirik, për Njeriun dhe ndjesia e shndërruar në dhimbje personale dhe kolektive. Gjithë gjeografia shpirtërore e poezive i mbështjellë manteli i vdekjes dhe jetës me ngjyrat e trishtimit, frikës, plagëve, ankthit, psikozës, ikjes dhe rrugës së shpëtimit. Tema bosht e luftës përbën atë motorin lëvizës ku sillen “dy kahje” të kundërta, fletëzat e jetës dhe ato të vdekjes. Pra, kemi një antitezë stilistike (jeta-vdekja). Këto dy “pole” ideore- filozofike herë e mundin njëra-tjetrën, herë bëhen pjesë e një gjendjeje krejt të katandisur ku në fund triumfon jeta si bimë që kultivohet dhe rritet nga të gjallët, nga ëndrrat për lirinë dhe pjesëmarrësit në “kështjellën” e pamposhtur, Jetën.

Donika Dabishevci, “E gjithkohshmja Andërr”, poezi,
“Littera”, Prishtinë, 2024

NJË METAFORË NË MES JETËS DHE VDEKJES

Nga Maxhun Osmanaj

Ndërtimi strukturor i librit

Libri ndahet në katër cikle, me gjithsej 41 poezi, 110 faqe. Librit i paraprin një recension “Poemë për njeriun në luftë” shkruar nga Dr. Gëzim Aliu, me një mendje daltuese dhe profesionalizëm, duke hyrë thellë në shpirtin e veprës, duke shkoçitur karakteristikën, veçori dhe tipare të veprës.

Cikli i parë “Zanun n’lak” (14 poezi), cikli i dytë “Lakmia me u çmend” (12 poezi), cikli i tretë “N’luftë me korba” (6 poezi) dhe cikli i fundit “Dhimta t’ngufatuna n’ofshama t’pazashme” (9 poezi). Libri hapet me poezinë “Granatimi”, më shumë si rrëfim poetik, ngase granatimet dihet çfarë sjellin, nga këtu fillon odiseada e skenave trishtuese. Poezia “Shpija” është poemë në vete. Në atmosferë lufte, koncepti filozofik për shpinë, sikur humb çdo gjë nga rrebeshi i luftës, ngase ajo është vatra e ngrohtë ku merr kuptim jeta në liri, ndërsa “Lufta t’vesh përj finesave/ lakmive, joshjeve, dëshirave.../Lufta t’i mbytë tana andrrat.../Lufta ta humbë arsyen/ Lufta t’i minimizon edhe nevojat” (fq. 21. Poa aty). Poezia e radhës “Simfoni zorrësh” është protestë shpirti, është pikturë urie ku përzihen ngjyrat më të errta të jetës, ku askush s’dëshiron ta shohë apo përjetojë “Dita e tretë pa shti gja ngojë/ Bukë, ku me gjetë bukë!/ Janë harxhë tana rezervat/ janë harxhë tana idetë/t’rrethueme n’tana antë prej armëve” (fq.22-23).

Autores nuk i ikën nga sytë dhe mendja gjërat e ulta që i ndeshim nga matrapazët e përfituesit e luftës, ku e përfitojnë dhe shfrytëzojnë situatën, njerëz pa sedër, s’kanë shpirt, s’kanë fytyrë njeriu, të zhveshur nga dinjiteti; “Nji lirë dukati, një boks cigare”, poezia “Matrapazët” (fq.26). Në çdo pëllëmbë toke ulërin deka “kërcënuese” deri në shfarosje, ku në çdo minutë rrjedh pyetja: “A po desim a po pshtojmë?” (fq.27). Ndërsa poezia që bart titulli i librit “E gjithkohshmja andërr”, është andërr që bart gjithë mesazhin estetik të veprës, sepse njeriu gjithmonë udhëton me një andërr në gjini- në shpirt. Në këtë rast, liria është ëndërra e mijëra shqiptarëve për jetë të lirë pa shtypës, pa robërues, për t’i shpëtuar së pari vdekjes që e kanë para syve...” Andërr që ka brenda vetes andrrën/andërr që andron me andrrue/ andërr që lodhesh e s’mund e andrron/ e pashkatrueshme, e pavdekshme/ e gjithkohshmja ashtë Andrra/ me dalë gjallë prej lufte/ bashkë me krejt t’dashunit e tu!” (fq. 31-32). Pra, këtu qëndron tërë filozofia e andrrës që bart poezia dhe vepra në tërësi.


Të gjitha poezitë e ciklit të parë, “Zanun n’lak”: “N’grykë”, “Tuj ikë dekës”, “Tuj ecë n’mina”, “Rrethueme katëran’sh”, “T’shtana batara”, “Naë zezëditë...”, “K’tu rnohej dikur”, “Pas masakres” i përcjel atmosfera e frikës, ikjes “qysh me ecë me dekën përdore?” (fq.38), granatime, ulërima, masakra “një kambë ktu, një krye atje, trupin si kuaj deti” (fq.46).



Poezitë e ciklit të dytë, “Lakmia u çmend”, janë kontinuitet i dramës, tragjikës, i trishtimit, përshkallëzuar në shkallën më të lartë të dhimbjes, ngase edhe titujt janë të prekshëm. “Ninull” flej djali i nanës... flej/andërr ahtë krejt kjo/andërr...asht...bir/andërr...andërr/andërr.../asht!” (fq. 53).

Te poezia “Vaji i bebove” vërshohen pasthirrat në çdo fillim të strofës dhe mbaron me “Shhhhhhhhhhh...” (fq.54-55). Me një atmosferë dhe gjendje të rëndë psikologjike, të trishtë, shpërfaqen poezitë në vazhdim “S’kish menu nanëzeza...” “Mos”, “E nemuna nanë!”, “Piktogram dhimte” dhe shumë të tjera. Por si te tejkalohet poezia “E vogla”, ku rrëfimi poetik na mbytet shpirtin: “Gjashtëmuejshe/u puth tejpërtej plumbash/shosh u ba/sitë/prej gjinit t’nanës/ngji t’dekës!” (fq.64). Këto vargje janë monument kujtese, tishtimi, protestë dhe revoltë. Bebeja në vend që ta gëzojë jetën, ajo puthet me plumba, me vdekjen...

Cikli i tretë “N’luftë me korba” përfshin rrëfimin poetik herë si baladë, në një rasti një histori dashurie nëpër kohë si uverturë dhimbje, por në pleqëri përplasen me luftën. Edhe në këtë cikël ruhet kontinuiteti nevalgjik i luftës, rrethit vicioz, sesi të dilet nga ky rreth i trishtë, por në çdo çast ndeshemi me pasqyrën e tmerrit, ankthit, frikës...Poezia “Ngjitun si thue n’mish” është poezia që provokon thellë lexuesin. Një çiftë i moshuar tjerrin luftën në shtëpi, nuk duan t’i lëshojnë



vatrat shekullore, anipse e dinë ç'fat i pret..., japin edhe një porosi :"- Ikni ju , ju priftë e mara, ruene veten, runi këta thmi,/se na pleq jem! / Pak pa dekë/ E ma e mirë se deka n'shpi s'ka!./kishin pasë thanë flokëtëorët/ s'kish pasë gja që i nxjerrë prej shpisë/ s'kishin livritë/ prej pleqve./ një grusht eshtna/ aq kish mbetë!" (fq.80-81). Këtu shihet se njeriu pranon vdekjen, ngase nuk mund të largohet nga vatra e vet shekullore, sepse aty i ka rrënjet, historinë, kujtimet... Kjo poezi është në " Kujtim t'dy moshuemve, Xhevrie e Beqir Kelmendit, t'vrrarë e t'djegun n'shpinë e tyne në Fushë -Kosovë, më 1999. (fq.81).

Libri për mbyllet me **ciklin e katërt- të fundit** " Dhimita t'ngufatuna n'ofshama t'pazashme", ku çdo poezi është e mbuluar me "çarçafin" e vdekjes. Nuk mund të anashkalojmë poezitë që kalojnë nëpër flakët e luftës, ku gjaku si lëng jetë na mbyll gojën pa fjalë, sepse "A mun' m'sohet njeriu me lundrue ngjak", ku autorja në pesë strovat e fillon me këtë varg si rrëfim dhe pyetje retorike. (poezia : "A mun' m'sohet njeriu me lundrue ngjak!", (fq.104-105). Është poezi e tipit rrëfim-trishtim, ku vdekja ka hapur dhembët, kafshon-helmon. Një tjetër poezi që prek thellë shpirtin e çdo lexuesi , ndërtuar nga mermeri i krenarisë epiko-lirike, elegjiake, është poezia " Nanat e dëshmorëve". Autorja ngre lart dhe skalit figurën burrërore të Nanave të dëshmorëve, që pas mbarimit të luftës " T'msue me shkue të vorri/ e mos me la me lot- me i përbi/ e mos me thanë mjera unë/po lum nana për ty!". (fq. 106). Këtu qëndron arti estetik -filozofik dhe mesazh si kuptim ideor.Libri përmbyllet me poezinë " Gja s'ka ndrrue!" që na vjen si përfundim pesimist, por përmes këtij pesimizmi poetja ngre zërin e revoltës, (zhgënjimit) të nënkuptuar në heshtje. " Asht kjo tokë e trueme/ T'tanë janë dëshmitarë/t'dhunuemve e gjymtuemve/ t'vorreve pa emna e t'eshtnave pa vorre/t'nanave mbetun qyqe n'themele shpijash t'rrënueme/t'nuseve me duvak t'zi e shpirtnash t'djegun jetimash,/për mija vjet..." (fq. 108). Këtu vargje janë një përgjigje më revoltuese, rrëfim më prekës, humnera më e thellë e dhimbjes, vargje që dëshmojnë tragjikën, dramën, andrrën e gjithkohshme për liri... Është një përmbyllje e librit kulm- mesazh.

Stili dhe gjuha figurative

Poetja Donika Dabishevci duke qenë doktore e shkencave filologjike , me kënaqësi shkruan në gëgërishte këtë vepër dhe vepra tjera, por edhe në gjuhën standarde letrare. Libri është i pasur me një fjalor stilistik, ku përdor figurat letrare; metaforë, antitezë, epitet, krahasim, figurat tingullore, përsëritjen që i japin fuqi estetike vargut. Autorja përdor varg të lirë, i ik skemave konvencionale. Përdor vargun nga njërrokësh deri në shtatëmbëdhjetërokësh..

Përfundim

Libri ndërtohet nga fjalët kyçe : lufta, dhimbja, andrra, jeta, vdekja, gjaku, masakër, shtëpitë, vrasje...Sikur vdekja ndjek jetën, jeta shqelmon vdekjen. Libër i ndërtuar në tabanin dhe tharmin e luftës, ku brenda kësaj fantazme gëlon vdekja-jeta-andrra. Është "poemë për njeriun në luftë", siç thekson në parathënien e librit, redaktori , Dr. Gëzim Aliu. Libri mbetet para se gjithash permendore kujtimi e skalitur me dhimbje, rrëfim për **Njeriun** që do t'i qëndrojë kohës në çdo kohë, sepse koha nuk shlyen dhimbjen..., kujtesa fuqizon dhimbjen.Autores i dëshirojmë suksese dhe libra të radhës!

Romani "Shtrati 13" i Petrit Palushit, botimet Ombra GVG, Tiranë 2016; libri u shpall romani më i mirë në Panairin e librit, Prishtinë 2017

DASHURI NË SHTRATIN E VDEKJES

Nga Shqiponja Axhami

Romani "Shtrati 13" i Petrit Palushit arrin në mënyrë të patjetërsueshme misionin që ka letërsia, funksionin estetik të saj në përcjelljen e së bukurës përmes artit edhe në hijet më të terrta të jetës. "Dita e vdekjes është më e bukur se dita e lindjes"...

"Vdekjen sikur e kishte para syve, po e merrte kaq mendjelehtësisht, madje tek e shihte si një vallëzimtare të shkathët. Ajo mund ta tërhiqte edhe atë në valle dhe, pak përpara se t'ia ndalte frymën, zhdukej menjëherë prej sallës së vallëzimit..."

"Shtrati 13", ka si pikëvështrim vdekjen ose me saktë luftën me të. Qëndrimi shtatë ditë i Ulpian Agshtegut (personazhi kryesor) në spital jepet përmes një rrëfimi që ngjan herë-herë me një klithmë e here-herë me një nënqeshje të personazhit kryesor, i cili edhe fatalitetin vdekje e merr hera herës me moskokëçarje. Përshkrimi i situatave të qëndrimit të tij në spital, lidhja me ngjarje reale dhe surreale, kujtimet e bukura, por dhe të trishtat janë një spirale kërkuese që përshkruan gjithë romanin, kthjella e epërme e së cilit është shërimi i personazhit, i cili në këtë udhëtim shtatë ditë përjetoi atë që nuk e kishte përjetuar kurrë imagjinatën në kufijtë skajorë të ëndrrës së pajetuar dhe të jetuar njëkohësisht. Por zymtësia e këtij vështrimi zbutet nga aftësia e jashtëzakonshme e autorit i cili krijon paralele, prej përshkrimesh gati poetike sa lexuesi pluskon mbi fatalitetin vdekje gati përcmues.


Përmes një arti që krijon tablo dhe rrethana krejt moderne të përceptimit të vdekjes lexuesi kupton se si Ulpian Agshtegu në momentet më të vështira të jetës, në shtratin e vdekjes bën një udhëtim imagjinar. Por udhëtimi që sjell autori përmes personazhit të vet në një muzg të trishtë vdekjeje nuk është dramatik e as i trishtë, personazhi në çdo situatë i bën sfidë vdekjes jo përmes guximit, por përmes përceptimit të thellë psikologjik të kësaj gjendje si një gjendje fluide gati-gati të domosdoshme në të cilin njeriu sheh për herë të parë atë që nuk e pa kurrë në jetën e shëndoshë. Në këtë udhëtim ai sheh në fillim varrin e tij të hapur, më vonë hijet

ngjyrë verdha, do të luajë ose të kërcejë me to dhe përmes një shkallëzimi rritës të forcës artistike nga fundi shfaqet gruaja, fëmijët, ndonjë përronjës, lumi, përroi i andrrave, dashuria... Në momentet e fundit të jetës të dënosh vdekjen me dashuri është misioni më i pamundur, por më i gjetur artistik që vetëm një mendje e hollë krijuese arrin ta bëjë (Unë nuk dua të lë amanete siç lënë të tjerët... Unë shëtit në oborrin e spitalit më Fjollën...)

Dialogjet e personazhit me infermierën dhe mjekun janë të veshura me një tish të hollë ironizues, ai herë ndien frikë por herë moskokëçarje. Dyzimi i tij i brendshëm nuk ka të bëjë me naivitetin e tij, por intelektin e tij mundohet t'i japë kuptim çdo absurdi, çdo gjendje qoftë edhe vdekjes (Vdekja është e arsyeshme, e bukur...)

Autori i vesh personazhit petkun e mortjes me hijet përreth, të vdekurit imagjinarë me sy hapur, por nga ana tjetër personazhi me kujtimet e tij, dialogjet e tij krijon një vorbull ere që orvatet të jetë dhe është triumfuese duke gjerbur deri në grahmen e fundit një arsye për vazhdimësi qoftë kjo edhe përmes një kujtimi. Megjithëse kujton Natën e Varrit, ai ndjell dhe ka aftësinë të ftojë dhe vdekjen në vallëzim.

Tulipanët e verdhë të dikurshëm për dashurinë e tij të vërtetë, Fjollën, dhe prania e të verdhës së Van Gogut në mur, tek infermiera, tek hijet (... kjo vdekje me ngjyrë të verdhë që po i avitet) shihen në dy paralele. Së pari si një forcë e brendshme e shpirtit të tij në luftë me vdekjen, ato hije vdekatare ndoshta nuk janë gjë tjetër veçse penelatë Vangogiane që sjell imagjinata e tij si ngushëllim për të sfiduar mbi mortjen dhe së dyti e verdha e trishtë në këtë shtrat vdekje është dhe e verdha që pëlqejnë dhe lyhen të gjitha muret e spitaleve psikiatrike. Ndoshta në shtratin e vdekjes të gjithë kemi fatin të përjetojmë një kompleksitet të pashpjegueshëm të qenurit nga pak të çmendur dhe frymojmë atë që e jetuam por dhe deshëm ta jetojmë përmes çmëdurisë së skajshme duke i dhënë formë dhe vdekjes.



Fundja kjo botë vdekatare mjerisht është një spital i madh me të sëmure psikikë të babëzitur për t'i dhënë kuptim absurdit jetë. Jo më kot personazhi numëron krevatet (jane shumë...), madje në çdo paragraf të romanit ndihet orvajtja e autorit për të shpjeguar atë që po ndodh... Për të nuk është më e rëndësishme nëse do i shpëtojë vdekjes apo jo, për të më e rëndësishme është të jetë i qartë brenda egos së vet: Pse duhet të ndodhë vdekja? Pse vjen pa e ftuar? A mund t'ia dali? A do ringjallet?

"Tu shmanga dhomës së ferrit, deshi të thoshte, por drita e syve të saj sikur ia rrudhi fjalët..."

As i shkoi nëpër mend se po kalonte edhe nata e pestë, kur pa orën se duhej edhe pak me çelë drita e mëngjesit. Të gjitha netët janë të njësojta, iu dha të thoshte, por veçse ajo të dhoma e rigjallnimit që mashtruese..."

Nëse do rrekeshim të gjenim një vepër krahasuese moderne do kishte disa, por nuk e di pse këto shtatë netë te sprovës së vdekjes me udhëtimin imagjinar të "Shtrati 13", të çojnë tek Dantja, por jo ai udhëtim i botës së përtejme, por një udhëtim midis dy botëve, shtatë rrathët e të cilave janë shtatë netët sflitëse të unit njerëzor, që nga fëmijëria deri tek vdekja me pa dyshim triumfusen gjer në grahmat e fundit – dashurinë, derivatet e së cilës mbeten të përjetshme.

Elementet tjera si mëvetësia leksikologjike, ruajtja me fanatizëm, por pa dëmtuar efektin estetik që krijon shenjuesi si trevë, dialogjet e shkurta, por me një simbolikë dhe nëntekst të fuqishëm i pudrosin kësaj vepre uniken në formë dhe stil.

I erdhi ndërmend se, do ditë para se të vinte në dhomën e rigjallnimit, dikund, në rrethina të qytetit, sytë i kapën një trup pishe, mu në zemrën e një shkëmbi. E zhveshme krejt, rrënjët thuajse i kishin dalë, por prap vazhdon të ruante drejtpeshojën. Kishte marrë ngjyrën e ashpër të shkëmbit, sa vetëm sy të vëmendshëm mund ta dallonin se qe trup pishe. Pakëz më vonë, kur e pa së largu s'i ngjau me një trup pishe, siç iu duk në fillim, por me një vijë uji në shkëmb, veçse ujë s'dallohej kund. Kështu, i ngjau se po ndodhte dhe me të...

Elementet folklorike si këngët e dashurisë, zanat, krijimi i fjalëve të reja, personazhe të përzgjedhur të së shkuarës, por që mbeten thellë në kujtesë si shkrimtarja surrealistë, vajza që krijonte poezi të çuditshme, etj., e bëjnë këtë vepër, vepër të një niveli të lartë artistik dhe me një kahje moderne të padiskutueshme.

Fundi i romanit është kulmi i artit të Shtratit 13. Ai e dënon vdekjen me dashuri dhe kujtimet për të. Shtrati i 13 është shtrati i vdekjes në një dhomë me pesë dritare të një spitali jashtë oborrit të të cilit ecën me hapa të paqtë ai dhe dashuria e tij dikurshme – Fjolla (fjollë ere, fjollë drite, fjollë kuptimësie). Ai u nda me të për një arsye të pakuptimtë, ngjyra e ullinjës e syve, por fundja edhe vetë jeta, vdekja kanë një arsye gati të pakuptimtë që vijnë, ikin por duke lënë zgjuar brenda nesh kafshën që e vetëquajtëm njeri, orvajtjet dhe dilemat e të cilit në luftën për të jetuar mbeten gjithsesi te bukura....

1

Feliksi është drejtor fotografie dhe është e natyrshme që termat që ai përdor kur flet për jetën të kenë të bëjnë me filmin. *Fade in* është kafeja e mëngjesit. *Fade out* është mbyllja e syve për të fjetur. Ngaqë edhe dashuritë e tij kalimtare janë një episod që përsëritet shpesh, edhe seksin e fillon me një “çak”, ashtu siç shkrepet butoni *record* për të realizuar një plan në sheshxhirim.

Kështu ndodh edhe këtë mbrëmje.

- Çak. Dubli i parë. Dashuri me... Si quhesh?

- Barbara.

- Çak. Dubli i parë. Dashuri me Barbarën. Aksion, - thotë Feliksi.

Fik dritën dhe hidhet me kërcim mbi trupin e Barbarës që pret në shtrat, e zhveshur edhe ajo lakuriq që më parë.

Barbara e përfshin në krahët e saj dhe më pas nuk merret më vesh se nga lëvizin duart, si ngërthehen këmbët, si përthithin njëri-tjetrin në një dashuri të rrëmujshme, shoqëruar me klithma gudulisjesh. Gjatë gjithë natës, çaku përplasat dy-tri herë për të shënuar *action* dhe pastaj i zë gjumi.

Kur Feliksi zgjohet, dhoma e hotelit është e tëra errësirë. Perdet e rënda nuk lejojnë të hyjë asnjë rreze drite për të kuptuar se ka ardhur mesdita. Feliksi hap sytë dhe shtrati bosh i shprishur e bën të mendojë se Barbara ka ikur. Kanë kaluar një natë të hareshme, të dallgëzuar si këta çarçafë të zhubravitur.

Feliksi shtriqet me sytë e mbyllur sërish dhe është gati të kthehet në anën tjetër e të flejë, por një dritë e beftë e godet, gati e verbon. Barbara nuk paska ikur. Paska qenë në dush. Ka dalë nga aty, mbështjellë me peshqir dhe gjëja e parë që ka bërë ka hapur perdet e rënda.

- Ora është dymbëdhjetë e një çerek, - thotë ajo, duke u marrë me veten para pasqyrës. Me një krem të lehtë po mbulon të gjitha gjurmët e natës që iku.

- Kujtoja se ishte dymbëdhjetë e mesnatës, - i përgjigjet Feliksi dhe nuk paska qejf të ngrihet nga shtrati. - Ishte një natë e bukur.

Barbara e ndjek zgjimin e tij duke komunikuar me sy përmes pasqyrës.

I buzëqesh.

- Më thuaj të vërtetën, ke gënjer ndonjëherë? - e pyet ajo.

- Shumë herë, - i thotë Feliksi dhe ngrihet, e përqafon me vështrimet mbajtur mbërthyer mbi pasqyrë. - Po nata e mbrëmshme më pëlqeu dhe unë jam gati t'i bëj *playback* kalendarit, ta kthej datën mbrapsht dhe ta jetoj përsëri një natë të ngjashme.

- Jo, - i buzëqesh Barbara. - Nuk e kam fjalën për gënjeshtret në dashuri. Unë e di që dashuria është e gjitha një gjendje e gënjeshtërt. Përderisa humb mendjen kur je në shtrat, ajo nuk gjykohet. Dhe unë as që marr mundimin ta arsyetoj. Por, po shihja veten në pasqyrë dhe mendoja, sa i gënjeshtërt, sa pak i vërtetë është portreti im tani që e pikturoj me gjithë këto kimikate. 26 dollarë krem, 42 dollarë rimel, 17 dollarë të kuq buzësh. Mjaftojnë 85 dollarë për t'u bërë e bukur. 85 dollarë për t'u bërë tjetër njeri. Ha-ha-ha.

- Ti je e bukur në të gjitha rastet, - i thotë Feliksi.

E puth në qafë. Ajo rrëqethet.

Feliksi kalon të gjitha personazhet në objektivin e kamerës, por asnjëherë

botim i ri nga Onufri

BASHKIM HOXHA

Shtëpia e verdhë

fragment nga romani



nuk e ka vvarë mendjen për gënjeshtret që krijon grimi. Për profesionin e tij, e vërteta është ajo që del në film dhe e vërteta duhet të jetë gjithmonë e bukur, edhe pse për të qenë e tillë duhet gënjer.

- Duhet gënjer, por jo rëndë, - i thotë Barbara.

Ajo del në korridor dhe vesh pallton duke u bërë gati për të ikur.

Pastaj, qesh me vete.

- Dhe të mendosh se vetë jeta është një gënjeshtër e gjatë që ne e besojmë si të vërtetë.

- Ik tani. Unë jam i figurës, jo i dialogut. Më lodhin fjalët. Mos ma ngatërro ditën.

Shkëmbejnë edhe një puthje. Ajo ikën, ndërsa Feliksi hyn në banjë dhe lëshon ujin e dushit, ritual i çdo fundepisodi të momenteve që ka kaluar me ndonjë grua, por edhe i çdo mëngjesi kur gdhihet i vetëm.

Në gjuhën e filmit, anglisht i thonë *cut* (prite). Këtu përfundon nata.

Duke u relaksuar nën ujin e ngrohtë, ai mendon se gënjeshtret janë të llojeve të ndryshme. Ka gënjeshtret e bardha. Kështu quhen gënjeshtret pa zarar, kur je i detyruar të dalësh nga një situatë apo të përfitosh prej saj, si për shembull: “U vonova, sepse kishte ndodhur një aksident në rrugë.” Ose kur do t'i prishësh mendjen ndonjë aktoreje, siç edhe ka ndodhur me Barbarën që sapo iku. I ke thënë se ka nurin e Nicole Kidman-it. Pastaj ke bërë sikur je mahnitur me portretin e saj. “Më lër të të bëj një foto, sepse të bie drita bukur dhe kjo dritë rrallë vjen”, - apo siç mund të kishe vazhduar edhe më tej po të kishte zgjatur hezitimi i saj, t'i thoshe se edhe buzëqeshjen e ka si të Sophia Loren-it, duke qenë i kujdesshëm të mos harrosh nënvizimin: “Tamam-tamam si Sophia Loren-it kur ka qenë e re.”

Nga këto gënjeshtret Feliksi ka thënë me shumicë.

Por ka edhe gënjeshtret e zeza, të rënda, nga ato që të nxijnë jetën tënde apo të tjetrit. Jo. Nga këto nuk ka thënë kurrë. Nuk është gjendur asnjëherë në mes të situatave të tilla. Edhe Barbarës, natën që kaloi, nuk i ka thënë asnjë gënjeshtër të tillë, ka pëshpëritur vetëm fjalë fluturake të bardha.

Me Barbarën është hera e parë që takohen dhe nuk ka pasur kohë t'i thotë ndonjë gënjeshtër të zezë. Vetëm të bardha, ja kështu si shkuma, të lehta, të bukura, vezullitëse, krijojnë flluska ngjyra-ngjyra që pëlcastin në ajër.

Premtimin se ajo do të luajë në filmin e tij të radhës do ta mbajë. Barbara është vërtet e talentuar, del bukur në kamerë dhe ka një ecje të fisme për ekranin e madh, pavarësisht nga fjalët që ai i ka thënë për t'i prishur mendjen.

Në filmin për të cilin po përgatitet, Barbarës do t'i hanë mëlçinë korbati e ardhur nga një qiell i plumbtë. Do ta rrethojnë një tufë e tyre dhe do ta çukisin njëri pas tjetrit derisa të zbulojnë përtej gjakut rropullitë, do të përzgjedhin mëlçinë dhe do ta çukisin të gjithë në rrëmujë e sipër, ndërsa ajo do të jetë e lidhur në një shkëmb gjysmë e zhveshur, si dikur Prometeu. Dënimi i saj është sepse u ka vjedhur dashurinë zotave, është arratisur nga qielli dhe ua ka shpërndarë njerëzve. Nga titulli duket si një romancë dhe jo si një film tmerri - *Hajdute e dashurisë*. Barbara është më me fat se Laura. Në filmin e fundit të tij, Laura ishte zhytur në një vaskë me një lëng të tmerrshëm që i hollonte dalëngadalë edhe pjesët e trupit derisa ato treteshin.

Feliksi xhiron filma horror.

Emrin e vërtetë e ka Felice Marzullo, por të gjithë e kanë më kollaj ta thërrisin

Feliks. Edhe në titrat e filmave ku ka marrë pjesë ia shkruajnë shkurt, Feliks di Marzo. Kush ka kohë të lexojë aq gjatë sot! Ëndrra e tij ka qenë të ishte pjesë e ndonjë filmi të madh, me histori të vërteta, por kjo ka ndodhur kohë më parë, kur ishte shumë i ri dhe ende nuk kishte marrë rrugët e botës. Në qytetën e tij të vogël në Kalabri, kinemaja e vjetër me karrige të drunjtë, ajo gropë errësire dhe maja e malit ku ndriçimi i diellit zgjatej deri vonë, ishin dy koordinatat që i tregonin se bota është më e madhe se ajo që shohim. Gjithmonë do të gjendej ose në errësirë në kinema, duke parë për herë të dhjetë filmin e radhës, ngjarjet e të cilit zhvilloheshin në vende të largëta, ose ngjitej në majën më të lartë mbi qytetë, aq lart, sa nga aty arrinte të shihte detin dhe vijën e horizontit. Horizonti ishte larg. Por edhe ëndrrat janë si ai. Larg. Përtej horizontit ka një horizont tjetër. Më pas edhe një tjetër dhe horizontet nuk mbarojnë kurrë. Është e gjatë udha për tek ëndrra. Mund edhe të mos mbërrish kurrë.

Ai ka mbërritur deri te filmat e kategorisë B horror. Ëndrra e një filmi të madh është ende larg, përtej horizontit, nuk është shfaqur. Kjo bota e filmit ka një të keqe të madhe. Po të futi në një listë, është njësoj si të të kenë futur në një burg të sigurisë së lartë. Është e vështirë të dalësh që aty. Të gjitha kërkesat për të vinin për filma tmerri dhe kjo e bënte të ndihej ngushtë. Jo se nuk e bënte punën me pasion, por, po ta mendoje se për ku ishte nisur, i binte që në këtë rrugëtimin e tij drejt ëndrrës ta kishin burgosur në horizontin e tretë. Ëndërronte të katërtin.

Ai do të kishte qëndruar gjatë në dushin që po i lezetonte, por dikush i bie pa pushim ziles së telefonit të tij. Muzika e pëçudnuar e Verdit nga *Kori i skllëvërve*, deformuar në tingëllimin gërvishtës të ziles, pasi bën dy herë pushime të shkurtra, insiston përsëri. Muzika pushon pikërisht atëherë kur Feliksi, lakuriq e i shkumëzuar, mbërrin atje.

Shikon se në telefon është Anita, nga agjencia e tij.

Pasi është lodhur duke i rënë telefonit, ajo i ka dërguar edhe një mesazh. I thotë të paraqitet menjëherë në agjenci dhe ka shtuar: “Gjatë natës që kaloi të ka puthur fati.” Katër palë duartrokite zëvendësojnë pikën.

“Unë kujtoja se më ka puthur Barbara”, - qesh me vete Feliksi. - “Ha-ha. Më paska puthur fati. E sheh? Ja kështu të puth fati, pa e ditur”.

Fati?

Ai kurdoherë kishte besuar se jeta është një film i xhiruar pa skenar. Dimë se si kemi ardhur në këtë botë, por nuk e dimë çfarë rruge do të bëjmë, nuk dimë as edhe si do të ikim. Vetëm ai e di, Fati. Fati është skenaristi që, çfarëdo të ngjasë, ua thotë njerëzve vetëm në sheshin e xhirimit. Ashtu si një kolegu i tij kishte angazhuar katër skenaristë që ndiqnin linjën e katër kalorësve të Apokalipsit në një film, secili nga ne ka nga një skenarist atje lart, që vetëm ai e di se çfarë pëlhere thur tinëzisht me jetën tënde.

Feliksi ishte i bindur se skenaristi i tij kishte qëlluar dembel dhe pa fantazi. Kishte kohë që asgjë interesante nuk ndodhte në jetën e tij.

A thua do t'i ketë dalë gjumi Fatit?

2

Agjencia është gjithmonë e Azhurmshme. Ndoshta për faktin se Anita është e bukur dhe njerëzit shfaqen aty edhe kur nuk kanë punë. Thjesht duan të bëjnë muhabet me të. Anita i sjell të gjithë vërdallë me fjalë të ëmbla. Edhe Feliksiti i ka zgjuar njëherë shpresën se mund të shkonin bashkë, por kishte qenë një shpresë e rreme ose, më saktë, fjalët e gabuara në kohë të gabuar.

“Po porosis sot për darkë në restorantin më të shtrenjtë një tavolinë për dy”, - i kishte thënë njëherë ai dhe e kishte nënvizuar emrin e restorantit më të shtrenjtë, atje ku darkonin yjet.

“As mos e mendo”, - i ishte përgjigjur Anita sapo kishte dëgjuar emrin e restorantit. - “Unë jam vegane. Nuk shkel kurrë në ato vende ku kafshët e gjora i masakrojnë dhe pastaj e gatujnë tërë neps mishin me receta kriminale”.

Ai i kishte thënë se mund të shkonin edhe diku tjetër.

“Me ty? Mos mbaj shpresë kot. Me atë që u bën njerëzve ti në filmat horror, kushedi se çfarë mund t’u bësh kafshëve. Me siguri kur i sheh të shkon ndër mend se si t’i rrjepësh të gjalla. Ato të gjorat janë edhe më të pambrojtura se njerëzit”.

Feliksi është ndëshkuar shpeshherë për faktin se shkëlqimin e ka me filma horror. Ka ndodhur njëherë me një vajzë që e kishte njohur në bar, ajo nuk kishte pranuar ta përcillte në rrugicën e errët, ia kishte krisur vrapit për t’u larguar prej tij para se ai të ekzekutonte ndonjë nga skenat e frikshme, për xhirimin e të cilave kishte marrë edhe disa çmime të rëndësishme.

- Çfarë emri ka fati im? - pyet Feliksi Anitën që, sapo e sheh në derë, i lë të gjitha bisedat e tjera.

- Kevin Johns.

- Kevin Johns? “Oscar”-i i fundit? Nuk po tallesh.

- E kam seriozisht. Producenti Kevin Johns, tri herë nominuar për “Oscar”, një herë fitues, të kërkon në një takim për të të propozuar të marrësh pjesë në projektin e tij të ri.

- Horror?

- Prej horrorit të rrëfyer bukur të ka zgjedhur. Ja që ndonjëherë edhe tmerret të nxjerrin fitimtar.

- Po filmi që kam në dorë?

- Bisedojmë për këtë. Merremi ne me sistemimin. Pa merak. Gëzo fitoren!

Fitorja. Kjo fjalë e huton fare Feliksin. Ai nuk e di ende se çfarë ka fituar. Ndoshta doli në breg, mbërriti në horizontin e fundit të ëndrrës.

I shfaqet imazhi i largët i një kodre mbushur me ullinj me trungje gunga-gunga. Përmes degëve të gjelbra duket deti. Është vendi prej nga nisi ëndrra.

Në fillim Feliksi kishte ëndrra të vogla. Kur të rritet edhe pak, do ta çojë mama Ritën në Disneyland. Ajo gjithmonë i thotë se jetën e ka menduar si përrallë që përfundon bukur, por përrallat i kanë dalë gënjeshtare. Jeta nuk sjell funde të lumtura. Më shumë sjell zhgënjime. Por mama Rita nuk do ta besojë zhgënjimin. Braktis një përrallë dhe kap një përrallë tjetër. Edhe ai e çon përpara ëndërrimin. Do ta hipi mama Ritën në atë rrotullamen e madhe që ngjitet në katin më të lartë të qiellit. Ajo mund t’i thotë se i dhëmbin

kockat dhe nuk shkon dot aq larg, apo të ketë frikë se mos i merren mendtë kur shikon poshtë. Atëherë ai do t’i dhurojë tjetër kënaqësi. Me rrogën e parë do t’i blejë mama Ritën një shall të bukur mëndafshi nga ato që sjellin nga Kina, një shall të madh, aq të madh sa askush nuk e ka parë ende, sa Muri i Madh Kinez dhe do ta mbështjellë të tërën siç mbështjell mjegulla ndonjëherë majën e kodrave aty pranë. Ashtu në mjegull, do ta njohë nga zëri. Nuk e ka njeri tjetër zërin e saj nanuritës. Ndërsa Kristinës, shoqes së bankës, do t’i bëjë një dhuratë më të madhe. Do të martohet me të. Puthjen e parë do t’ia japë në majë të kambanores. Do të ngjiten si gjithmonë nëpër shkallët e ngushta rrotulluese dhe do të shikojnë atëherë se sa të vogla janë shtëpitë, pemët, kodrat dhe sa të mëdha janë buzët e saj aty pranë, janë aq të mëdha, sa kodra e ullinjve në sfond të saj atje larg. Kur ta puthë, do të mbyllë sytë. Me sytë hapur mund t’i merren mendtë dhe të fluturojnë të dy nga kambanorja dhe kur të hapin sytë, ta gjejnë vetën shtrirë mbi bar.

Pastaj vjen ëndrra e madhe. Ajo shfaqet në një ditë me shi dhe është dashur të presin dy ditë derisa të dalë dielli për t’i dhënë udhë. Feliksi ka një xhaxha në Amerikë. Quhet Francesco. Ka një piceri të famshme në Los Anxhelos. Merret edhe me *real estate*. Ka financuar edhe disa filma, producent minor. Në një nga ardhjet e tij, pasi babai i Feliksiti ka vdekur, xhaxha Franko ka

sjellë disa dhurata. Mamasë i ka sjellë një peliçe dimri, motrës një shall të bukur ngjyrë portokalli dhe Feliksiti një kamerë.

Është një kamerë e vogël që ai, në fillim, ka frikë ta prekë.

Ditën që Francesco nxjerr nga kutia kamerën është duke rënë një shi i imët dhe brenda shtëpisë nuk e shijojnë dot të plotë. Kanë pritur dy ditë, derisa doli dielli dhe u ngjiten të dy lart në kodër, prej nga dukej deti. Nën këmbët e tyre ishte fshati dhe ngado të mbinin në sy vrangat e baltës.

“Shiko sa rrëmujë është kjo botë”, - i kishte thënë xhaxha Franco. - “Andej det i kaltër, këtej baltë e pistë, poshtë shtëpi të shtrembëta dhe gjurmë rrotash makinash që kanë spërkatur gjithçka rreth e qark. Po ta shikosh kështu, në plan të gjerë, e tërë kjo botë është e pistë dhe nuk ia vlen, është aq e komplikuar sa të zë koka ta arsyetosh. Kjo botë është e ngatërruar. E ngatërruar dhe e ngarkuar me shumë gjera të tepërta. Është një sferë e madhe e pistë në një katrahurë të madhe ku përzihen pa rend njerëz, kafshë, bimë, ujë, naftë, minerale, oqeanë, kënetë, pyje, shkretëtira, shkëmbinj e baltë. Rrëmujë, e zhurmshme dhe aspak e bukur. Si një gjë pa shije. Por ka një mënyrë për ta shijuar. Shiko këtë kuadrat të vogël këtu në aparat. Vendose syrin aty, shiko vetëm brenda tij dhe asgjë tjetër rreth e qark. Drejtoje këtë vështrim në një gjë të bukur, gjeje aty ku është fshehur në

mes të kësaj rrëmujë të madhe. Shijojë këtë bukuri të paktë që zbulon dhe as mos e konsidero se rreth e qark është një katrahurë pislëku dhe shëmtie që quhet jeta e madhe. Gjej dritën që përkëdhel jo vetëm sendet, por edhe të ngroh shpirtin. Fiksoje në fotografi këtë çast të bukur zbulimi. Kënaqu që në tërë këtë rrëmujë të pazgjidhshme arrite të gjesht një gjë që të ndriçon shpirtin. Pastaj hidh vështrimin kot, me nënçmim, në atë rrëmujë që quhet bota e madhe dhe përbuze, zgjidh përsëri një katror të vogël tjetër dhe kënaqu. Konsidero vetëm bukurinë që zbulon. Harroje çfarë ka jashtë këtij kuadrati. Kjo është shija e vërtetë që i duhet njeriut. Kështu ka filluar ëndrra e madhe”.

Në atë qytezë-fshat në Itali. Atje muzgu zbriste shpejt, por ai ngjitej lart në majë të kodrës për të zgatur sa më shumë çastet me dritë, në kërkim të ngrohtësisë që i jepnin perëndimet e diellit, tek rrëzohej atje tutje në fund të detit. Me këtë rregullin e katrorit që ndante gjërat e bukura nga tërësia e ngatërruar e botës, rrugët nuk ishin më edhe aq të mërzitshme, fenerët krijonin hije të bukura dhe pllakat e trotuarit nuk ishin monotone, si në çastet kur i duhej të tërhiqte këmbët zvarrë, pa ditur se ku donte të ikte. Edhe vajzat e fshatit, po t’u gjeje këndin e duhur, nuk ishin të shëmtuara.

Sytë e Kristinës ndonjëherë shkëlqenin dhe ai përpiquej të zbulonte se çfarë e bënte të bukur dhe me dritë një sy dhe vonë, shumë më vonë në jetë, u trishtua kur kuptoi se më të bukur sytë i bënte loti. Por nuk ka vetëm lot trishtimi. Ka edhe lot gëzimi dhe ata janë më të ndritshmit.

Në një nga ardhjet e tjera, xhaxhai u mahniti nga fotografitë që kishte bërë Feliksi dhe i kërkoi mama Ritën ta merrte me vete në Amerikë për ta regjistruar në një shkollë filmi.

Mama Rita e përcolli dy muaj më pas, me sytë e ndritshëm që nuk e ndaje dot nga se, nga trishtimi apo nga gëzimi. E përqafoi fort. Loti i saj i nxehtë u rrokullis mbi faqen e tij si një përkëdhelje e ngrohtë.

- Ndiq ëndrën tënde, bir, - i tha ajo.

Mama Rita nuk e dinte se ëndrra e tij e parë ishte ta ngjiste atë në katin e lartë të qiellit. I erdhi për të qeshur me këtë ëndërr që kishte pasur. Tashmë ishte rritur.

Edhe mama Rita fshiu lotët me cepin e mëngës së fustanit të saj të zi me lule të vogla të bardha dhe qeshi kur ai i tha këtë ëndërr të çmendur.

Ky ishte momenti i fundit që ata u përqaftuan. Pastaj në mes tyre hyri deti, më pas oqeani.

Katër vjet më parë, kur mama Rita kishte vdekur, Feliksi nuk i shkoi dot në varrim. Kishte qenë duke xhiruar në Meksikë filmin e tij të tretë horror, një histori takimi me alienët vrasës, për kohëzgjatje, në një ritual të ditës së të vdekurve.

Xhaxhai i tij ka mundur ta përfshijë në disa filma të miqve të tij producentë dhe Feliksi ia ka shpërblyer. Ka korrur disa fitore të vogla, por janë pak, vlejnë vetëm aq sa për të mbajtur veten në lojë.

Ndoshta fati i vërtetë i vjen tani, kur duhet të marrë pjesë në ekipin e një filmi të madh, epik, nga ata që di të bëjë Kevin Johns-i i famshëm.

Një ftesë e tij është si një ftesë në gostinë e mbretërve.



Kënga e një poeti kosovar

Unë jam poet kosovar.
Plakem shpejtë.
Mund të shpërthejë në çdo çast.
Ne mes erës së barotit
Të ardhmen e ftoj në shtrat.
E fus surratin në pjatën e
Absurdit dhe e pi.
Liria nuk më duhet.
Lufta më përdridhet para
Syve, ma bën me gisht
Dhe heq rrobat e veta
Ngadalë duke më provokuar.
E shoh nga distanca dhe
Dal në ajër të pastër.
Më vjen të qaj por nuk mundem.
Më vjen të bërtasë por nuk kam zë.
Une jam poet kosovar.
I keqkuptuar nga atdheu.
I përndjekur shpirtërisht nga
Moralizuesit dhe paqebërësit.
Miqtë e mi të vërtetë
Janë fantazma të gjalla,
Tiktaket e zemrave të tyre
Prishin gjumin e bebeve.
Jam poet kosovar.
Plakem shpejtë.
Pi shumë.
Durimtar i madh.
Nuk gëzohem për asgjë,
Nuk bëj tifo për askënd,
Nuk pres asnjë lajm,
Rri i frikësuar përballë lumturisë
Si një kafshë e rrahur
Nga fëmijët e Adamit.

Një poezi

Jam Shpëtim Selmani.
Motherfucker i shkencës së njohjes
njerëzore.
Endacak bastard i rrugëve ku u vra shpirti.
Dhe nderi. Dhe turpi. Dhe faji. Dhe
arsyeja.
Po endem atypari.
Unë dhe macja
Pa sy e Edgar Allan Poe-së.
Ende kam mundësi të bëj marrëveshje
Të fshehura me veten.
E vetmja lumturi në duar.
Po merrem me teatër. Teatri
Tjetër, dhuratë nga perënditë
Është një shfaqje pa shije
E mbipopulluar nga aktorët e këqij.
Jam kundër të gjitha qeverive.
Jam kundër të gjitha bashkësive atdhetare.
Dhe lirisht mund ta përdhosni
Idenë time sakate, e cila qëndron e varur
Nëpër shtyllat elektrike.
Shkruaj poezi. Kohëve të fundit
Më duket se të gjitha janë të njëjta
Dhe habitem me veten pse nuk
Heq dorë nga kjo gjë.
Por kur ndalem e mendoj
Mendja e qenies njerëzore
Është një shkëmb fanatik
Që duhet të çahet në dysh.
Kam vibrime të frikshme kur
Gjëra të liga më rrethojnë.
Në mes errësirës rri i heshtur,
Vështroj dhe ha thonjtë.
Jam romantiku i fundit
Hedhur si copë trëndafil
Në planetin e pajetueshëm.
Shel Silverstein është
Miku im më besnik,
Ngase nuk e njoha kurrë.
Jam Shpëtim Selmani.

botim i ri nga Onufri

SHPËTIM SELMANI

Kureshtje dhe terror

poezi

Edhe nëse nuk do të isha
Nuk do të kishte farë rëndësi.
Fund e krye i rrahur nga
Grushtat e realitetit.
I dëbuar politikisht.
I urryer nga bombëkurdisësit.
I bekuar nga një grua
Dhe tragjikisht i zbatuar në
Fushën e madhe të prushit.
Përgjithmonë hajvan vetmitar duke i
dhënë
Botës diçka, për të cilën ajo nuk
Ka fare nevojë.
Një poezi.

(Të rrosh apo mos të rrosh, kjo është çështja.
Çfarë çështje, përgjigju i dashur
Çështje politike - Wislawa Szymborska).

Unë po zvarritem mbi një pëlhurë të kuqe
politike,

po futem në gojën e njeriut politik dhe po
ndiej se
si po kullufitem nga goja e madhe e një
shoqërie politike.
Kam nisur të çmendem politikisht kur
zgjohem
mëngjeseve nga mijëra thirrje të fshehta
brenda
kafkës sime të çarë politike.
Kam humbur sensin normal për të
vlerësuar gjërat
dhe jam bërë një kafshë e gërditshme
politike,
ngase brenda secilit tru gjendet një sovran
mizor,
ngase brenda secilës mendje gjendet një
mbretëri mistreçe,
një mbretëri e ashpër politike.
Përsëritjet e rëndomta njerëzore nuk
janë asgjë tjetër
pos lojërë të rrezikshme politike.
Mirësjellja elementare nuk është asgjë
tjetër
pos një sjellje politikisht e menduar mirë.

Shpëtim Selmani
Kureshtje dhe terror

OnufriPoezi

Sëmundjet janë fund e krye politike.
Dashuria është çerdhe e zogjve politikë.
Puna si veprimtari e ndershme njerëzore
është pasojë e një qëndrimi korrektësisht
politik.
Dinjiteti është mbeturina e lashtë
njerëzore
që sot kujtohet politikisht.
Arti është neveria e nderit politik.
Asgjë nuk është e dobishme nëse nuk
është e konstruktuar politikisht.
E ardhmja e secilit është preokupim
politik dhe jo njerëzor.
Shpirti është fundërrina e fundit politike
dhe madje çuditërisht sustat e krevateve
kërcasin politikisht nëse mbi të
këndojnë dy qenie të shkreta jo-politike.
Humaniteti është relik i dikurshëm i një
historie politike.
Intelekti i shërben të keqes politike.
Ajri është ushqim politik.
Vdekja është politike.

Do të sundohe mi nga
krimba politikë
dhe kështu do të pushojmë
përgjithmonë në një
paqe të nëndheshme politike.

Kur ndihem i lumtur, më vjen turp nga
vetja
Por ama megjithatë ia dal të mbes i tillë
Për disa çaste derisa nata të bjerë dhe
Mendja të më shkojë te mënyra se si
zgjohesh
Nga gjumi. Se si shkruan diçka
Në fletoren tënde, diçka për mua,
Diçka për veten,
Për Tom Waits-in apo për ndonjë mister
Që nuk ma lëshon në duar ngase
Ti e di që nuk ka diçka më të frikshme
Dhe njëkohësisht më hyjnore
Se sa ajo që e gjuan në duart e mia,
Për shembull, kur kujtoj kokën tënde
Në shuplakën e dorës së majtë,
Jam gati të heq dorë nga të gjitha poezitë.

Shpirt, kur të përçolla, ti ktheve kokën
Dhe ma bëre me dorë ndërkohë unë
Në heshtje futa gishtat e mi në gojë
Dhe të ndjeva tmerrësisht.

Më pas më erdhi keq që ishim njerëz dhe
Shpirt, ti nuk e di se sa shumë
Qava.

Në ditën e madhe të dashurisë do ta
marrim vesh që nuk duhemi,
Politikanët ekzekutojnë politikanët tjerë,
Gjithçka ka të bëjë me dashurinë,
Shtetet zhdukin nga faqja e dheut shtetet
tjera,
Gjithçka ka të bëjë me dashurinë,
Artistët hanë në dhëmbë artistët tjerë,
Secila turmë ka dhomat e saj të dashurisë,
Demokratët vrasin demokratët tjerë,
Ata e dinë se dashuria është ligji më i lartë
hyjnor,
Bukëpjekësit fusin në furrat e tyre
bukëpjekësit tjerë,
Gjithçka ka të bëjë me dashurinë,
Luleshitësit fusin lule në bythët e
luleshitësve tjerë,
Trëndafil, e vetmja shenjë e dashurisë,
Intelektualët vriten me thikë pas shpinë

nga intelektualët tjerë,
Dashuria lulëzon pas vrasjes,
Revolucionarët vrasin revolucionarët
tjerë,
Ata e dinë se të dashurosh është shumë
lehtë,
Gratë vrasin gratë tjera,
Në emër të dashurisë ata bëhen më të
bukura,
Burrat vrasin burra tjerë,
Në emër të dashurisë ata bëhen qesharakë,
Kafshët shkelin me këmbë kafshët tjera,
Dashuria është dekor mahnitës i të gjitha
krijesave dhe
Romeo mbeturinë historike e dashurisë,
Shekujt vrasin shekuj,
Kohërat vrasin kohëra,
Mendimet vrasin mendime,
Gjithçka në emër të dashurisë ndaj
diçkaje.

Nuk jemi asgjë tjetër pos viktima të mjera
politike,
Gjendur nën identitete të llojlojshme
shtypëse,
Që e hamë në dhëmbë ekzistencën e
tjetrit.
Nuk ka më asnjë shtypës për një poezi të re,
Asnjë dashuri njerëzore, për ditën që po
vjen,
Kemi mbetur në fushën e zjarrit të ferrit
logjik,
Mbështjellur me flamujt tanë të dhunës
Dhe me bërtrimat tona të heshtura, në
drejtim të
Qielit mbushur me pamflete ideologjike.
Ndëshkuar të jemi të ndryshëm për aq sa
Jemi ndëshkuar të jemi të njëjtë.
Të vrarë nga arma e nevojës.
Të shpuar nga thika e lavdisë.
Të turpëruar para luftërave.
E gjithë çfarë jemi është gjithçka çfarë
Nuk është tjetri dhe gjithë çfarë është
Tjetri, nuk është ajo që duam ne.
Çdo atdhe është i përdalë,
Nëse fëmija i bukur,
Brenda gjoksit të tij
Vetëvritet.

Përderisa dikund lexohen poezi nëpër
mbrëmje të ndryshme
Mua mund të më gjeni në oborrin e
shtëpisë sime në fshat
Duke ndjekur një top, në mbretërinë e
erës.
Apo duke larë e fërkuar veturën e babait
që e deshi aq shumë.
Poezitë janë të domosdoshme për mua.
Dhe jeta nuk ka se nga t'ia mbajë përderisa
verbëria
Është jashtë çdo rregulli dhe jashtë secilës
ditë.
Ja, rreth meje zogjtë e pulës hanë vargje
nëpër fije bari.
Dhe unë kënaqem, trishtohem, mërzhitem,
gëzohem pranë
Kapitullit të ri njerëzor.

Një vashë e re ende me buzët qumësht
puth
Të dashurin e saj. Lëmon flokët e tij. Ia
rregullon jakat

E palltos, e përshëndet dhe ia çon gishtin
e mesëm
Me dashuri.

Pastaj të gjithë ata sy të bukur më
Përpijnë mua.

Natyrisht më nuk e kam të lehtë as unë.

Sall do të më mbetet në kujtesë valëvitja
e flokëve
Në erë përderisa tretet
Në betejat e ardhshme, që e presin vetëm
atë.

2015, *Morenë, Prishtinë.*

Të gjithë më duan.
Gruaja ime. Djali im.
Familja. Miqtë.
Njerëzit e panjohur.
Burrat që pinë. Atdheu idiot.
Qentë e rrugës. Macja e komshiut.
Serbët dhe amerikanët.
Shkrimtarët dhe ëndrrat.
Të dobëtit dhe egocentrikët.
Të gjithë më duan.
Fanatikët fetarë.
Nacionalistët e tërbuar.
Librat dhe magazinat e mbushura
Me vasha të zhveshura.
Të gjithë presidentët qesharakë.
Të gjithë rekuiziterët e teatrove.
Kamerierët. Gjellëbërësi.
Djali dhe shoferi agresiv.
Armiqtë dhe librashitësit.
Të gjithë më duan.
Edhe ata që nuk kanë lidhje me këtë punë.
Edhe ata që janë shëmtuar nga urrejtja.
Edhe ata që e kanë gjoksin mbushur me
zjarr.
Edhe ata që hakmarrjen e kanë në zemër.
Unë jam vend i sigurt për të dëshpëruarit.
Unë jam vend i sigurt për të zhgënjyerit.
Unë jam vendi i vajit njerëzor.
Unë jam pema e djegur në mes turmës.
Të gjithë më duan

Dhe një ditë
Do të çmendem pikërisht
Nga ky shkak
Sublim.

Prizren, 30.06.2017

Mbrëmja bie si një armatë gjakatare.

Plaku hedh pallton mbi supe.
Heshtja dashuron esencën e gjetheve.
E nesërmja pastron fytyrën dhe rregullon
flokët.

Ajo që shkon, nuk kthehet kurrë.
Dritat e shtëpive shtohen.
Rruga mbushet me djersën e fëmijëve.
Egërsira sheh gjithmonë tinëz.
Njeriu, është lodra e perëndive të lumtura.
Dhe pastaj gjaku dhe vuajtja dhe dhëmbët
Dhe thika dhe fjalët dhe puna dhe e
ardhmja
Dhe muti dhe kombet dhe ooh, ajo
Ushtimë e zemrave në pyllin e realitetit.

Përderisa bota është në flakë dhe
Trauma e luleve është epoka jonë e
lavdishme dhe
Njerëzit heqin dorë nga shenjtëria e tyre,
Unë merrem me *Jack Micheline* dhe njëjtë
sikurse ai
Preokupohem me vërtetësinë e gjetes
në erë.
Jam i pafat në lojën e madhe të
mediokritetit,
I mjerë në fushën e kalbur të politikës dhe
I marrë pas vargut, që si thikë ngulet
Në gjoksin e patundshëm të realitetit.
Të realitetit prodhuar nga pushteti,
Gazetat, televizioni, atomet, dhuna, Zoti,
Konferencat, pislëku, frika dhe
nëndetëset.
Asnjë përkëdhelje e vetme në kopshtin e
së ardhmes.
Asnjë shtëpi e banueshme në këtë

provincë qiellore
Që rëndomtë dhe thjesht sikur pas një
gromësire
E quajmë botë dhe përsëri tokë dhe
përsëri planet dhe
Përsëri xhungël teknologjike dhe përsëri
ëndërr në rrokullisje.
Dhe më vjen keq i dashur *Micheline*,
Nuk ka më humor që buron nga dhimbja,
Nuk ka më diell që shkundet prej nesh.
Ka një dashuri të vetme që quhet arratisje.
Drejtë një mjegulle që po ashtu
Është në kërkim të funksionit të saj.
Të humbur dhe të kotë.

Lirit

Bir,
Para së gjithash unë jam *beatnik*.
Që ta dish njëherë e mirë,
Jam njeriu më i fuqishëm në botë.
Kodrat i rrafshoj dhe asnjë atdhe
Nuk do ta lejoj që ta hedhë rrjetën
E madhe mbi lirinë tënde.
Shtëpia jote quhet Tokë dhe në çdo
Cep të saj mund të jetosh,
Mjafton t'i duash lulet dhe ta ndihmosh
Secilën gruan e cila ka nevojë për ty dhe
Të lirosh krijesa nga kafazi,
Sa më shumë që të mundesh,
Mjafton të pish me njerëz dhe t'i
Puthësh të gjithë, pa asnjë përjashtim.
Unë jam babai yt dhe ti je djali im,
Kështu kanë dashur fatet,
Rastësitë dhe dashuritë,
Jam tridhjetë e një vjeç,
Përgjithmonë i madh dhe i gatshëm
Për të rrënuar ideologjitë, që
Dalin në rrugën tënde, tinëzisht.
Pra mos e valëvit asnjë flamur,
Mos e jep jetën për asnjë atdhe dhe mos
U bëj rob i asnjërit religjion.
Krijojë veten vazhdimisht dhe
Bëhu dhurues dhe dhuratë,
Rri gjithmonë një
Qenie e frymëzuar dhe
*Plotësoje nevojën e ngutshme që
Kishe për vetveten.*¹

¹ sipas *Jean Paul Sartre*.



o gjemb pse ti në trëndafil

përse të duhet gjak i dashurisë

thuaje

vura dorën në kraharorin tim
dëgjova të rrahurat e zemrës time
si zhurma e hapave të një kalimtarit
të panjohur
kushedi dhe sa rruge ka për të bërë
kushedi për ku do shkojë

kur të ikesh më thuaj
ta di pse do vdes

në të gjitha kohët
piramidat janë piramida

aty ku ka piramida ka dhe skllëvër

skllëvërit hera herës bëhen edhe turistë
turistët mahnitën kudo që shkojnë
mahnitën dhe me piramidat që kanë bërë
vetë

e vjetra është thelbi
formë është e saja

jo vetëm dikur
mumjet kanë qenë faraonë

nesër në muzg do vdes si tingull muzike

gishtërinjtë e kujt do luajnë në piano

çditë e bukur do jetë

çdo mëngjes shkoj tek kutia postare

gjysmën e planetit do falja
vetëm për një letër dashurie

çdo mëngjes dhe ajo tek kutia postare
shkon

gjysmën tjetër të planetit
edhe ajo do e falte
vetëm për një letër dashurie

a ka më njerez që dashurojnë

kam kuptuar se nuk më duan

dhe unë rri vetëm si Zoti
edhe Zoti vetëm rri them

e ndjej se i dua

dhe prap unë rri vetëm
edhe Zoti vetëm rri them

veçse Zoti është i padukshëm
veçse Zotin e kanë frikë të gjithë

po unë jam i dukshëm
dhe hera herës më fusin frikën



XHELAL TOSKU

O gjemb, pse ti në trëndafil

trëndafilat në kopshtin tim
i kam mbjellë qysh vjeshtën që shkoi

ketë viti skuqin gjak

përjetësia i mban në gji
si nata yjet

vetëm unë jam i ikshëm

në katund unë
si bari buzë rrugës

i pa vënë re prej askujt

piklat e vesës kanë rënë natën

s'dihet se kur ndoshta
ka me m'ardhe e dashura e fillimit
me e fillu jetën nga fundi

mos harro se edhe ti je njeri
bëjmë edhe ne si në Romën e lashtë
ti këndojmë në kor
presidentit tonë
kryeministrit tonë
ministrave tanë
deputetëve tanë
gjykatësve
prokurorëve
noterëve
bankierëve
mjekëve
policëve
tregtarëve
bashkiakëve
këshilltarëve tanë
gjithë politikanëve tanë të medhenj dhe të
vegjël
kudo që janë
se mbase kujtohen

miku im të them një sekret
unë nuk do pranoj të ringjallet

nën dhe' një perandori e tërë pret të
ringjallet

mbi dhe' një perandori e tërë hedhur në
lufta gjithë gjak

të lutem Zoti im
shihe një herë sa shkoi ora

mbi tavolinë qelqja me ujë trëndafil

dora jote
goja jote

qelqja me ujë trëndafil

asgjë nuk po them për ty

me ra qelqja nga dora
m'u thye qelqja copë e çikë

sikur m'u thye shpirti

mblodha me mund gjithë copat dhe çikat
bëra t'i ngjisja copat dhe çikat

më nuk u ngjiten

shpirti si qelqja
qelqja si shpirti

ç'është gjithë kjo ngjashmëri

nuk po them asgjë për ty

dimër verë të gjithë lumenjtë rrjedhin
rrjedh edhe lumi im Shkumbin

nuk është se shkojnë kundër rrjedhës
vetëm njerzit
kundër rrjedhës shkojnë edhe peshqit

sipas Shekspirit peshkun që ha krimbin e
ha mbreti
po në fund fare krimbi ha mbretin

vetëm peshkun e ngordhur që shkon pas
rrjedhës nuk e ha askush

kete e di çdo peshkatar i lumit tim

lëkundet në lumturi bar i gjelbërt i
livadheve

kushedi ç'fjalë dashurie i pëshpërit era

Në Apolloni

August, prej këtu u nise
u bëre perandor i Romës
perandor i gjithë perandorisë romake
perandor i gjithkujt
po jo i imi
as tani as atëherë

fill pas krismës së thatë
thëllëze e gjorë u shkëput prej fluturimit
të ëmbël

kishte ardhë njeriu të dëshmoje se është
vrasës

unë nuk kam një zemër prej dru arre
unë nuk kam një zemër prej guri
unë nuk kam një zemër prej alabastrit
unë nuk kam një zemër prej dru panje
unë nuk kam një zemër prej qeramike
unë dua të rri me ty dhe s'di si ta them

qyteti u ndërtua i gjithi prej fillimi
rruget kanalizimet pallatet vilat motelet
hotelet
çerdhet shkollat universitetet ndërtesat
bashkiake kinemate teatrot semaforet i
gjithë ndriçimi
pritet tani të vij në njerëzit dhe ajri

nata me qiellin plot yj që digjen
qelq i verës zbrazur krejt
me kokën vendosur mbi duart në tavolina
lokalesh ky vetmitar nate mund të isha
dhe unë
nëse nuk do më kishte mposhtur dashuria
çfare do më mposhtte tjetër

ashtu si erdhi dimri shkoi
në luginë dëborë ka lënë gjurmët e saj në
mërmërimën e burimeve
pas çdo shkurreje mëllenja e zezë më
shkund nga monotonia

unë vij nga katundi me male pyje dhe gurë
nga katundi me përrej fusha dhe livadhe

unë jam unë
katundi është katund

në ditet kur katundi bëhet shurdh
unë behem memec

edhe kur zbret errësira ndër ne
ne nuk i mdryshojmë të vërtetat tona

katundi bëhet memec
unë shurdh

dihet unë vij era dhe'

Botim i ri nga Minerva

EMERSON

Vetëbesimi

Përktheu Granit Zela

Gjatë gati gjysmë shekulli që nga shfaqja në skenën amerikane si një zë origjinal i besimit kombëtar në individualizëm, optimizëm, natyrë dhe reforma sociale, fjalët e Ralph Waldo Emerson-it (1803-1882) nxitën bashkatdhetarët e tij të aspironin për një nivel ideal të mendimit njerëzor dhe aftësi veprimi të paimagjinueshme për brezat e mëparshëm të amerikanëve. Emerson mbajti gjatë jetës së tij rreth një mijë e pesëqind leksione publike për filozofinë, jetën amerikane, historinë letrare, natyrën dhe kulturën, si dhe shkroi një mori esesh mbi tema të ndryshme, si vetëbesimi, miqësia, dashuria, politika, karakteri, fuqia, pasuria, pjesë e kësaj përmbledhjeje me shkrime të zgjedhura.

Vetëbesimi (1841) përbën një nga tekstet themelore jo vetëm të vendit të tij, por të historisë dhe kulturës në përgjithësi. Besimtar i patundur te jokonformizmi, Emerson kremton individin dhe thekson vlerën e dëgjimit të zërit të brendshëm unik te secili prej nesh, edhe kur ai sfidon pritshmëritë e shoqërisë.

Ky vëllim përmban edhe një parathënie për trashëgiminë e jetës dhe veprës të Emerson-it si dhe ligjëratën e famshme të mbajtur në Kembrixh, *Dijetari amerikan* (1837), një thirrje për një brez të ri studiuesish që të shkëputen nga varësia e tyre nga imitimi i modeleve klasike dhe europiane në artin dhe mendimin e tyre. Oliver Wendell Holmes, i cili ishte i pranishëm, e quajti "fjalim madhështor" dhe "deklarata intelektuale e pavarësisë".

"Pse gjithë ky nderim ndaj Alfredit, Skënderbeut dhe Gustavit? Le ta marrim si të vërtetë që ishin të virtytshëm; a u sos kjo virtytshmëri tek ata? Ashtu si ata ndërmoren veprimet e tyre publike dhe të njohura, e njëjta gjë varet nga veprimet tuaja individuale sot. Kur veprimet mbështeten në pikëpamje origjinale, shkëlqimi i veprimeve të mbretërve kalon te veprimet e kalorësve. Bota ka mësuar nga mbretërit, të cilët i kanë hipnotizuar kaq shumë kombet. Nga këto simbole vigane kemi mësuar nderimin e ndërsjellë që njeriu duhet të ketë për njeriun".

Nga eseja *Vetëbesimi*

RALPH WALDO EMERSON

Vetëbesimi

Ile et il signifiant

Minerva

Kështu ishte Sif Jani i Shpatit. Një goxha burrë i mbushur dhe i gjatë, me pëllëmbë sa të një putre ariu të rritur, dhe me një fytyrë që rrezatonte mirësi e qetësi.

Ky Sifi na jetonte në një masiv turistik afër Elbasanit. Pas shtëpisë së tij fillonte një pyll i madh me dru halorë. Kishte aty edhe lisa e disa dushqe të vjetër që varreshin më poshtë tek ajo faqe mali, dhe që i jepnin më shumë hijeshi gjithë zonës deri aty ku fillonte të frymonte qyteti. Sifi kishte vetëm një nip e një mbesë me të vogël. Së bashku me Marien, gjyshen e tyre, kujdesej për ta si një prind i vërtetë. I biri, Veniamini, ishte refugjat në Itali që prej disa vitesh. Kishte bërë dokumentet për bashkim familjar dhe priste dita-ditës lejen nga ambasada. Por jetesa ishte vështirësuar. Të gjithë jetonin me të ardhurat që vinin nga përtej detit. Toka e mbjellë rreth shtëpisë bënte pak zarzavate e prodhime stine. Kohën tjetër Sifi e kalonte në pyll. Atë e njihte mirë. I dinte çdo dhëmbë e dhëmballë. Shkonte për gjueti me të cilën siguronte pak mish kafshësh të egra. Po shtëpia nuk mbahej me ato.

Bëheshin pesë frymë.

Një ditë prej ditësh mori me vete edhe Stefanin. Nipi i lutej vazhdimisht, por Sifi e konsideronte këtë «punë me rrezik». Bëri si bëri dhe nuk ia prishi atij. U nisën gjysh e nip herët. Ai me armë gjahu në krah dhe i vogli me një shkop në dorë. Ecën nëpër monopate. Bora kish ditë që kish shkrirë e bardhësia i mungonte këtij peisazhi. Pastaj ngjitu në një kodër e zbrit në një lirishtë. Kështu bënë deri afër dreqës.

Ishin përballë një shkëmbi. As njëqind metra larg. Sifi bëri me shenjë që të ndalonin.

- Është me rrezik, - tha Sifi ngadalë për nipin nëntëvjeçar. - Atje tej, në shpellën që duket nga këtu, jeton një arushë me këlyshin e saj. Ai është shumë i vogël. Ka ardhur në jetë vetëm dy javë më parë. Mezi lëviz. E ëma del për ushqim këtu rrotull dhe kthehet shpejt. I jep që të pijë. Pastaj del sërish. Kështu bën derisa vjen nata.

- Gjysh, a nuk e marrim në shtëpi që edhe ta rrisim? - pyeti krejt papritur vogëlushi. Sifi e pa drejt e në sy nipin. Nuk dha përgjigje. Hodhi hapin e zbriti më poshtë duke rregulluar armën në sup. - Të lutem, gjysh, ma plotëso këtë dëshirë.

Sif Jani qëndroi përsëri dhe përsëri e pa drejt e në sy Stefanin.

- Është me rrezik, o nipçe. Arusha na shqyen që të dy. Bishë. Nuk mund që t'ia marrësh këlyshin asaj. Ajo duhet të jetë këtej rrotull. Ne duhet të lëvizim tani, nëse nuk duam që të përballemi me atë.

Nipi uli sytë. Zbriti edhe ai duke hedhur me kujdes hapat e vegjël.

Sifi e kapë për dore dhe nxituan derisa u futën në një lirishtë, që ngrihej përtej një kodrine të butë. Në shtëpi u kthyen pasdite vonë. Për ariun dhe arushin e vogël nuk u fol më. Stefani rrinte dhe ndihmonte nënën, me tri dhi e një grusht delesh që mbanin në vathë, aty në fund të shtëpisë. I kishin për qumësht dhe për të bërë pak djathë, gjalpë e kos. Sifi ishte gjithmonë mysafir i pyllit.

Dhjetë ditë më vonë Stefani kishte ditëlindjen. U duk se të gjithë e kishin harruar. Atë të shtunë në mëngjes, gjyshi tha se po zbriste në qytet. Fani mendoi: «Ah, sikur të më binte ndonjë dhuratë!» Kishte marrë delet e dhitë dhe kishte zbritur në Fushëkuqe. Kështu quhej ai vend poshtë qytezës atje në male. Aty vinin edhe moshatarë të tjerë. Ishte fundjave, dhe fëmijët rrëmbeheshin edhe pas ndonjë topi. Në mbrëmje djali i vogël e mblodhi bagëtinë dhe e futi në vathën e tij. Ndërsa mbylli lesën, përpara iu shfaq një arush shumë i vogël që mezi e mbanin këmbët.

Në një çast qëndroi. Nuk mund t'u besonte syve. Pastaj... pastaj e mori në duar. Kafsha e gjorë dridhej. Dukej se kishte ftohtë. Lëvizte turirin e vogël me sytë gjysmë të mbyllur në gjoksin e djalit.

Te dera e shtëpisë u shfaq Sifi.

- Gjysh, gjysh, - klithi Fani dhe vrapoi me arushin e vogël në duar.

E ngriti pak lart sikur donte që t'ia tregonte.

Ndjehej tepër i lumtur

- Është dhuratë, - tha Sif Jani. - E bleva në qytet.



ARIU I VOGËL

Tregim nga Aleko Likaj

Por Fani nuk u zuri besë fjalëve të gjyshit. Ai e kuptoi se ky arush ishte marrë në strofullën e arushës, atje përtej pyllit. «Gjyshi ka rrezikuar. Këtë e ka bërë për mua».

Asnjëherë nuk e pyeti më që prej asaj dite se, si e kishte marrë arushin e vogël. Por edhe Sifi nuk shkeli më në pyll. As që u largua edhe nga shtëpia. Menjëherë kafshës së vogël iu afrua qumësht, madje edhe një biberon fëmijësh që kishte mbetur prej vitesh, kur ishte e vogël Saveta. Pas një muaji, vetë Stefani përgatiste përshesh me qumësht në një pjatë të thellë dhe ia vinte përpara arushit. Në fillim ky i bëri disa naze, por pastaj e lëpinte shpejt e shpejt, duke mos lënë asgjë aty. Atëherë Fani i jepte për të dytën herë dhe përsëri... deri sa ngopej. Në muajin e katërt arushi hodhi trup e u bë si i shtëpisë. Një gjuetar, mik i Sif Janit, që kaloi natën aty, tregoi se arrusha nënë ka vuajtur shumë. E ka kërkuar krijesën e saj kudo. Në pyll vetëm britmat e saj dëgjoje. Të këpuste shpirtin. E thërriste fëmijën e saj, ashtu siç bëjnë nënat tona. Kërkonte gjurmët, por Sifi si gjuetar i vjetër, i kish humbur ato. Duhet të këtë kaluar ujëra, përpara se ta sillte në shtëpi. Veçse aty humbasin ato.

Stefani nuk e harroi këtë. Madje edhe në ëndërr i shfaqej arrusha nënë, ndërsa krijesa e saj rritej çdo ditë... Ishte bërë si një mik e shok i mirë për të vegjëlit e asaj shtëpie, por edhe për më të mëdhenjtë. Gjithë ditën sillej nëpër shtëpi e luante brenda oborrit. Kjo lloj «lumturie» nuk do të zgjaste shumë. Nga Italia sapo erdhën edhe dokumentet e bashkimit familjar. Ambasada italiane lajmëronte se duhej të paraqiteshin atje për të marrë edhe vizat, të gjithë familjarisht.

Po me arushin çdo të bëhej?

- E kërkon një miku im poshtë në qytet, - tha një natë Sif Jani.

Atë mbrëmje nuk foli më njeri për arushin e vogël. Fani vuri hall. Mendjen tek arushi e kishte. Nuk hëngri as dreqë e as darkë. Ashtu ra për të fjetur. Por gjumi nuk e zuri deri në agim. Rrotullohej nëpër shtrat. Sifi e shikonte, por nuk i fliste. E kuptonte se nipi po vuante. Fëmija duhej të merrte një vendim. I përkiste atij, sepse djali e kishte kërkuar arushin. Ishte kujdesur për atë si për vëllanë më të vogël.

Kaloi dhe ajo ditë, kaloi dhe një tjetër. Tashmë në Tiranë ishte marrë edhe viza në ambasadën italiane, madje ishte planifikuar edhe orari i tragetit që do t'i çonte drejt e në Ankona. Aty afër punonte edhe babai i Fanit, Veniamini, në Rimini. Vogëlushi ende nuk kishte vendosur se çdo të bëhej me arushin. Sifi ishte bërë vuv. Mirë që do t'i ikte nipi, nusja dhe vajza e vogël, por edhe arushi do t'i mungonte këtë herë. Ishin mësuar që të gjithë në shtëpi me kafshën e pyllit.

- Gjysh, - tha Fani në mbrëmje, - po sikur ta lëmë të lirë? Të shkojë tek nëna e tij. Më duket se ne kemi bërë gabim që e morëm prej saj. Këtu ai i ka pasur gjithë të mirat dhe ne kemi

menduar se nuk i ka munguar asgjë, por nënën nuk ia kemi zëvendësuar.

Sif Jani, i heshtur, i vendosi nipit pëllëmbën mbi kaçurrelat e zeza.

- Po... e kemi ndarë. Mbase nuk duhet të bënim kështu...

Në mbrëmje erdhi përsëri gjuetari si mysafir.

- Kam gjetur një treg për arushin tuaj. Janë një grup ciganësh atje poshtë buzë qytetit, në Elbasan dhe më thanë se e blejnë sa të kërkosh ti. Kjo është mirë për ju, se edhe hiqni shpenzimet e biletave për në Itali, por edhe ndonjë lek për pleqtë tepron, - i drejtua Sifit miku.

- Jo! - bërtiti Fani që ishte aty pranë. - Edhe sikur të mos shkonim në Itali, ne duhet që ta kthejmë arushin te nëna e tij.

Sifi e mori djalin në kraharor dhe e shtrëngoi duke ia puthur këtë herë kaçurrelat. I vogli ndjeu që ishte penduar. Iu duk se kishte ndërhyrë pa të drejtë në jetën e kafshës së vogël të pyllit.

Të nesërmen, gjysh e nip morën arushin e u futën në pyll. Nuk ishin afruar as edhe në qendër të masivit të blertë, kur përpara u shfaq nëna arushë. E kishte ndier erën e krijesës së saj që shumë larg dhe kishte dalë përpara. Ishin përballë. Arusha lëshoi një britmë gëzimi e u ngrit në këmbë. U duk se ishte dy metra e lartë. Hapi gojën si një shpellë e vërtetë, dhe hungëriu.

- Mos lëviz! - i tha Sifi të nipit dhe u përkul që të zgjidhte arushin e vogël, i cili ende nuk po reagonte.

Nuk e mendonin se do të dilte përpara kaq shpejt arusha e pyllit. Po ajo tani priste vetëm disa hapa përpara tyre, duke mos ia ndarë sytë vogëlushit të saj. I dërgonte mesazhe mikluese, por ai në indiferencë të plotë, edhe pse i lirë, tashmë nuk bënte përpara. Në një moment u ngatërrua në këmbët e Fanit sikur kërkonte përkëdheljen e fundit nga ai. Kur u duk se po mungonte kjo, ngriti putrat e vogla dhe i vendosi në gjoksin e tij. Mbështeti kokën e madhe në kraharor e pastaj lëshoi një klithmë të butë. Fani dalloi lot në sytë e kafshës, por nuk guxoi që ta përkëdhelte mikun e tij. Atje tej priste nëna arushë. Dukej sikur i lutej që të kthehej sa më parë në gjirin e saj. Vogëlushi pastaj hoqi putrat nga kraharori i Fanit e zbriti poshtë. Tundi kokën në një çast dhe u nis për te nëna e tij.

Rrugës së kthimit për në shtëpi Fani u ndje keq. I hipi një ngashërim fëmije përpara lesës së oborrit. Pastaj u ul aty e qau me dënesë. Gjyshja dhe nëna e tij nxituan që t'i dilnin përpara. Ishin të merakosura. Por Sif Jani ua bëri me shenjë që të qëndronin aty

- Ai ka nevojë për këtë moment, - tha plaku, ndërsa hoqi këpucët qetësisht dhe u fut brenda në shtëpi, si një njeri që i ka kryer të gjitha detyrat e ditës.

Pas supit, nga qielli i rimitë, filluan të pikojnë pikat e para të shiut.

Nuk kisha shkelur kurrë më parë në Malin e Harresës. Legjenda thotë se kushdo që shkel në të harron kush është. Manastiri ku bujtja prej gati një jave nuk ishte shumë larg Malit. Murgeshat më shoqëronin thuajse në çdo hap. Në mensë, bibliotekë, kopësht, faltore. Mëngjesi më gjeti në bibliotekë tek shfletoja një dorëshkrim tejet interesant. E përhumur në lexim nuk e ndjeva vajzën që rrinte pas meje. Vetëm kur lëshoi frymën mbi flokët e mia ia ndjeva praninë. Ktheva kokën dhe pashë një bukuroshe dhe në çast mendova (Zoti më ndjefte) se ishte mëkat që ish veshur murgeshë.

Quhej Dina dhe ishte 20 vjeç. Më ftoi të bënim një shëtitje dhe s'do mend që pranova. Mëngjesi ishte i qetë, dielli shndrinte dhe ajri ishte i pastër. Dina dhe unë morëm udhën mes kopshtit. Sapo u futëm pak më thellë në kopshtin e manastirit, Dina më kapi dorën dhe duke m'i ngulur sytë më pyeti:

- Ke dëshirë të shkosh në Malin e Harresës?

Diçka kisha dëgjuar për legjendën e atij Mali por nuk i kisha kushtuar shumë rëndësi ndaj për t'u informuar më tepër e pyeta:

- Nuk di çfarë të them. Më trego diçka më shumë. Si është historia e tij?

Dina nënqeshi.

- Shiko, ty të pëlqen vetja? Domethënë, je rehat me veten, apo dëshiron të harrosh se kush je.

- Epo, mua më pëlqen deri diku. Ka raste që dua të zhdukem, të tjera herë ndihem e humbur, e të tjera herë akoma fatkeqe. Por në thelb, po, më pëlqen vetja. Nuk ndihem gjithmonë mirë me të por më pëlqen.

Dina sikur e humbi disi. Largoji sytë dhe tha:

- Mendoja se nuk ndiheshe rehat me veten. Paskam gabuar.

- Ç'të bën të mendosh kështu?

- Po ja, kur mësova se një shkrimtare do vinte për disa kohë në manastir u gëzova. Ju shkrimtarët jeni të veçantë, jeni ndryshe. Aty gëzoni, aty pezmatoheni, çirreni, qani e triumfoni. Ndaj mendova se ndoshta do të dëshiroje të harroje se kush ishte.

- Dhe ti mendon se duke hipur në Malin e Harresës njerëzit harrojnë se kush janë?! - e pyeta e çuditur. Dina, është një legjendë. Asgjë më shumë.

Vajza uli kokën, por arrita t'ia shoh sytë e përplotur. E mora për krahu dhe u kthyem përmes kopshtit. Në korridorin e gjatë teksa bëhesha gati të merrja drejtimin e bibliotekës i afrova dhe i pëshpërita:

- Sonte në darkë eja tek dhoma ime.

Habia në fytyrën e saj më bëri për të qeshur.

Kur ora ra 22:00 në derën e dhomës sime (ndryshe nga qelat e manastirit, unë bujtja në një dhomë të rehatshme, të cilën murgeshat e përdornin vetëm për miqtë) u dëgjua një trokitje e lehtë. U ngrita, rrotullova çelësin dhe Dina hyri brenda aq shpejt sa më bëri çudi. U ul në cep të krevatit, kryqëzoi gishtat dhe mori një pozë si të donte të më thoshte "Ja ku jam!".

- Dina, - ia nisa - përse i përket Malin të Harresës, unë të besoj. Që kur e kam dëgjuar për herë të parë legjendën për Malin e kam besuar. Dhe po, në të vërtetë do të doja shumë të ngjitesha në majë, të harroja veten. Nuk e di nëse ndodh vërtet të harrosh veten duke ngjitur Malin po unë dua ta provoj.

Fjalët e mia duket se goditën në shenjë. Dina ishte ngritur dhe ecejakte nëpër dhomë. Zemra i gufonte dhe arrija t'ia ndieja rrahjet. E megjithatë nuk doja që ajo të ngutej. Ishte mjaft e re për të dëshiruar harresën e vetvetes. U ula dhe me shikim i kërkova të ulej dhe ajo. U qas më pranë por nuk u ul.

- Dina, më thuaj diçka. Përse dëshiron të harrosh veten?



XHENI SHEHAJ

Mallkimi i Malit të Harresës

- Sepse legjenda thotë: Kush ngjit Malin e Harresës harron veten, kthehet në njeri pa kujtesë dhe fill pas kësaj rilind si dikush që dëshiron të jetë.

- Oh, Dina, por unë nuk e dija këtë pjesë të legjendës.

Befas ndjeva të eksitohesha vetëm duke menduar se mund të rilindja si një tjetër njeri. Dina e ndjeu rrënjëqethjen që më mbërtheu. Pa folur, kaloi dorën e saj mbi kofshën time dhe energjia që shkëmbyem ishte drithëruese. Më vinte ta puthja. E largova nga koka këtë mendim dhe brofa në këmbë.

Duke u parë në sy kuptuam se kishim vendosur të ngjismim Malin. Ajo bëri për nga dera por e ndalova duke e kapur për dorë.

- Prit! Kemi një problem që mendoj se duhet ta diskutojmë. - i thashë.

- Ç'problem?

- Kur të rilindim si kush do të bëhesh ti? Ke zgjedhur një model? Unë nuk e kisha menduar se nuk e dija pjesën tjetër të legjendës.

Dina u mbështet pas derës dhe qeshi.

- Mos mendo për rilindjen time. Mendo më mirë se në cilën do të shndërrohesh ti. Nesër pa dalë dielli nisemi drejt Malit.

Kaq tha dhe doli. Kisha mbetur pas dere me mendjen ngarkuar plot mendime. U shtriva në shtrat, i ngula sytë tavanit dhe nisa të sillja nëpër mend gjithë shkrimtarët e mëdha. Nuk kisha dyshim që do bëhesha një prej tyre. Do të rilindja si dikush që kishte jetuar mijëra vite më parë. Do të kisha të njëjtën famë, sukses, të njëjtat sfida e probleme. Atëherë më duhej të zgjidhja me kujdes. Të gjeja dikë që kishte kaluar pak probleme e që kish patur një jetë të mirë e pa shumë telashe. Deri më tani më dilnin boll telashe e mia.

Kalova në mendje gjithë shkrimtarët gra e në fund nxora përfundimin që secila kish pasur një jetë të vështirë. Burrat, kuptohet që nuk i zgjidhja dot. E rraskapitur nga mendimet e trazuara vendosa të flija e t'ia lija në dorë rastësisë. Nuk do ta vrisja mendjen më gjatë. U ktheva në një anë dhe

mbylla sytë. Gjumi nuk vonoi të më merrte.

Një trokitje e lehtë më zgjoi. Në prag ishte Dina. Sytë i kishin marrë një shkëlqim të frikshëm. Dukej sikur kishte ethe. U përshëndetëm dhe pa e zgjatur më tej dolëm në heshtje të plotë njëra pas tjetrës. Ajo më pëshpëriti që të mos flisnim derisa të dilnim nga manastiri. Nga porta kryesore nuk dilnim dot por Dina njihte një shteg sekret i cili të nxirrte në udhë të madhe nga ku mund të ecje në drejtim të malit. Më vonë më shpjegoi se atë shteg e kishte zbuluar teksa ruante një nga motrat e cila fuste natën në dhomë një djalë me të cilin bënte dashuri. Dina e kishte zbuluar rastësisht ngjarjen e që prej asaj dite e ndiqte me përpikmëri të fshehtë të tyre. Nuk e kishte raportuar motrën dhe as nuk i kishte thënë se e dinte sekretin, por vijonte ta ndiqte në heshtje.

Pasi kaluam shtegun dhe dolëm nga kufiri i manastirit, morëm rrugën drejt Malit. Dielli tashmë ishte ngritur dhe na shoqëronte. Tek ecnim vendosa ta pyes vajzën për jetën e saj. Dhe ashtu kaluam një copë rrugë, ajo duke rrëfyer, unë duke dëgjuar.

Dreka na zuri në rrugë. U ndalëm për të pushuar. Megjithatë nuk e zgjatëm shumë pushimin pasi Dina kishte ngut të madh t'i ngjitej Malit. E ndoqa pas.

Ende pa perënduar dielli dhe ne ishim gati në majë. Prisja të kisha më shumë emocione por duket se ato ishin shterur. Ndërsa Dina, eh, Dina ishte në kulmin e eksitimit. Me fytyrë të përskuqur, sy që i xixëllonin, duar e ballin mbuluar me djersë, Dina dihashte me sytë drejt majës.

Isha disi e hutuar ndaj dhe e pyeta Dinën se si do vazhdonim.

- Do ngjitem unë e para - ma ktheu ajo, - vepro siç bëj unë. Pasi të ngjitem, do ti vendos këmbët në ato dy pllakat që sheh. Aty nis gjithçka pastaj. Ti qëndro këtu, shih dhe bëj si unë por vetëm pasi të jem larguar nga pllakat.

Tunda kokën dhe prita. Dina u mbush me frymë, shkundi rrobën e murgeshës dhe filloi të shkante drejt pllakave. Pa pulitur ende sytë e pashë tek i vendoste këmbët mbi pllaka. Zemra më rrihte si e çmendur. Një dritë u lëshua në trupin e Dinës, aq shpejt sa nuk munda ta shihja nga erdhi. U plandos përtoke dhe drita u shua. Nuk mundesha ti afrohesha Dinës. Në përpjekje me veten për të vendosur t'i afrohesha apo jo, befas pashë Dinën të ngrihej. Trupi ishte i njëjti, por dukej se ajo vetë, e brendshmeja e saj kishte ndryshuar. Nuk gjeja më vajzën e brishtë. Egërsia e syve, tiparet e ashpërsuara rrëfenin një tjetër njeri.

Ajo u ngrit, eci drejt meje dhe pa më vështruar fare nisi të zbriste Malin. Ishte radha ime të ndiqja hapat e ritualit. Pak me drojë e frikë u avita drejt pllakave.

I dhashë vetes kurajë dhe me sytë përtoke i shkela ato. E njëjta dritë më goditi dhe mua. Ndjeva trupin tek lëshohej për dhë. Drita, ndryshe nga disa çaste më parë nuk u zhduk. Qëndronte mbi mua. E ndjeva të më digjte trupin por nuk kuptoja përse nuk largohej. Mendja nuk më punonte aq sa për të kuptuar se unë nuk e kisha përfunduar procesin pasi nuk kisha zgjedhur se si cila duhej të rilindja. Por këtë e kuptova pak më vonë, kur intesiteti me të cilin digjte drita u bë i padurueshëm. Mendja u qartësua disi dhe vendosa të mendoja emrin e personit që dëshiroja të isha. Për drej nuk kisha asnjë emër konkret ndaj dhe mëmërita:

- Si askush.

Kaq u desh që drita të zbuste djegien që po shkaktonte e ndërkohe që ajo tërhiqej ngadalë unë ndjeva lotët mbi faqe dhe zërin tim që vijonte të mëmëriste:

- Nuk e di si kush dua të rilind. Nuk e di. Nuk e di.

Kur drita ishte larguar njëherë e mirë ndjeva një lehtësim. U ngrita ngadalë e hodha sytë qark. Errësira kish mbuluar tokën. Nuk m'u desh shumë të kuptoja se nuk kisha më një trup. Nuk e kisha kryer si duhej ritualin ndaj dhe Mali më kishte mallkuar. Tashmë isha një e mallkuar pa trup, me një shpirt anonim me të cilin duhej të kaloja përjetësinë. Nuk e kisha humbur kujtesën, nuk isha dënuar me harresë por isha mallkuar me anonimitet. Isha kthyer në hije. Zbrita Malin dhe këmbët më çuan drejt manastirit. Hyra brenda pasi askush nuk më ndalonte, as që mund të më shihnin. Nuk lashë skutë pa u futur, njoha gjithë murgeshat. U futa dhe në dhomën e murgeshës që fuste natën një djalë. I gjeta në shtrat të dy, tek lëpinin organet gjenitale të njëri - tjetrit. Dola që aty dhe nxitova për tek qela e Dinës. Ishte bosh.

Natën e kalova duke u futur sa në një qelë, në një tjetër. Pasi i vizitova të gjitha u ndala tek dhoma e miqve, aty ku kisha bujtur dhe vetë. Kur u gdhi dita dola nga dhoma dhe ndoqa murgeshat gjatë lutjeve. Ç'të shihja! Lutjet i drejtonte Dina. Por nuk ishte më Dina që kisha njohur unë. Ajo tashmë ishte një grua e madhërishe, e frikshme, e tmerrshme. Lutjet që dilnin nga goja e saj nuk ishin të ëmbla, të qeta, shpresëdhënëse. Ato ishin të mbushura me urrejtje, tmerre e gjak. Dina lutej për ardhjen e Djallit. Lutej për gjëmimet e topave, për pushtimin, për vrasjen, përdhunimin, masakrat; lutej për gjarpërinjtë e kuçedrat, dragonjtë e lugatët; Dina lutej për vdekjen.

Dina kish zgjedhur të rilindte si një grua që e ka mbuluar terri. Dina kish zgjedhur Errësirën, Ligësinë, të Keqen. Dina kish zgjedhur Djallin. E shihja tek nxirrte fjalë të ashpra, tek mbillte dhunë e terror, tek ndizte gjakra e urrejtje dhe ndjeja neveri.

Po unë? Unë që isha dënuar të mos rilindja. Unë që përjetësisht do të endesha si hije mes njerëzve. Mos vallë isha më mirë unë?

Në djall!

“Si është e mundur”, i them vetes. “Kam mbi pesëdhjetë vjet që mbaj këtë mbiemër dhe akoma nuk di asgjë mbi origjinën e tij?” Ishte pra një pyetje sa naive po aq edhe e natyrshme, e cila më nxiti të merrja autobuzin e dikurshëm. Zbrita diku afër ish shkollës në Qerret, ndanë xhades. Aty ku tashmë betoni, hekuri dhe xhami xajs, ia kanë dhunuar natyrës çiltërsinë. Dikur ishte një rrugë e drejtë qerresh. Tani e mora në këmbë si dikur, adoleshent. Ishte hera e fundit që shkoja. Kur isha fëmijë, e bëja shpesh me babain, nënën dhe motrat. Është e njëjta rrugë, e njoh si vdekja. Sapo mbaron asfalti, fillon pluhuri i xhades, i athët, i nxehtë, i heshtur. Merrnim përherë rrugën poshtë urës, ku kalonin shinat e trenit. Ishte, për babain: ti bije për shkurt. Ishim rritur me atë opinjon, ndaj s kishim shanc si ta mendonim ndryshe. Kur ktheheshim nga miqtë në fshat, t’i dilje nga Fabrika e Letrës, na nevojitej ta bënim të tërë Kavajën në këmbë në zheg të vapës, për të marrë trenin në fund të qytetit, ndaj kjo, ishte një torturë e vërtetë. Torturën na e shtonin edhe trastat që duart tona të njoma i mbanin me zor. Kushërinjtë tanë, ishin aq shumë zemërgjërë, sa e kishin për turp të na nisnin pa na i mbushur trastat me fiq, ullinj, domate, rrush. Deri dhe pula të gjalla na dhuronin. Pra ne, ishim të detyruar t’i binim shkurt. Bënim Liqenin e Agonasit, kalonim rrugën e pluhurit të gushtit nën diellin përzhitës, dhe larë krejt në djersë, të etur nga vapa, prisnim buzë xhades në Qerret, deri sa të kalonte autobuzi i Kavajës. Në mos ai, ndonjë mjet i rastit. Babai gjithmonë ngrente dorën me shpresë se do njëhte ndonjë shofer zisi, nga ato që frekuentonin parkun e mallrave në shknozë. Rruga ishte fare e qete, e asfaltuar, pa trafikun e tanishëm. Ishte epoka kur natyra e thonte fort fjalën e saj dhe buzëbrëmja, kishte një malinkoni të veçantë, si e ardhur aty nga fund shekujt. Rruga ishte e ndarë nga dy rrjeshta plepash, të cilët vazhdonin për kilometra të tërë; deri tek Kavaleshenca, në Plepa. Aty ku, kridheshin në diell dhjamacakët e elitës.

Deliri i gjetheve të plepave, të cilat në vjeshtë binin me rrëzeza rromantike, vazhdonin ndanë gjithë udhës, deri përtej rrugës bri detit; duke u ndalur tek Ura e daj Lanit, në të hyrë të Durrësit. “Jam nisur pra për atje. Në Kanaparaj, si dikur fëmijë por nuk e kuptoj mirë a jam fëmija i rritur, apo i rrituri fëmijë? Hedh sytë përreth, gjithçka ka ndryshuar që nga i largëti 1990, kur mbaj mend, këpuca ime ka shkëlur kënde për herë të fundit. Përreth, janë ngritur aq shumë pallate, aq shumë rrugë të reja, aq shumë dyqane dhe pika servisi, sa kujtesa e 30 vjetëve më parë, e ka krejt të pamundur orientimin. I zbrita pra autobuzit, në të hyrë për tek Katundi i Ri, këtë e kujtoj si dje. I hyra përmes urës së vogël mbi të cilën, dikur kalonte treni i hekurt dhe hijerëndë, dhe pastaj ndoqa rrugën e pluhurit drejt Liqenit Agonas. Është një liqen me ujrat plot llum, ngjyrë balte, ku në verë, ne zhyteshim duke u llangosur krejt; argëtoheshim duke u freskuar në orët e vapës së gushtit, pa e çarë fare kokën. Deri sa pashë liqenin as nuk po e besoja nëse isha apo jo në drejtimin e duhur. Tek eci, dielli përvëlues, ma djeg çakëkën, ndërsa mbi pluhurin e nxehtë të xhades, rrugëzat, ndërpritin nga milingonat gjigande, të cilat rëndin në pluhur. Me dhëmbët si morsaeta mbajnë të shtrënguara fara luledielli, dhe rëndin drejt foleve. Se di për besë, nëse po gaboj, apo kujtesa po më loz një trill. Ndoshta, diku, një kujtim, po merr formë dhe unë po e jetoj rishtaz, sikur të isha ende i ri, i sapo hedhur në brigjet e jetës së vërtetë. Ndoshta jam ende 19 vjeçari i dikurshëm? Sapo pikas liqenin e Agonasit, e ngre fill kokën. “S po gaboj!” them. “Kjo është rruga!” Poshtë ullinjve shekullorë, aty ku shtëpitë e fshatit afër ledheve të liqenit, shpërndahen andej kënde, heshtja e blertë, e ndjej, nuk e ka më gjallërinë e dikurshme. Një gjel, në majë të një gardhi, këndon sa t ja hajë fyti. Një kloçkë, me shumë zogj të njomë ikën drejt liqenit.

Habitem për besë. Ç të jetë jeta vallë? Ç kuptim do kishte, nëse gjithçka do të shuhej, tretej, zhdukej tek asgjëja? Gjithë ai vrudh vstar ndjenjash, dashurie dhe urrejtje. Ankthi dhe gëzimi. Përkushtimi dhe zhgënjimi. Njerëzit që aq shumë i deshëm, ku ikën vallë? Ku u tretën? Ku u zhdukën gjeneratat e damarëve të gjakut? S do kishte kuptim, po të treteshin tek asgjëja! Do të mungonte thelbi i egzistencës. Do të ishte si një dramë e bukur, të cilës do t’i mungonte finalja. Nuk do të kishte finale.

Nuk ka finale!
Të paktën, të ishim, pjesë e një projekti gjigand hyjnor, ndoshta do të kishim shpresë t’i takonim diku prap njerëzit e dashur. Në zjarr a në dritë? Aty ku të meritonim. Të ishim pjesë e një krijimi madhështor, ku Hyja të ishte artisti më gjigand i universit! Më mirë se t’i besoja hiçit të madh,



ARTUR SPANJOLLI Shtegtim nga e ardhmja

do të më pëlqente t’u shqepja veten me iluzionin ngushëllues të Hyjit. Një fuqi drite krijuese, e cila, një ditë, do të ma shpërbente me amëshim gjithë mundin e lutjeve. Do të ma shpërbente njëmijëfish investimin shpirtëror, nëse unë me heroizëm, do të ndija vrytytin. Nevojitet vërtetë heroizëm për t’u ndjekur vrytytin, në këtë botë muti dhe shurre.

Le të zhgënjehem një ditë, pak rëndësi ka! Por ideja se jam i vetëm në univers, më fut tmerrin e zi në shpirt, akullin. Më angështon krejt. Më kall datën. Më bën të ndjehem i vetmuar. Tmerrësisht i vetmuar.

Nuk dua të ndjehem i vetmuar në univers. Nuk dua dhe pikë! Se pranoj të jemë një ulërimë vetmitare në qiellin bosh dhe pa kuptim. Le ta gënjej vetveten. Dëshiroj të investoj për gjysmën e mundësisë: Hyjinë. Lojë zari pra, na qenka jeta?! Unë e hedh zarin duke shpresuar të më dalin numrat e Hyjit. Le të dalë ku të dalë! Ashtu si të jetë e vërteta, le të dalë! Aq më bën. Po pati diçka tutje, investimi im shpirtëror do të godasë në shenjë. Po nuk pati asgjë, do të më mjaftojë ky iluzion i zhuall ngushëllimi. Në fund të fundit: *Morto io, muore tutto il mondo.*

Me sa kujtoj më nevojitet akoma një orë ecje normale, për të arritur atje. “Tutje varrezave, mbi kodrinën e vogël” them me vete, “gjenden të shtëpiat e djemve të xhaxhait. Kur xhai i babit vdiq, se groposën mirë. Një erë mish njeriu në kalbje thonin u përhap gjithkund. Ndaj kur kaloje xhaden njerëzia mbyllte hundët. Ishte trup i bëshëm dhe vdiq fare i ri. Babai, mbasi u bë rezil me njerëzit e vet për një çështje pronash, u afrua më shumë me kushërinjtë e tij. Ç të bënte?! A rrihet dot pa njerëz dhe pa farefis?! “Isha 18 vjeç?! Me siguri aq kam qenë, a ndoshta 19. Se mbaj mend për at Zot. Isha si në ëndërr. Vjen një moment kur mosha e humb krejt kuptimin e mirfilltë. Bëhet thjeshtë një shifër më shumë. Ishte një udhëtim lëngimi. Kisha një vit, që i rënë me turitë në asfalt, për arsye të një dashurie të pamundur, ndërmorra një udhëtim harrese. A ndoshta, për të gjetur disi paqen?! Ndoshta ngushëllimin, larg. Fare larg. Larg syve, larg zemrës, thonë italianët. Po, kishte ndodhur diçka e rëndë. Si një shembje e rrëmujshme; i tërë qyteti ishte në zi. Perëndimet çaheshin nga thika plot gjak, pemët ulërinin kujë, buçisnin fort dallgët në shkëmb. Plot kripë. Krejt i llahtaritur, me trurin lesh arapi, mendoja për të gjithkund. Ndjeja një dëshirë marrake t’u harroja. Ah, pak paqje, pak qetësi. Një armëpushim po kërkjoja, në këtë luftë mizore brenda meje. Shpirti, si të ishte llavë e nxehtë, magmë, nga zjarri në akull donte të shkojë. Të iki, të iki sa më larg. S kishte faj ajo. Fajin e kishte kjo koka ime, që ishte magjepsur krejt. Kërkoja një lumturi të rrezikshme, rashë keq. Ja tani, i thoja vetes, jam bërë si tutkun.

Është e rëndësishme për mua t’u di një nga një mbiemër! Ç’origjinë ka? Kjo pyetje këmbëngulëse ma torturon prej shumë vitesh kurjozitetin, ndaj dua t’i shkoj deri në fund kësaj çështje. Njeriu duhet ta njohë prejardhjen e tij! Ta kërkojë atë nëpër rrudhat e historisë. Nëpër rrënojat e së shkuarës. Të pyesit stërgjyshin. A ndoshta ndonjë plak ende gjallë, të cilin fshikullima e mortjes nuk e ka përlarë akoma. Dheu e mban kujtesën, si pema, si guri, si një prag i lashtë që del në dritë. “Do të

pyes më të vjetrit,” them me vete. Por se di deri në fund, nëse ky udhëtim, ishte, është apo do të jetë?! “Ndonjë plak njëqindësh, plot rrudha, tym llulle dhe gëllezë, me siguri duhet të di më tepër!” Tek eci, këtë pasdite fundgushti, afshi i avullit i diellit, kënga e turtullshave poshtë degëve të ullinjve, zhurma e gjinkallave, heshtja pa kohë e kaçubeve përgjatë rrugës, gjithçka më merr dhe më jep. Më merr copa shpirti që ishin. Më jep frymë të re. E çuditshme. Po eci si peshk. Kujtesa, nuk gjen më asgjë. Gjithçka është zbjeurur, zbardhur, si një teshë e lënë në diell për vite të tëra. E cila, jo vetëm ka humbur ngjyrat, por sapo e prek, grisit nga kalbësia.

Kjo heshtje fshati ku gjithçka flet me gjuhën e natyrës, më habit jo pak. Nuk po has më asnjë këmbë njeriu përreth, mendoj i habitur. Sikur të ketë rënë murtaja. Ma kishin thënë: këto vise po braktiseshin, por se mendoja kaq keq punën! “Ore, a jam për atje, a jo?!” Pas 90-tës, fshatarët, lodhur nga angaritë e bujqësisë, zunë tokë në të hyrë të qytezës dhe ndërtuan shtëpitë. Ndaj, këto shtëpi të vjetra, braktisur nga fryma e njeriut, ngajnë si zhuall breshke krejt bosh nga brenda.

Kjo na qenkerka vetmija e pandreqshme e kohës. Shtëpia thonë pleqtë, po nuk u jetua, fillon dhe shembet vetvetiu. Gjëja më e çuditshme është se unë eci, por me zor po e njoh këtë vend. Çudi e madhe?! Ndoshta kam lajthitur? A ka ndryshuar pejzazhi? Ndoshta kujtesa po më loz një rreng. Ca skena zhduken, të tjera pësojnë modifikime. Kur vinim fëmijë me xha H. xha D. apo xha B. bënim rrugën e Fabrikës së Letrës. E thashë, këtë herë devijova. I rashë për shkurt, ndoqa fjalët e babait, si dikur. Ishte një akt nostalgjie.

Pra, për t’u përmblodhur: zbrita tek shkolla në Qerret. Aty ku babai, fëmijë, shkante në fshat. Një herë, kish rrefyer se si kish parë në një gropë, një mori perrishë. Me qindra gjarpërinj të shndritshëm, plot ngjyra ylberi vezulluese, të cilët përndrydheshin, shkinin mbi trupat plot jargë të njeri tjetrit. Përndritja e tyre gati sa nuk i kish verbuar sytë. Fëmijët, krejt të mrekulluar dhe të tmerruar nga ajo bukuri e frikshme kishin ikur me vrap. Në xhade kishin gjetur një plak, e kishin terhequr prej dore me ngut. “Eja. Eja!” i thonin. “Janë perri” ishte pergjigjur plaku. Më pas, kish hedhur mbi kanal një batanije. Gjarpërinjtë vezullues nga ngjyrat, të trembur, kishin marrë dhenë duke u shpërndarë nëpër fushën djerrë.

Kalova Agonasin, tani po eci në heshtje. Ndjej një lloj trishtimi të mekur, fisnik në shpirt por krejt memec. Sikur aty të ndodhej një pellg i verdhë, i ndenjur, reflektues dhe zemërcjerrës, në të njëjtën kohë. Nga erdhni kështu kjo ndjenjë trishtimi fisnik brenda meje? E di! Ka formën e një vaje flokë artë. Po. Po. Ajo me fundin kaf me pala dhe me këmbë të bardhë, me lule të mëdha, krejt të verdha mbi të. Tani jam larg saj, ja pse e kam këtë trishtim. Veç një Zot e din, sa kam shkruar, lexuar për të kuptuar diçka më shumë. Një ndjenjë, e cila, si një ortek, ka përmbytur krejt, qetësinë gri të qenjes time. Ajo s don t’ja dijë?! Refuzon këtë ndjenjë të fjetur, të marrë?! Është më e bukura, më e paarritshmja?! Apo unë jam më vulëhumburi i botës. E di. Po shkoj të mbledh dëshmi mbi mbiemrin tim. Kush jam? Nga vij? Ç’duan spanjollët në një kodrinë feudale, ku

shpirti turk, ulur këmbëkryq që prej 500 vjetësh nuk don të bëhet Europë? Ç kanë dashur kaq larg hapësirave të Mançes? Ato shkonin drejt amerikave. Po, kanë arritur deri në Napoli, Sicili, hajt t’u themi deri në Korfuz, por kurrë kaq të largët. Nga këto vise, ende bëhet bakllavaja dhe hahet mishi i pjekur, i ulur në sofër.

Kur e kaloj liqenit, ende i kam sytë plot mosbesim dhe një hutim, gati turbullirë. “Për nder, po ja fus kot më duket! S do arris kurrë në Kanaparaj!” Tutje, shtrihen fushat mbjellë me mollë, rrush të pjekur. Por shumë toka, kanë mbetur djerrë. Është gusht, ndaj frutat e pjekur, gati sa s’plasin nga shëndeti. Kumbullat pikojnë nektarin e ëmbël, fiqtë bëhen palë në degë; bostani çahet nga pjekja.

Dikur, këto ara, i mbaja mend të mbjella me grurë, luledielli, pambuk. Më në fund, e humb fillin krejt! “As përroin e vogël nuk e gjej. As ullinjtë tek xhadeja, as shtegun për tek kroit, as fshatarët me shatin në sup, trastën e bukës në shpinë. “Po si nuk ka as edhe një gomar me dy kosha dhe plakun me qeleshe ulur mbi samar? Vërtetë ia paskan mbathur të gjithë!” Eci akoma. “Po kërkoj një rrugë me gurë të bardhë, një përrua të keq dhe mbi një kodrinë, tre shtëpiat ku shkoja çdo verë. Mbi shpatin tutje, ishin rrënojat e një Qishe!”

Pranë përroit argjilor, të vegjël, rinim me Betimin, Naimin, Bardhin dhe Yllin. Ndiqim gaforret. Edhe pse zbatch, nuk i kishim frikë. I kapnim dhe i shkullim krahët, krejt pa shpirt. Unë mburresha me këpucët e vockla prej kartoni, të cilat i fabrikajo po vetë. I vishja me letër varaku dhe i vija xhufka shumëngjyrëshe në majë. Ndjehesha më i dituri, më i zgjuari. Doemos, *Shehelii*. Shpesh, në zheg të vapës, ia mbathnim nëpër ara për të mbledhur fiq, volla të egra, manaferra. Të pjekurat ishin aq të mira sa na kënaqnin krejt. Vollzat i fusnim nëpër mullarë bari dhe prisnim që të piqeshin. I zbatchur, nuk i dëgjoja kurrë motrat. “Mos ja mbath nëpër ara dhe kaçube, se ka gjarpërinj!” Unë, Afri dhe Betimi, na pëlqente të eksploronim shtigjet. Nëpër këmbë na hynin gjembat. Përcëlloheshim nga dielli.

Ndërsa mendoj këto gjëra, mbaj shtrenguar në krah një dosje vizatimi me letra të bardha brenda. Po përgatitem për konkursin e shkollës së Lartë, në kryeqytet. Tani, i kam ikur qytetin. Dua të harroj, e di. Ndërgjegja, është fare e bindur. Dua t’u harroj. Duhet! Gjithkush don të harrojë diçka në jetë, edhe pse e din që mall do t’u djegë fort.

Është hera e parë dhe e fundit që vij këtu, vetëm. Liqeni, të cilin ne e quanim Rezervuari, shtrihet i paqhtë, në një heshtje pa kohë. Një masë uji ku mijra peshq gjoli, sillen në kërkim të ushqimit. Shtrirja e ujit me diellin vezullues mbi të, më sjell ndër mend kohën e largët të fëmijërisë, ku kujtimet rrinë si pezull. Sekuenca pa lidhje, pa llogjikë, lëmsh. Si fragmente të një historie bërë copë copë nga harrësia.

Tek ulliri i vjetër, marr kthesën. Kalldrëmin e gjej njëllor. Unë të gjej pleq qindvjeçarë në këtë humbëtrë?! S ka shanc! Aty shoh një djalë të vogël, i cili loz me një breshkë. Sa mirë! Më në fund e gjeta dikënd që ta pyes.

“Hej o çun. Si e ka emrin ky fshati?” Ai nuk flet. Më shikon me dy sy të thellë, kurjoz, por nuk flet. Po! Jam fare i sigurtë. Poshtë pikas përroin, tani mbytur nga ferrat. Njoh gurët e bardhë të xhades, ngulur udhës së djerrë, mbuluar nga një tis pluhuri të nxehtë. Veçse shkurret dhe fierat, kanë ndryshuar fizionominë e vendit.

“A më kupton? Quhet Kanaparaj ky fshati?!” Ka veshur një palë pantallona të shkurtëra doku. Një këmbë të bardhë me kuadrata, plot njolla manaferrash. Me shikon, por silltet çuditshëm. Nuk rreagon. Sikur të mos e kuptonte gjuhën time.

Sipër bregut shfaqen tre fëmijë të tjerë, pak më të mëdhenj, të cilët e therrasin në emër “O Art ku je? Hajde mor drej se na trëmbe. Kemi dy orë që të kërkjome!” Njëri fërshellen. Fëmija përgjigjet duke ngritur duart. I ka këmbët plot me kore dhe dregëza. Ngrihet, braktis breshkën dhe këmbëzbathur ja mbath. “Çuna!” i pyes. “A jemi në Kanaparaj këtu?” Ato ngrajnë supet. Më shohin çuditshëm, si të isha një qenje e një kohe tjetër. Turbullirën ma kthjellton ulliri tek kthesa e xhades. Është i njëjti, i fëmijërisë. “E gjeta!” mendoj. Iu futa përmes barit të thatë, rugicës që të çonte drejt shtëpisë së xha H., por shtëpisë nuk i gjendej as nishani.

Nuk ishte ibriku me ujë të nxehtë nga dielli, as trina, as kapercylli, si i thonim ne, kur kalonim nga një pronë tek tjetra. S ishin as rrjeshtat e hardhive të rrushit. Ai rrush i zi, kokërrmadh, krejt i ëmbël, plot lëng. Dheun e kujtoja të butë, mirnjohës, zemërgjërë. Ashtu ishte. Këpuca zhytej si në sfunger. Gjithkund kishte veç bar dhe toka të braktisura, të lëna nën mëshirën e fatit. Vende

(vijon në faqen 16)

(vijon nga faqja 15)

vende e çarë, si lëkura e femrës së zhuritur për dashuri. Ullirit të vjetër në të djathtë të shtëpisë së Naimit, i kish mbetur veç kërcuri. Nuk e di pse, gjithmonë më pëlqente të nevrikosja aty qenin e zi, të lidhur. Më pëlqente kur, ai, krejt i egërsuar, nxirrte dhëmbët gati për të kafshuar. "Janë të njëjtat vënde!" them me zë, "kot bëj sikur nuk i njoh prap. Ç pret kur kthehesh mbas 30 vjetësh!"

Kur gjeta ullirin e xha D., aty ku Tija, dikur, ndizte zjarrin për të pjekur tavën me qull, u binda. Isha në dheun që mendoja se isha. Shtëpia rrinte ende në këmbë. E vetmja që kishte rezistuar mes tre shtëpiave të vëllezërve. Gjysëm e rrënuar, pa çati, me rrënojat përgjithërisht, dukej sikur rënkonte nga harrësia dhe braktisja. "Edhe pse e di, prap nuk jam i sigurt!" mendoja dhe nisa të thërras kalamajtë si dikur. Asnjë nuk përgjigjej. Çimentoja ku ne ecnim zbat, ishte plasur aq shumë, sa kishin dalë rrënjët e një ulliri qindravjeçarë. Dikur i vogël, nga të çarat e çementos, kisha frikë se mos dilte ndonjë gjarpër. Mu kujtua koha kur na bënë sytë ende fëmijë. Ishim 7 djem, dhe të tërëve na sistemuan brenda një nate. Berberi erdhi në fshehtësinë më të madhe. Nuk lejohet. Mbasi na fashuan zogun, na doli turpi fare, ndaj bridhnim nëpër oda veshur me fustane, pa asgjë poshtë, derisa na i hoqën fashot. Manat prapa shtëpisë nuk ishin më. Mu ngjir zëri duke ulëritur: "O Betim. O Afrim. O Bardhi!" askush nuk dilte askund. Një braktisje e egër, e thellë ndjehej gjithkund. Një dallgë malli ma ngjethi lëkurën prapa kokës. Tokat poshtë, buzë përroit, ishin mbjellë me domate dhe speca, por nuk kishte bojë njeriu. Shkova deri tek prroi poshtë dhe sa mezor e gjeta nga pylli i ferrave. Asgjë s'ishte më nga ato kohërat e largëta të 82shit. Nga maja e kodrës, tutje, pashë rezervuarin, ku dielli rrezatonte mbi syprinën e qetë të ujit. Se di por një dallgë malli mi njomi sytë. "Si ka mundësi?!" pyesja vetveten. "Këtu nuk gjendet as edhe një kafshë, jo më ndonjë plak qindësh për ta pyetur!"

Koka mu bë lëmsh. Tani, me zemrën krejt të trishtuar, poshtë ullirit, po vizatoja mbi letër Afrimin. Ai rrinte nën hije dhe buzëqeshte. Përreth pulat kakarisnin. Qeni vraponte si i tërbuar. Tija po rripete pulën e therur për mikun, të cilën do ta piqte me çerepin mbushur me prush. Gjinkallat, kapura nëpër lëvore degësh, çmendeshin prej vapës. Nga qielli vinte muzika e një dashurie pa skaje. Tepër e madhe, si një ortek, për shpirtin e brishtë të një 19 vjeçari. "Ç'mu desh kjo punë!" i thoja vetes dhe psherëtitja. "Të thya turitë me një femër kaq lart meje!" Ndjeja trishtimin në shpirt, i cili plot krimba të verdhë ma brente ndërgjegjen. Ndërkohë, vizatoja me penë dhe tush, konturet e Afrimit. Ai po lodhej duke pozuar në të njëjtin vënd. "Do të më bësh original?" më pyeste. "Varet!" ja ktheja. "Po s'është, del mirë." Mendja, e çoroditur krejt nga dashuria, tani po mbushej me një mall të padurueshëm. Nuk vizatoja siç duhej. Ishte një udhëtim harrese, e mbaj mend si të kishte ndodhur dje. Koha kalonte fare e çalë, dhe qielli, toka, pemët, zërat, fushat, gjithçka ngjyrosej me të verdhën e flokëve të saj dhe gjithçka më vështronte me sytë e saj të zinj, ledhatarë, të ëmbël. Edhe pse ajo s'ishte aty, çuditërisht, ishte gjithkund. "Ku jam nor zot i madh. Atje, këtu, askund, gjithkund?!"

Tutje, kur ngrija kokën, përtej manave, fiqve, shegëve, mbi shpatin e rrëpirtë, gjendeshin rrënojat e *Qishës*. Kurjoziteti për mbiemrin, i cili më kishte lindur më vonë, s'më kishte shtyrë ende ta njihja atë vënd. "Eja" më tha Ylli. "Të dërgoj unë!" Ikëm. Kisha veshur një palë xhinsash blu. Ato që K. mi solli nga Italia mbas eksodit, bashkë me bluzën e verdhë si ajo e Brazilit. Mbathja atlete të bardha. Malli po ma shkumbonte shpirtin. Gjithkund hidhja sytë shihja qeshjet diellore të saj, i ndjeja zërin e ëmbël, mendoja lëvizjet e saj dhe mendimi për të, si një qen besnik, nuk më ndahej. Por kurjoziteti për të parë *Qishën*, ishte djegës. Ecëm gjatë, nëpër shtigjet plot kaçube, ferra, driza. Rrugë pa rrugë, ku vetëm gomari mund të ngjitej, arritëm. Nuk isha më as fëmija i atëhershëm, as edhe djaloshi 19 vjeçarë nga udhëtimi e harrësës, me zemrën e bërë copë nga dashuria. Isha burri 50 vjeçar, kurjoz, i cili donte të dinte për origjinën e tij. "Ç'është njeriu pa të shkuarën e tij vallë? A mund të ketë të ardhme pa të shkuar?" Ndërkohë vështrua kodrat verore. Era e marrë përkulte ferrat. Djerrishtja plot gurë të virgjër, kaçube dhe bar të thatë më pëshpëriste emra të humbur. Aty ishin vërtetë rrënojat e dikurshme të një Kise. "Kushedi ç ka ndodhur?" i thoja kushëritit dhe shihja rrotull. "Kushedi si ka qenë puna që fisi jonë, me sytë nga turku, mori këtë mbiemër!" I shtyrë nga një kurjozitet i tepurur, mendoja. Vërtetë! Ç'ishte ky mbiemër kaq i çuditshëm në një fshat kaq primitiv? "Të kujtohet kur ishe i vogël?!" ia

pat Ylli tek ktheheshim. "Ti kishe hipur në majë të fikut, tundje fort degët dhe ulërije: "Hyji xhaja n maj t mullarit/ per te hequr lesht e!" Ne ishim poshtë. Një fytyrë na vinte, një na ikte, nga turpi. Ta bënim me shenjë që ti të ndaloje. Pak me tutje, gratë e kooperativës, ia kishin plasur gazit. Ne s'e donim veten nga turpi. "Mjaft. Pusho, se na fëlliqe!" të thonim që poshtë pemës. Por ti, e kishe marrë me vrull, ndaj vazhdoje të ulërisje me sa ta hante fyti!"

"Se kujtoj!" ia ktheva. "Por tekstin e mbaj mend!"

Gjithmonë më bënte përshtypje heshtja në fshat.

Ishte një heshtje netësh plot yje. Kur shtrihesha mbi dyshekun me kashtë, flija me zor dhe sapo nata binte, malli fillonte dhe ma gërryente shpirtin. Ia mbathnim nëpër fushat e sapo korrura nga gruri dhe loznm me top lecke. Në kthim, duhej patjetër t'i mbushnim tratat me luledielli. Në qytet, i piqnim me kripë dhe i hanim si të babëzitur. Një herë, tregonte babai, i cili ishte rritur atje, ra nga qielli një tullumbac. Kushedi ku e kishin ngritur, dhe era e kishte ulur aty. Fshatarët nuk kishin parë kurrë një send të tillë. E shikonin me habi. I afroheshin, e vështronin, por i rrinin edhe larg nga frika. Sa herë që e lëvizte era, ato tmerroheshin se mos ishte bombë. Më në fund dikush tentoi ta kapte dhe ai plasi. Të tmerruar, fshatarët ia mbathën vrapit përposhtë xhades me ulërima. Injoranca është në themel të shumë fatkeqësive, dihet. "Kushedi ç do të ketë ndodhur këtu, shekuj më parë!" mendoj. "Jo më kot kanë ndërretuar një Kishë. E ka dhe ajo historinë e vet. Çuditërisht, një farë përgjigje mu fanit nga s'e prisja fare. Po pija birrë me një shok dhe i tregova arsyjen. "Arsyjen don ti. Ta them unë!" ma ktheu. Ishte një mik piktor. Kështu, me të, përfundova për vizitë tek një historjan i moshuar, i cili ishte marrë shumë me atë çështje. Kishte hasur më në fund me një material mbi atë mbiemër. Kur ia bëmë vizitën, e gjetëm krejt të dërrmuar nga reumatizma. Lëngata e kishte mbërthyer keq në shtrat. Ilaçet e kishin fryrë. Ishte bërë gati i panjohur. "Si ndjehesh profesor?!" e pyeti miku im, tek e shihte me ato sytë e tij plot dritë, përjetësisht entuzjastë dhe të qeshur. "Ja, siç me sheh!" iu përgjigj i lënguari në shtrat. "Kemi këtë shkrimtarin me origjinë nga ai katund. Don të dijë diçka për prejardhjen e mbiemrit!"

"Ajo që di dhe ti është përgjigja!"

"Ja kam thënë por don ta dëgjojë nga goja jote!"

"Përsërite ti historinë se s kam fuqi, dhe unë t'a konfirmoj!" foli i lënguari. Ma tregoi rishtaz varjantin e vetëm që dinte. "Në fshatin Kanaparaj, pranë kodrës së Qenezës, ndodhej një lagje që mban akoma edhe sot këtë mbiemër. Të parët e këtij fisi, bënë pjesë në trupat spanjolle që në fillim të shekullit të XIII, u bashkuan me kryqëzatën e IV, e cila drejtohej kundër vendeve të Lindjes. Në kthim, trupa spanjolle, nuk arritën të largoheshin prap drejt Spanjës, sepse ishin dëbuar nga atje dhe u vendosën përfundimisht nëpër fshatrat pas Malit të Robit, në zonën e Kanaparajt. Aty blenë tokë, u shkrinë dhe u asimiluan. Pak nga pak, ndërruan dhe fenë. Rrënojat e Kishës e dëshmojnë. Aty luteshin dhe kishin varret e tyre. Përpara këtyre ndryshimeve themelore, jetonin bashkë në komunitet!" Ndërkohë që miku im fliste, profesori tundte kokën dhe pohonte. Shtrembëronte turitë nga dhimbja dhe sytë i nxirrnin një lëng si të ishin lotë.

U ndava me një shije të çuditshme mes gëzimt për informacionin e vyer dhe trishtimit për sëmundjen e tij. Më tepër s kisha ç të zbuloja.

Dolëm jashtë. Ishte një mbasditë vere e nxehtë. Qyteti avullisej dhe përvëlohej nga afshi. Kavajsit nuk dukeshin askund. Rrugët ishin bosh. Tek tuk, poshtë hijeve, ndonjë plak thithte çibukun shekullor, ulur tek stolat e parkut. "Nuk e njoh më këtë qytet aq shumë ka ndryshuar!" i thashë. Kur isha fëmijë dhe e bëja nga Fabrika e Letrës deri tek treni, ishte krejt tjetër! Tani mes kaq shumë ndërtime, veç Ora e Vjetër ka mbijetuar!" Miku im buzëqeshte duke i dhënë makinës me kujdes. "Nuk ka njerëz!" tha. "Ja kanë mbathur në plazh!"

"Shpresoj mos t'a kenë braktisur siç kanë bërë me fshatrat!" ia ktheva. Mendja prap me shkoi tek netët e verës fëmijë atje. Para se të flija, Meja, nga frika se mos bënim urinën në krevat, i shtronte dyshekut plasmas. Pastaj na thonte: "Dilni jashtë të bëni çiqin, pastaj shtrihuni!" Dilnim dhe urinonim poshtë ullirit. Qielli ishte plot yje fshati. Të njëjtat yje që tetë shekuj më parë, kishin vëzhguar edhe trupat e Papa Inocencit të tretë, të cilët zbarkuan tek shkëmbi i Kavajës. Aty, ato u përgatitën për muaj të tërë dhe po aty u kthyen pas betejave. Dhe po në atë vënd jetuan, duke e harruar Spanjën mëmë përgjithmonë. Se di për besë, a kam parë ëndërr, apo gjithçka ka ndodhur tre herë.

Gazmend Bërlajolli

Cikje shpirtnash Tregim

1.

Semafori i kambësorëve urdhonte me u ndalë, madje m'i numëronte edhe shtatëdhjetë e tetë sekonda të kuqe. Por kur ktheva kryet majtas me pa mos po vjen ndoj veturë, vuna re se ato të rrugës përmatanë merrnin të parën kthesë tekëndej në kryqëzim, tue ua zanë, kësodore, shtegun veturave që kishin me ardhë drejt meje. Prandaj mora me kapërcye pjesën e parë të zebërës, për me ndalue në ishullin mes dy rrugësh të gjana.

Njani, që vlerësoi se po ecja me hap të sigurtë të dikujt që e dinte ç'po bante, pa pritë gjatë, u vu me e ba hapërimin bardhezi gati fill mbas meje. Kur hetoi se ngadalësava sapo u avita te mesi i shtegut kambësorësh, bash mbi vetë boshtin imagjinat të ishullit trotuar, edhe ai, pa vonue, u ndal aty me mue.

Mbetëm ashtu përbri do çaste. Nuk pashë, me bishtin e vëmendjes, përtej një manteli bezhë, veshë pa mbërthye rreth një trupi të hajthëm e të gjatë. Kaq di me thanë për qenien majtas simes.

Semafori përballë shënonte edhe katërdhjetë e tre sekonda pritjeje të kuqe. Ajo që unë e dija, e që, me ç'dëshmova prej hapave që m'i ndoqën të mitë, zotnia përbri nuk e dinte, asht se kur ato dy shifra të ndërronin vende, makinat, që tashma po vinin nga e djathta, do të ndalnin hov e do të banin aty radhën vetjake të pritjes së palëvizim, kurse unë, pa i pritë çalot me u harxhue, rrjedhë e përngeshme rane nëpër grykë të ngushtë qelqi, do ta kaloja gjysmën e mbetun të shtegut, kalorës urban i zebërës asfalti.

Çasti erdhi. Nji veturë e bardhë që avitej, u ndal matanë vijës së gjatë perpendikularisht të bardhë. Unë mora me qitë hap. Vendosa me e riecë ritmin fillestar. Ai, që si unë, po nxitonte rrugës së vet, do të bindej me më ndjekë risht me të njejtën bindje si ma parë, tue i ba lak pritjes mbigjysëminutëshe për shifrat e blerta.

Me një ngurrim, këtë herë ma të shkurtë, hapi i tij ndoqi timin. Në trotuar, manteli bezhë që rrypat po i valëviteshin, bani drejt. Unë mora djathtas. Ndonji i tretë, që mund të ketë qenë dëshmitar i këtij ngadhënjimi modest, nuk kish me thanë kurrë se na të dy kalimtarët, nëpër të kuqen tonë të përbashkët kuvendëm, se unë ftova, e se tjetri më besoi e më ndoqi.

Por po, dy energjitë tona, ato që mbas gjase i quejnë shpirtina, kuvendën vërtet. Ç'asht kryesorja, vetë shpirtinat këtë gja e ditën, sepse gjithmonë e paskishin ditë. Të pavëmendshëm ishim veç na, egot prej mishi e truni, mbetë me ecë këtyne rrugëve edhe ndonji vit a ditë. Veç të ndrymë kësisoj, harrokemi se në thellin ma të thjeshtë të gjanave, jemi nji dhe e njeja, pjesë të pandashme të të tanës që ka.

2.

Lagë shiu tashma të prajtn, trotuari qe prarue nën diellin krejt të ulun të mbasdites së vonë, që ia skiconte nji mozaik dritëhijesh nëpër rrasat e gërryeme. Hapat përsipër tyne më trokëllinin me nji ritëm vetmitar, secili nji tjetër kumb në simfoninë përndryshe të prajshme të qytetit në atë buzëmbrajme. Prejnjiherë, njifarë si copëze kujtese, si mejtimit bredharak nisi të më kërcente e të më lodronte nëpër cepat e vetëdijës, tue refuzue me u ba zap nën përqendrimin e vëmendjes. Dhe, veç atëherë kur figura përballë, grueja që po hallakaste në përmbajtjen e nji çante të vjetrueme, e çoi kryet dhe ma nguli shikimin tek i saji, kujtimi, bishë e harbueme, u kap në çark.

Sytë na u takuen në atë t'imtë, dhe krejt nji jetë e tanë, jase disa sosh mbase, u ngjeshën tok në atë nji vështrim të vetëm. Në sytë e saj, dhe në sytë veç, tashma prej mesogrujeje të kolme, nuk pati askund asnji fërkemë prej barrës së motmoteve. Ishim dy kalimtarë sall, dy të huej në nji trotuar të lenuem njerëzish, e megjithatë, krejt nji kuvend të pafjalë e ndërruem në t'imtën e atij vështrimi të ndërsjelltë.

M'u kujtue. Ka pasë qenë njanëse e mësueses sime, nji brezni para meje veçse – prani krejt anësore, vetje kalimtare në ato vite të largëta, para se të më zhdukej përfundimisht dikah përmbraja mjegullnajës së viteve të vogëlisë. Kureshtar, këtunjherë ia hetoja gjestet gjatë vizitave të rralla që ia bante mësueses në klasë. Ndoshta ishte eglendia që i shquhej në cepat e syve e të buzëve tek fliste, jase mënyra se si, tash e parë, i fuste bishtat e flokëve përmbraja veshit. Këto pamje, hollësi të parandësi, më paskan gjatë disi strukturë në qilarin e pluhnuem të kujtesës, tue pritë çastin e duhun, njikëtë takim të rastësishëm shikimesh, me u rishfaqë.

E, qe tek ishim, dy kurkusha për njani-tjetrin, troç me e thanë, njisue prej njatij filli të padukshëm të nji të kaluemeje, aq rrallë e tek të përbashkët. Njohja, i bindun jam, qe edhe e anasjelltë. Në zgurdullimin e beftë dallova nji vizëllimë hutie njijherë, tevona nji gazmim të ngadaltë e ngurrues të cepave të syve veç – hije pos e buzagazeve të dikurshme që i mbaja mend prej nji jete të jetueme qyshkur.

E njai fill i përbashkët, tjerë prej shikimesh të ndërsjellta, nuk pati si të zgjaste përtej se lejonin rregullat e pashkrume të mirësjelljes shoqnore, që rahatinë e heshtun e tendosin sakaq në sticim të bezdisshëm. Prandaj, të dy palë syve tanë u erdhi radha për cikje qepallash, të cilën vetiu e shfrytëzue me e shkëputë lidhjen *wireless* përmes të cilës po shkarkoheshin fotografi kujtimesh andej e këndeje.

Përballja e shkurtë më la njifarësoj të hutuem. Si i bahet, a thue, që ajo që asht thelbi i nji vetjeje, xixa e saj fëminore, të ngulmojë me u rrujtë e paçartun përjetë në ata sy, kryeneçësisht tue i ba ballë dhambit të kohës, si farë kodi sekret që sall ata që na njihnin këtunjherë të mund ta deshifrojnë. Çka ka diçka në sy, a në shikimin e tyne ndoshta, që kurrnjijherë nuk plaket?

Ecja e matejme drejt shpisë ishte nji lloj turbullime, përftue prej reflektimeve rreth kësaj pikëpyetjeje dhe ndjenjës që, tash se pranoj, mall paskish qenë.

Kujtimi, gazmor po aq sa i trishtë, pati njifarë hijeshie. Ishte jo veç dëshmi se në gjithin e pamatë të të qenit, edhe ma të imat e ndodhinave të kalume, sado të largëta a të pape-sha në dukje, dikund mbeten, e se në pakohësinë e gjithëkohësisë, a ma parë, përtashësinë e saj, të mbërthyeshme mirëfilli veç për zotat, edhe e kaluemja, e shkuemja, e dikurshmja, e tashme asht.

ART HOUSE
 Organizon:
EKRANI I ARTIT
Solitude and Multitude

EDICIONI I VII-të

5-9 QERSHOR, 2024

Vendi: Kinema Republika, Art House, Galerinë e Arteve, Vendin e Dëshmise e Kujtesës, Qendrën Rinore Arka, Auditorin Franceskan, Galerinë Oda dhe në Kalanë e Rozafës

Ekran i Artit vjen në edicionin e tij të shtatë. Nga data 5 deri më 9 qershor, Shkodra do të mirëpresë vepra të video artit, filmi të shkurtër e të gjatë, dokumentar e fikcion, punime nga artistë vendas dhe ndërkombëtarë që do të shfaqen në Kinema Republika, Art House, Galerinë e Arteve, Vendin e Dëshmise e Kujtesës, Qendrën Rinore Arka, Auditorin Franceskan, Galerinë Oda dhe në Kalanë e Rozafës. Nën titullin Solitude and Multitude filmat e edicionit të sivjetshëm eksplorojnë këto skaje të pandashme të ekzistencës njerëzore ku vetmia dhe shumësia, individi dhe komuniteti, thjeshtësia dhe kompleksiteti, intimiteti privat dhe dimensionin publik përvijohen mes nuancash, kalimesh e sfumaturash të panumërta. Vetëm eksperiencia e spektatorit në kinema është një eksperiencë që thërret sa vetminë e atij që qëndron përballë imazheve lëvizëse, kur dritat përreth fiken e ndizet e vetmja dritë e ekranit të madh, aq edhe nevojën për të qenë pjesë e gumëzhitjes së sallës së mbushur plot me spektatorë dhe nevojës për të bashkëndarë eksperiencën që kinemaja me magjinë e saj përcjell.

Ekran i Artit këtë vit inauguron Kinemanë Republika si hapësirë të komunitetit qytetar, si hapësirë publike dhe tempull të kinematografisë. Shpresat, pritshmëritë dhe urimi ynë Ky vit shënon edicionin e tretë të punëtorisë së koordinuar nga Melisa Paci që sheh nxënësit e shkollave 9 vjeçare të dialogojnë me punën e një artisteje bashkëkohore. Këtë vit nxënësit e shkollave "Ismail Qemali" e "Miqësia", kanë punuar për një periudhë gjashtë mujore në dialog me veprën e artistes Claudia Losi dhe punimet e tyre do të shfaqen në Galerinë Oda me datë 7 në ora 17 00.

Ish Konsullata Italiane në Shkodër do mirëpresë një program të kuruar nga Ajola Xoxa me tre vepra në video të Anri Salës, Emilia Skarnulyte dhe Lek M. Gjeloshit.

Një seri bisedash e takimesh do shoqërojnë ditët e festivalit ku veçojmë prezantimin e Pavjonit shqiptar në Biennalen e Venecias me protagoniste artisten Iva Lulashi dhe kuratorin Antonio Grulli i cili do mbahet në Art House në datë 6 Qershor, ora 16 00.

Festivali Ekran i Artit mbështetet nga MEKL, Bashkia Shkodër, Istituti Italian i Kulturës, Goethe Zentrum, Fondacioni In Between Art Film, Fondacioni 17, AICS, Ambasda Italiane, Ambasada Austriake, Ambasada Suedeze, Europe House, Provinca Franceskane Shkodër, ABI Bank, Akademia Marubi Tiranë, Gjykuria Konstruktion, Qendra Rinore Arka, Harabel



Solitude and Multitude
 nga Tea Paci

Por ka një tjetër mënyrë për mua të shkoj në kinema (përtej armatosjes me diskursin e kundër-ideologjisë); duke e lënë vehten të mahnitem dyfish, nga imazhi e nga ajo që e rrethon - sikur të kisha dy trupa njëkohësisht: një trup narçiz i cili vështron, i përhumbur, në pasqyrën gëlltitëse të ekranit, dhe një tjetër trup pervers, i gatshëm të fetishizojë jo imazhin, por pikërisht atë që e tejkalon: teksturën e tingullit, sallën, terrin, masën e errët të trupave të tjerë, rrezet e dritës që hyjnë e dalin në sallën e kinemasë.

Roland Barthes, "Leaving the Movie Theater". From Phillip Lopate (ed.), *The Art of the Personal Essay*, New York: Anchor Books, 1995 *

Në këtë paragraf të shkurtër por plot tharme, Roland Barthes përkufizon eksperiencën e spektatorit në kinema si të dyzuar: i pari, një trup i zhytur në pasqyrën e ekranit, i përthithur (e hera herës i reflektuar); eksperiencia e përqëndrimit. I dyti një trup i shpërhapur, që e lë vehten të mahnitet e të zaptohet nga pjesa tjetër; eksperiencia e shpërqëndrimit mund ta quajmë, drejt asaj që ndodh jashtë kuadrin e cila përfaqësohet nga vetë salla e kinemasë.

E para është një eksperiencë e vetmuar përballë imazhit, e dyta e çon spektatorin drejt "masës së errët të trupave të tjerë"

Sepse nëse është e vërtetë se sot, salla e kinemasë përvijohet si hapësira e një vëmendjeje të privilegjuar për individin e veçuar, gati gati një strofull, për ti shpëtuar përthithjes së fluksit të fragmentuar e bulimik të imazheve e informacioneve, është po aq e vërtetë që shkojmë në kinema pikërisht për të mos qenë vetëm e për t'i parë filmat me të tjerët. Prania e tjetrit është përbrendësisht pjesë e eksperiencës kinematografike.

Në reflektimin e Barthes, pyetja e nënkuptuar duket se është: "ku jemi kur shohim një film?" Ana tjetër e kësaj pyetjeje mund të jetë: "me kë jemi kur shohim një film?"

Shkoj shpesh e vetme në kinema dhe më është dashur pak kohë ta kuptoj që ndjesia është ajo e të shkuarit në një takim të pa programuar me dikë tjetër. Nganjëherë, na bëjnë shoqëri persona të njohur, fytyra mike e të afërta, por të shumtën e herëve, ai që na rri afër është një i panjohur, me të cilin për disa minuta ose ndonjë orë, kalojmë kohën, përballë të njëjtit objekt, i cili provokon tek secili humore e reagime, qofshin ato të kundërta apo të ngjashme.

Gjatë filmit gati e harrojmë praninë e tjetrit e këtë bashkëndarje. Ftillohem shpesh vetëm në fund, kur dritat ndizen e, sikur të ishim zgjuar nga një mpirje, e gjejmë vehten në këtë komunitet të përkohshëm që ndërtohet e shprishet, jo më nën dritën e zjarrit të vatrës por të një vargëzimi imazhesh.

Vetëm, por jo të izoluar, një shumësi heterogjene, e ndalur e në të njëjtën kohë në lëvizje. Salla si një trup i gjallë, që merr frymë, imagjinon, dremitet, ëndërron.

Nganjëherë mjafton të ulesh sëbashku që të marrësh pjesë. Shikim të këndshëm!

Emmanuel Radnizky (1890-1976), i njohur me emrin Man Ray, ishte një artist modern me interesa të shumfishta, që krijoi me talent në fushën e pikturës, skulpturës dhe kinemasë, por, mbi të gjitha, ishte vepra e tij fotografike ajo që do të pushtonte botën.

I përfshirë fillimisht në grupimin artistik Dada dhe më vonë në lëvizjen surrealiste, fotografi dhe piktori amerikan ushqeu artin e tij me të dyja metodat artistike. Krijimet e tij reflektojnë botën e tij të brendshme, ai fikson çfarë sheh, çfarë mendon dhe çfarë dëshiron. I mirëpritur nga Marcel Duchamp-i, me të cilin ishte njohur që në Nju Jork, Man Ray vendoset në vitin 1921 në kryeqytetin francez dhe i bashkohet grupimit artistik surrealit. Në fakt, njohja e fotografisë si art nis me lëvizjen surrealiste dhe identifikohet me emrin e Man Ray-it, që solli një frymë të re, duke thyer normat tradicionale.

Në vështrimin artistik, për të, fotografia ishte një mjet shprehjeje për të realizuar atë që nuk mund ta bënte në pikturë. Megjithatë ai kurrë nuk pushoi së pikturuar.

Më 1921, dadisti Man Ray bëhet fotograf profesionist. Në këtë periudhë Man Ray përdorte retushin shpesh e më shpesh, madje edhe në autoportret. Përdorimi i mjeteve shtesë në lëvizjen surrealiste dhe ndryshueshmëria e këndeve të ndriçimit vërtetojnë një përpjekje artistike, ku rastësia dhe improvizimi nuk janë veçse fasadë.

Me mbërritjen në Paris, Man Ray bëhet një fotograf i modës, pastaj shumë shpejt një fotograf në modë, ku porositi në masë për të realizuar portrete e bëjnë të famshëm. Ai arrin të përdorë përvojën e efekteve speciale, kompozimet e guximshme, solarizimet që i jepnin formave efekte ireale dhe tërheqëse.

Fotografite në gjininë e modës karakterizohen nga përdorimi i një gjuhe piktoreske moderne, që është një nga prurjet madhore të fotografisë në artin e shekullit XX.

Karriera artistike e Man Ray-it në fushën e modës që e shkurtër, pothuaj 18 muaj, por i parapriu rolit vendimtar të fotografisë për të tërhequr një publik universal. Në këtë optikë, ashtu si në pikturë, modelet e tij fotografike përfitonin përmasa artistike shtesë në kontekstin e realizimeve të tyre. Në ato vite urat e bashkëpunimit mes botës së artit dhe asaj të modës po shumëfishoheshin dhe personalitetet e tilla krijuese, si Gabrielle Chanel dhe Salvador Dali, Sonia Delaunay dhe Tristan Tzara, si dhe Magritte dhe shtëpia e modës *Norine*, frymëzonin dhe realizonin projekte të përbashkëta.

Man Ray është një krijues i vërtetë novator dhe kurrë i zhytur në rrëmujë nga përdorimi i teknikës. Në kontekstin e raporteve të tij me surrealitetin, i përballur me fotografinë piktorale tashmë në grahmen e fundit, Man Ray-it nuk i mbeti zgjedhje tjetër, veçse të shpikte një stil original.

Si fotograf, Man Ray përgjithësisht nuk ka punuar me porosi nga muzetë ose galeritë, por për tregun, ku ecejaket mes eksperimentimit dhe përdorimit tregtar ishin trampolinë për thyerjen e rregullave.

Në panteonin e artistëve dhe njerëzve të famshëm të fotografuar nga Man Ray, si Marcel Duchamps, Salvatore Dali, Andrea Breton, Tristan Tzara, Max Ernst, Paul Eluard, Ernest Heminguej etj., duhen shtuar edhe njerëzit e zakonshëm të cilëve Man Ray u pëlqente portretin dhe me ta realizoi punime që ishin mjaft sfiduese nga niveli artistik.

Man Ray përfitoi shumë shpejt nga porositi në fushën e modës për t'u identifikuar me stilin e tij artistik surrealit, që përdorte me guxim armën e tij të provokimit. Ky stil i zotëruar në përsosmëri, i korrigjuar me tone të klasicizmit, i shoqëruar me një erotizëm

Në qershor të vitit 1924, tre vjet pas mbërritjes në Paris, Man Ray realizoi *Violina e Ingresit*, një nga krijimet më të shquara në historinë e fotografisë

GËZUAR DITËLINDJEN, INGRES

XHYHER CANI PH.D.

të lehtë, largohet nga funksioni komercial, për t'u përjetësuar në art. Man Ray rinovon përfundimisht fotografinë që deri atëhere kishte qenë dokumentare dhe hedh një vështrim mbi gruan ku ngjizet realiteti dhe imagjinaria.

Fotografia bëhet përfundimisht një art që e zotëron plotësisht, duke i siguruar atij një kapacitet krijimi dhe ndërtimi të imazheve, duke e bërë një mjeshtër të vërtetë ikonash fotografike.

Në qershor të vitit 1924, tre vjet pas mbërritjes në Paris, Man Ray realizoi *Violina e Ingresit*, një nga krijimet më të shquara në historinë e fotografisë dhe provë se çfarë mund të bënte surrealizmi në fotografi. Fotografia e pagëzuar *Violina e Ingresit* është padyshim vepra më e famshme dhe më e rallë e Man Ray-it që ka hyrë në imagjinatën kolektive.

Në maj të vitit 2022, vlerësimi i originalit

të kësaj fotografie nga shoqëria *Christie's*, arriti në një çmim unikal në tregun ankand të veprave të artit në Nju Jork, duke "fluturuar" në shumën 12,4 milion dollarë ose rreth 11,9 milion euro. Një rekord absolut për artistin, por gjithashtu edhe për tregun e artit, duke u ngritur në majë të shitjeve botërore të fotografisë. Një shumë marramendëse për këtë gur të çmuar të gjerdanit artistik të Man Ray-it, që u ngrit në statusin e ikonës surrealiste.

Në komunikatën e shoqërisë *Christie's*, lidhur me shitjen astronomike të negativit të fotografisë *Violina e Ingresit*, thuhet tekstualisht: "Është një nga veprat më të rëndësishme të shekullit XX. [...] Ky imazh surrealit dhe joshës është rezultat unik i një procesi në dhomën e zezë dhe i manipuluar me dorë. Rëndësia dhe ndikimi i imazhit njëkohësisht romantik, misterioz, jetësor dhe lozonjar, intrigon që prej njëqind

vjetësh. Si vepër fotografike, ajo nuk ka precedent në treg".

Për realizimin e kësaj vepre fotografike Man Ray u frymëzua posaçërisht nga dy veprat e piktorit Ingres, *La Baigneuse de Valpinçon* (1808) dhe *Le Bain Turc* (1859), ruajtur dhe ekspozuar në muzeun e Luvrit.

Në fakt, togfjalëshi popullor që shërben si titull i fotografisë sugjeron në të njëjtën kohë referencën piktorale të Jean-Auguste Ingres-it në tablotë e cituara më lart, si edhe faktin e ngjashmërisë që shpina e Kikit ka me instrumentin e violinës që simbolizon trupin e femrës. Kjo mendësi artistike pasqyrohet te të gjithë surrealitetit, saqë në numrin e parë të *Revolucionit Surrealist*, më 1924, citohet për shpjegim fraza e famshme e Charles Baudelaire-it: "Femra është qenia njerzore që projekton hijen më të madhe ose dritën më të madhe në ëndërrat tona". *Violina e Ingresit* e cila pozon në shpinë, lë të supozohet atë çfarë fsheh trupi i adhuruar i Kikit, duke zgjuar në këtë mënyrë imagjinatën tonë.

Në negativin e rallë për nga vlerat artistike është fokusuar një grua nudo, e ulur në shpinë, me kokën të kthyer nga e majta, ku shihet një pjesë nga bukuria e fytyrës, me ije të mbuluara nga një cohë e lehtë dhe një turban oriental që mbështjell flokët e saj. Trupi i saj, i zhveshur në rrafshin e pasëm, kontraston hijshëm në një ndenjësë të katrorizuar. Pjesa e poshtme e shpinës dhe të pasmet janë lënë të dukshme, edhe pse mbi to bie një lloj veshjeje që formon një kurorë rreth trupit.

Plastika e modelit të fotografuar spikat në format e saj femërore. Mbi këtë negativ artisti ka vizatuar me bojë kine *fjongot* e një instrumenti muzikor të familjes së violinës. Qëndrimi i përshatur nga gruaja e re, duart dhe këmbët e fshehura brenda vetes nuk janë pa analogji me format e instrumentit të violinës, ku *fjongot* e violinës lejojnë "shpërthimin" e valëve sonore të instrumentit. Bëhet fjalë për një artefakt të thjeshtë, një fotografi bardhë e zi, ku sfondi i fotografisë është në të zezë, ndërsa një dritë nga e djathta ndriçon shpinën, si dhe nuancon me dritë dyshemenë dhe murin. E bardha e shpinës kontraston me *fjongot* e zeza dhe me sfondin e errët të gjithë skenës.


Kjo grua nuk është një model anonim, por një personalitet i Parisit të viteve të gumëzhimit; apo siç janë thirrur në metaforë "të çmendura"; bëhet fjalë për këngëtarën dhe aktoren Kiki i Montparnasit - me emrin e saj të vërtetë, Alice Prin (1901-1953), që ishte gjithashtu në pesë vite muza dhe partnerja e fotografit. Magjepse për nga bukuria, ajo frymëzoi gjithashtu edhe artistë të tjerë të modës, si fotografin Brassai, piktorët Modigliani e Foujita, apo skulptorin Calder.

Fillimisht, ajo nuk donte të pozonte për të realizuar fotografinë. Bukuroshja Kiki dyshonte, se regjistrimi fotografik do të prodhonte një fotografi vulgare. Ajo e kishte pozuar trupin e saj me pasion dhe me talent para piktorëve dhe skulptorëve, por jo para një makine, edhe pse ajo ishte në duart e të dashurit të saj. Por këmbëngulja e Man Ray-it dhe shpjegimi i tij pse duhej të pozonte për realizimin e këtij kompozimi artistik, shprehin thelbin e kredos artistike të tij: "Jo, unë nuk fotografoj natyrën, por vizionin e saj. Unë fotografoj ashtu siç do të pikturoja, duke e transformuar subjektin, siç do të bënte një piktor. Ashtu si ai, unë idealizoj apo deformoj subjektin tim".

Violina e Ingresit ilustron besnikërisht këto fjalë, duke përcjellë te ne një fotografi mes pikturës dhe një riprodhimi mekanik.

Një tipar shënues i këtij montazhi fotografik është karakteri i tij abstrakt, ngaqë subjekti është i izoluar nga mjedis rrethues. Montazhi të jep përshpikjen se artefakti egziston pavarësisht kontekstit.

Trupi joshës i Kikit në shpinë, pozicioni i kokës i saj dhe flokët lidhur në një turban të kujtojnë gratë që lahen, të piktorit Ingres,



në dy tablotë e tij. Në sajë të vizatimit të dy fjongove, trupi femëror metamorfozohet në violinë, duke zbuluar erotizmin e gruas së re.

Trupi femëror është një nga subjektet e parapëlqyera të Man Ray-it. Gratë janë shumë të pranishme në jetën dhe veprën e tij. Duke njohur mirë surrealizmin ëndërrimtar të Rene Magritti-t apo të Joan Miro-së, Man Ray priret drejt çlirimit të nënvetëdijes në një raport tejet frojdian. Ai paraqet sensualitetin dhe ekspresionin e dëshirës njerëzore. Fotografia i jep privilegjin të tregojë një rilexim të trupit femëror, duke kapërcyer vizionin klasik. Artisti jep një perceptim modern dhe do të nxjerrë në pah jetësoren. Ai vë në skenë modelet me kompozime artistike, duke rimodeluar dritën, hijet, ngjyrat dhe kuadratet. Thjesht artisti vë në plan të parë një trup femëror, një vështrim, një gjest.

Shprehja a emërtimi *Violina e Ingresit* që është popullarizuar në shekullin XX dhe sot përdoret në kahun figurativ e ka origjinën e përdorimit në një objekt real, në violinën e portretistit të famshëm neoklasik Ingresit (Jean-Auguste Dominique Ingres) që jetoi në harkun historik të viteve 1780-1867. Artisti në fjalë, krahas penelit zotëronte me aq mjeshtëri dhe instrumentin e violinës që iu bë pasioni i tij i dytë, duke u afirmuar për disa kohë si violinë e dytë në orkestrën e Kapitolit të Tuluzës, ku luante me talent muzikën e Mozartit, Glukut, Bethovenit dhe Hajdenit.

Fillimisht e përdorur për të kumtuar vetëm aktivitetet artistike, kjo shprehje a emërtim u shtri në rrafshin semantik të përkushtimit dhe kalimit të kohës së lirë me një interes më të gjerë. Në *Larousse*, kjo shprehje përcaktohet si talent i një personi që kultivohet paralelisht me aktivitetin e tij kryesor.

Më 1924, Andre Breton-i publikon *Manifestin e surrealizmit*, ku përcakton lëvizjen artistike si "automatizëm psikik të pastër, [...] në mungesë totale të kontrollit të ushtruar nga arsyeja dhe jashtë çdo shqetësimi estetik ose moral". Surrealizmi përdori botën reale, për ta transformuar në botë imagjinare.

Artistët surrealistë u formuan duke u nisur nga shpirti i revoltës që karakterizonte avangardistët europianë të viteve 20 të shekullit të kaluar. Të dominuar nga personaliteti i Andrea Breton-it, surrealizmi fillimisht si lëvizje letrare, u shtri shpejt edhe në artet plastike, në fotografi dhe kinema.

Tentativa e ndërtimit konceptual të automatizmit psikik nga Andrea Breton-i është skicuar më së miri në veprën e Man Ray-it, ku fotografia kontribon në ndërtimin e nocionit të automatizmit si proces krijimi, ku mediumi është betejë kundër "tiranisë së logjikës", dhe ku takohet plot sens e mrekullueshmja me të përditshmen.

Fantazia vizuale e një trupi femëror,

tjetërsuar në violinë, ilustron parimin e takimit artistik të brishtë të surrealitetit. Në këtë vështrim, kjo fotografi është publikuar për herë të parë në qershor të vitit 1924 në faqet e revistës *Litterature* të surrealisteve. Më pas, Man Ray autorizoi ribotimin disa herë të ekzemplarëve të tjerë dhe fotografia pushtoi botën.

Man Ray e transformoi fotografimin e shekullit XX, duke e ngritur në nivelin e arteve të tjera, si piktura dhe skulptura. Ai gjithashtu tregoi që fotografia nuk është gjithmonë një riprodhim i thjeshtë i realitetit, por ajo që mund të japë në esencë të gjitha ëndrrat dhe të zhvendosë objektet dhe trupat në një realitet të ri.

Andre Bretoni, duke folur për Man Ray-in në *Surrealizmi dhe piktura*, shkruan se fotografia e tij është si "objekt shkëmbimi" mes shkrimit dhe botës.

Për faktin se çfarë përfaqëson vepra e tij fotografike, Man Ray do të mbetet një figurë qendrore në sagën artistike surrealiste. Imazhi ikonik i *Violinës së Ingresit* është larg imazheve banale të fotografive të grave dhe i bën homazh erotizmit femëror.

Një analizë më e detajuar e domethënies së këtij artefakti bëhet përmes një kalimi nga syri te shpirti, mbas një numri të shumtë leximesh që rrezatojnë në mënyrë intensive dhe ndryshojnë vazhdimisht sensin semiotik dhe artistik të veprës fotografike.

Askush nuk mund të konkludojë, se simbolika e *Violinës së Ingresit* është ezauruar, sepse një histori tjetër ka nisur: ajo se si ne e lexojmë dhe e interpretojmë këtë artefakt edhe pas një shekulli.

Nga një fotografi ku modelja hezitonte për ta realizuar, *Violina e Ingresit* u kthye në një univers dedikuar fantazisë erotike. Kjo kryevepër e Man Ray-it tregon forcën dhe talentin e tij për të përjetësuar magjiken. Ndaj edhe në 100 vjetorin e lindjes së saj bukurshja Kiki vazhdon të na befasojë.

Burimet e konsultuara

- Bate, David, "The Oriental signifier", *Photography & Surrealism*, London, I.B. Tauris & Co.
- Emmanuelle de l'Écotaïs et Katherine Ware, *Man Ray*, Köln, Taschen, 2004.
- Laurent Le Bon (dir.), *Chefs-d'œuvre ?*, Éditions du Centre Pompidou, Metz, 2010.
- Filippe Secuer, *Man Ray Photo Poche*, Actes Sud, Paris, mars 2005.
- Le dictionnaire *Larousse*, Paris, 2009.
- Julie Guillaud, "Le Violon d'Ingres de Man Ray", *Le Figaro*, 18 février 2022.
- Vincent Brocvielle, "Man Ray. Violon d'Ingres. Femme objet", dans *Pourquoi c'est connu ? Le fabuleux destin des chefs d'oeuvre du Centre Pompidou*, Centre Pompidou, 2020.



Nga Enver S. Morina

Vizita e datës 19 maj 2024 në fshatin Theth sikur më riktheu tek takimi i parë me 10 shkurt 2008 me albanologun gjerman Robert Elsie. Amaneti sublim i një albanologu tejkalonte nivelet "mbimalore" të natyrës. "Writing in Light" për shqiptarët. Dhe homazh!

Veprimtaria e gjerë kërkimore dhe shkencore e Robert Elsie (1950-2017) zgjerohet në detaje nga studimet mbi etnografinë, etnologjinë, antropologjinë, filologjinë e tekstit, historinë e shkrimeve, gjuhësinë, etnokulturën, letërsinë gojore dhe të shkruar, besimet, kultin dhe shkrimet e shenjta. Veçojmë: "Migjeni, Freie Verse" (1987), përkthim gjermanisht i veprës së Migjenit; "Anthology of modern Albanian poetry" (1993); "History of Albanian literature" (1995), "Histori e letërsisë shqiptare" (1997, 2001);

"Le Kanun de Lekë Dukagjini" (2001), "Der Kanun" (2004), përkthim i Kanunit; "Historical Dictionary of Albania" (2004), "Fjalori historik i Shqipërisë" (2011); "Historical Dictionary of Kosovo" (2004), "Fjalor Historik i Kosovës" (2011); "Albanian literature: a short history" (2005), "Letërsia shqipe: një histori e shkurtër" (2006); "Writing in Light Dritëshkronja" (2007); "A Passion fot Theth" (2016), "Pasioni për Thethin" (2018); "Fiset Shqiptare: Historia, shoqëria dhe kultura" (2017), "The Tribes of Albania: History, Society and Culture" (2019); "Luftërat e Ballkanit" (2018); "Bektashinjtë shqiptare: Historia dhe kultura e një rendi dervishësh në Ballkan" (2020), "The Albanian Bektashi: History and Culture of a Dervish Order in the Balkans" (2021) etj. etj.

Në mëngjezin e hershëm të së dielës copat e shiut shndrisnin fragmente e detaje të virgjërisë së ditës së shenjtë për jetë e mot! Një ujëvarë sikur mbin nga qielli dhe godet tokën e gurtë! Ujë e kristaltë rrjedhje përgjatë luginës. Majejeshkët shkëmbore e kishin ngrirë historinë mijëvjeçare. Në veri të kishës, a në jug të varrezave, Robert Elsie i liste të gjallëve indiferent e të vdekurve në kërkim!

Në varr vendosa një trëndafil ngjyrë të kuqe "të mbyllur" me kushtimin: "Z. Robert Elsie!

Të takova në çastet e veçanta që do të vinin. Në fillim të shkurtit 2008.

Faleminderit për "Dritëshkronjën" Tënde dhënë kombit shqiptar!

Nga Gllareva e Prishtina, do të vijë përherë, edhe me kolegë të tjerë!"

Shkrimi i Tij i qetë" gërmonte thellë mitologjinë shqiptare. Dhe historinë moderne të një amaneti tej kohërave. "E kanë vrrarë mësuesin!", klithet në një film shqiptar për të treguar se kumti do e ç'thur analfabetizmin e ardhmërisë. Ishin mote të tjera.

Bari i lagësht e kishte gjetur mbiemrin e mësuesit Zef! Zef Bari më rrëfeu se ambasadori i kulturës shqiptare Robert Elsie ka kërkuar të varrosset me kostumin kombëtar të zonës, dhe të përcillet me një këngë me lahutë.

Takimi i parë, me shkas me një personalitet siç ishte dr. Robert Elsie, ishte një rast i veçantë. Në hotelin "Grand" në Prishtinë, me 10 shkurt 2008, periudhën e parashpalljes së Pavarësisë së Kosovës, datën e saj. Një enciklopedi e tërë (kontributi i tij për historinë, kulturën, letërsinë dhe artin shqiptar), të lehtësonte me thjeshtësinë e tij, me praninë "me kushtin" e të rinjohurit në një bashkëbisedim "pa dorëza". Të ofronte modestinë, thjeshtësinë që e bënte edhe më madhështor, sepse albanologu i njohur në përmasa ndërkombëtare e kishte përjetuar me vite dhe do e gëzonte përherë. Vetëm pak ditë më pas kapërcimi mediatik la gjurmë të përherëshme. Që Skënder Blakaj. E kot që Letra e mbyllur drejtuar shkrimtarit Teki Dervishit! "E zeza" e gazetarisë së shtypur shqiptare në Kosovë përgatiste si uragan, shuarjen e vetvetes, vrasjen e lexuesit.

Bashkëbisedimi që miqësor. Pyetja "Gjatë njëzet viteve të fundit jeni njohur me botën shqiptare që nga viti 1978 në Shqipëri dhe një vit më vonë edhe në Kosovë, në Seminarin Ndërkombëtar të udhës dhe Letërsisë Shqiptare. Përgjatë këtyre viteve, jeni këtu edhe në ketë javë, dika të veçantë që mund të thoni?" mori përgjigje të bëftë: "Unë mund t'ju them se përgjatë njëzet viteve po e pres Pavarësinë e Kosovës. Dhe tani po e shohë se po realizohet kjo pavarësi e merituar dhe janë shumë, shumë i lumtur. Do të jem akoma më i lumtur në javën tjetër nëse shpallet Pavarësia. Kjo do të jetë një gëzim i madh për mua." Edhe sot më vjen timbri i zërit qetazi kur e pyeta në fund që "Udhëtoni sot, ta zëmë se nuk do të kthehesh ta kushtëzojmë për pesë vjet!" më është përgjigjur më të qeshur: "Ha-ha-ha-ha... Nuk e paramendoj këtë që thoni! Ha-ha-ha-ha... Jam pak i pikël-luar që nuk jam këtu për ditën e Pavarësisë së Kosovës, sepse është një gjë që e kam pritur për një kohë shumë të gjatë, kam vuajtur bashkë me Kosovën tërë kohën për të kaluarën. Dhe shoh se tani po del. Po del atë që e kemi ëndërruar të gjithë. Jam shumë i gëzuar për këtë. Dhe shpresojmë kur të vij herën tjetër, do të vij në shtetin e pavarur të Kosovës. Jam i bindur për këtë. Dhe gëzohem që tani."

Trashëgimia albanologjike e studiuar nga perspektiva e kohës moderne ka një emër, Robert Elsie. Librin album e rrallë "Dritëshkronja" me rreth 230 fotografi të hershme nga Shqipëria dhe Ballkani Jugperëndimorë e solla nga Prishtina tek varri për një vizitë kujtese. Fotografia të vitit 1863 dhe të viteve 1903-1916.

Vizitat e mia te Milan Kundera dhe gruaja e tij, Vera, u bënë të rregullta në vitin 2019, kur isha në vitin e tretë të misionit tim si ambasador çek në Francë. Ajo që filloi si telefonata të sjellshme dhe admiruese nga një diplomat për autorin më të madh të vendit të tij u zhvillua në miqësi. Por kjo mbrëmje e fund nëntori ishte e veçantë dhe unë isha po aq nervoz sa kisha qenë gjatë telefonatës time të parë para dy vitesh. U ulëm në apartamentin e tyre parizian duke biseduar, si zakonisht, për gjëra të ndryshme. Kur mendova se kishte ardhur çasti i duhur, u ngrita në këmbë dhe thashë: "Milan, e di që nuk të pëlqejnë ceremonitë, por më lër të them disa fjalë".

Pas një fjalimi të shkurtër, i dorëzova një dokument ku thuhej se Milan Kundera kishte marrë nënshkrimin e çeke. Me një buzëqeshje të butë, pak të druajtur, Kundera pohoi me kokë, duke marrë dokumentin dhe duke nënshkruar një kopje për autoritetet çeke. Në mënyrë simbolike, Kundera u kthye në atdhe atë mbrëmje, 40 vjet pasi iu hoq shtetësia dhe 30 vjet pasi Revolucionit i Kadifenjtë solli në pushtet kolegët e tij intelektualë disidentë, veçanërisht ish-mikun e tij Václav Havel, i cili shërbeu si president nga vitin 1989 deri në vitin 2003.

Pse u desh kaq shumë? A nuk kishte dashur Kundera të kthehej në atdhe? Apo çekët e kishin parapëlqyer në ekzil? Pas vitit 1989, Kunderat menduan të ndanin kohën e tyre mes Parisit, Pragës dhe Brno-s, ku kishte lindur Milani. Por kjo nuk ndodhi kurrë. Disa udhëtime incognito në Çeki, vizita të herëpashershme të miqve çekë në Paris ose në rezidencën e tij verore në Touquet, telefonata të shpeshta - por kaq ishte e gjitha. Nuk pati kthim. Pse?

Romanet e Kunderës mund të na japin disa arsye të tërthorta. Kritikët e tij mëtuhan të kenë zbuluar në to ndjenja anti-çeke. Para së gjithash, në romanet e veta ai jo vetëm që përqeshte zyrtarët komunistë, por mbante një distancë kritike nga disidentët. Për shembull, kur Tomáš-i, mjeku protagonist i "Lehtësia e papërbalueshme e qenies", refuzon të nënshkruajë një peticion në mbështetje të të burgosurve politikë, lexuesi nuk mund të mos mbajë anën e tij. Për më tepër, Kundera thuhej se ngurronte të autorizonte përkthimet çeke të librave që kishte shkruar në frëngjisht. Por kurrë nuk foli publikisht për marrëdhëniet me vendin e vet. Në fakt, nuk ka folur fare në publik.

Ishte Vera ajo që pak javë para kthimit të shtetësisë e theu këtë heshtje të gjatë me një intervistë të sinqertë. Ajo shprehu malli për atdheun e humbur, por edhe pse nuk mund të ktheheshin. Shumë lexues çekë u habitën kur mësuan se për dekada, Kundera ishte përbaluar me armiqësi e disidentëve në Pragë dhe nga të mërguarit e tjerë antikomunistë. Miqtë e Havelit ishin veçanërisht aktivë në këto sulme kundër Kunderës; vetë përfshirja e Havelit ishte e paqartë.

Kundera dhe Haveli u takuan për herë të parë në fund të viteve 1950. Kundera, një shkrimtar i ri premtues, jepte mësim në Akademinë prestigjioze të Filmit në Pragë. Haveli, shtatë vjet më i ri, i kërkoi ta këshillonte, pasi donte të hynte në akademi. Kundera u përpoq të ndihmonte Havelin, duke vepruar, sipas fjalëve të Havelit, si "agjenti" i tij. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, akademia e refuzoi Havelin, si ndëshkim për "origjinën borgjeze" - një emërtim i përdorur kundër kujtdo, prindërit e të cilit nuk ishin punëtorë apo fshatarë. Në të vërtetë, përpara komunizmit, Havelit kishin qenë ndër familjet më të pasura dhe më me ndikim në Pragë.

Takimi i parë i Kunderës dhe Havelit vendosi modelin e marrëdhënies së tyre me ulje dhe ngritje përgjatë viteve 1960. Kundera ishte pjesë e establishmentit kulturor, merrte çmime dhe admirimin e lexuesve dhe ngjallte interesin e botuesve

PSE KUNDERA NUK U KTHYE KURRË NË ATDHE

Nga Petr Drulák

ish-zëvendës ministër i Jashtëm i Republikës Çeke dhe
ambasador në Francë

Përktheu: Granit Zela

të huaj. Nga pikëpamja politike, ai ishte një rebel që kritikoihej rregullisht nga zyrtarët dogmatik dhe librat e tij duhej të prisnin vite për autorizimin zyrtar. Ndërsa braktisi idealizmin marksist të poezisë së tij të hershme, Kundera ende besonte në disa versione të socializmit. Haveli, në të kundërt, ishte një i huaj ambicioz. Ai përfitoi nga kapitali kulturor i familjes së tij, i cili i dha emër dhe i siguroi kontakte me poetë dhe intelektualë të rëndësishëm. Por Havelit trajtoheshin si armiq të klasës nga regjimi dhe rruga e tij profesionale nuk ishte e lehtë. Haveli fillimisht iu bashkua botës së teatrit si punëtor teknik i skenës. Vetëm pas liberalizimit politik të vendit u bë i njohur si dramaturg. Politika e tij ishte e përmbajtur: nuk ishte antikomunist i vendosur dhe as socialist (përveç një revolte të shkurtër kundër nënës së tij).

Disa intelektualë me *bona fides* të mirëfilltë, përfshirë Kunderën, u përpoqën të ndihmonin Havelin në rrugën e tij të vështirë. Por duke pasur parasysh ambiciet e mëdha dhe etjen për njohje, Haveli duhet të ketë ndjerë një farë zilie ndaj tyre. Ata kishin mundësi më të mëdha në media, në pozicione me ndikim në aparatit shtetëror kulturor dhe te botuesit. Megjithatë, Haveli arriti njëfarë suksesi pavarësisht pengesave me të cilat u përball. Drama e tij e vitit 1963, "Festë në kopsht", u vu në skenë jo vetëm në Pragë, por edhe në Gjermani - një arritje e konsiderueshme për një autor të ri çek në atë kohë. Por vështirë se mund të krahasohej me suksesin e Kunderës, veprat e të cilit u lexuan dhe përkthyen shumë. "Shakaja" (1967) u kthye shpejt në një tekst kult; dhe deri në vitin 1969, ishin realizuar tre filma të mbështetur në librat e tij. Kur Carlos Fuentes, Gabriel García Marquez dhe Julio Cortázar vizituan Pragën në vjeshtën e vitit 1968, ishte Kundera ai që kërkuan të takonin.

Ndoshta kjo pakënaqësi shpjegon agresivitetin me të cilën Haveli reagoi ndaj esesë së Kunderës "Fati çek", botuar në dhjetor 1968, muaj pasi pushtimi sovjetik mbylli përpjekjet për reformat demokratike të atij viti. Pa dyshim, Kundera ishte jashtëzakonisht lirik, kur fliste për "një mision të madh të kombeve të vogla" duke pretenduar se viti 1968 "i zhvendosi çekët dhe sllovakët në qendër të historisë botërore" në një mënyrë të tillë që kombi "kishte parë madhësinë e tij". Ai e kremtoi Pranverën e Pragës duke e quajtur një kontribut unik në politikën botërore, duke mëtuar se kërkimi çek për një sistem politik që respektonte lirinë dhe drejtësinë sociale


ishte me rëndësi universale dhe mund të jepte mësim të dobishme për Perëndimin. Ai kishte shpresë për jetësimin e reformave demokratike, madje edhe nën pushtimin sovjetik.

Haveli, i cili nuk u besoi kurrë reformatorëve komunistë, reagoi me një shkrim demaskues sarkastik, duke përbuzur "iluzionet patriotike vetë-admiruese, nostalgjike" të Kunderës dhe duke e akuzuar atë për "mesianizëm qesharak provincial". Ai argumentoi se reformatorët e Pragës thjesht ishin përpjekur të korrigjonin krimet e tyre të mëparshme dhe se modeli perëndimor i demokracisë liberale ishte në gjendje të pajtonte lirinë dhe drejtësinë sociale më vete, pa pasur nevojë për mësim nga komunistët. Për më tepër, Haveli hodhi poshtë çdo shpresë për vazhdimin e reformave demokratike, duke bërë thirrje për rezistencë paqësore kundër pushtimit. Kundera u përgjigj në të njëjtën mënyrë personale. Ai akuzoi Havelin për ekzibicionizëm moral, duke argumentuar se radikaliteti i propozimeve të tij mund të kënaqte nevojën e tij të kotë për udhëheqje morale, por pasojat e tyre praktike do të ishin inekzistente ose të dëmshme.

Polemika e tyre pasqyroj vijën e fajit midis intelektualëve demokratio-socialistë dhe liberal: Kundera argumentoi për një model të ri të shoqërisë që do të ishte i lirë dhe i drejtë, duke shmangur veset e kapitalizmit perëndimor dhe autoritarizmit të Europës Lindore; Haveli mbrojt kapitalizmin perëndimor si modelin e vetëm të dëshirueshëm, që kishte nevojë për rregullim, por jo rishikim të madh. Këto dallime nuk kishin rëndësi për udhëheqësit neo-stalinistë që rifituan kontrollin pas revoltës së 1968-ës; regjimi i dënoi të dy autorët si antisocialistë dhe ua ndaloi veprën.

Por psikologjia e marrëdhënies së dy shkrimtarëve u formësua nga rivaliteti i tyre profesional. Ndonëse të dy ishin të etur për njohje letrare ndërkombëtare, vetëm Kundera ngadhënjue. Haveli u njoh si luftëtar i lirisë dhe udhëheqës politik, por nuk ka hyrë kurrë në kanonin e letërsisë botërore. Megjithatë, ai ruajti ambiciet letrare dhe identitetin e tij si shkrimtar. Pasi u largua nga zyra e presidentit, Haveli shkroi një dramë të titulluar "Largimi" (që ishte mediokër) dhe drejtoi një film të mbështetur në këtë dramë (i cili ishte një dështim).

E gjithë kjo mund të shpjegojë qasjen e dyfishtë të Havelit ndaj të Kunderës. Pas polemikës së vitit 1969, ai nuk u angazhua në



asnjë sulm personal ndaj Kunderës, por nuk bëri asgjë për të shkurajuar sulme të tilla nga miqtë dhe admiruesit e tij. I fundit dhe më i egri prej tyre erdhi në vitin 2008, kur e përjavshmja çeke *Respekt* botoi një artikull ku Kundera akuzohej se kur ai ishte student në vitet 1950, kishte informuar policinë për një agjent perëndimor. Artikulli nuk nxori asnjë provë përveç thashethemeve dhe një protokollin policie ku përmendej se Kundera ishte burimi i informacionit.

Edhe pse kishte arsye për dyshime, çështja kundër Kunderës ishte mjaft e dobët. As nënshkrimi dhe as numri i identifikimit të Kunderës nuk figuronin në protokollin e policisë, gjë që asokohe ishte një procedurë standarde. Përveç kësaj, agjenti u arrestua në dhomën e ish-të dashurës së tij studente. Ishte ajo që kishte treguar për ardhjen e tij në Pragë me të dashurin e saj të atëhershëm dhe më vonë bashkëshortin, i cili dyshohet se ia kaloi këtë informacion Kunderës. Megjithatë, as vajza dhe as i dashuri i saj nuk u ndëshkuan për kontakt me agjentin, gjë që nuk pritej në atë periudhë terrori. Kundera mohoi çdo përfshirje dhe nuk doli asnjë provë e mëtejshme, por kjo histori ia njollosoi emrin, ia dëmtoi shëndetin e tij dhe të bashkëshortes dhe përjashtoi përfundimisht vizitat e tyre në Çeki.

Respekt botohej asokohe, sikurse edhe sot, nga manjati mediatik miliarder Zdeněk Bakala, i cili është miku i Havelit dhe sponsori kryesor i Bibliotekës Václav Havel. Si kryetar i bordit të *Respekt*, Havel u lajmërua për artikullin përpara botimit dhe ai shprehu dakordësinë e tij. Një javë më vonë, pasi dëmi ishte bërë, ai bëri një deklaratë ku mbështeste me gjysmë zemre Kunderën: "Mos u dëshpëro, Milan, ka gjëra më të këqija në jetë se shtypi i keq". Ai filozofoi për grackat e gjykimit të ngjarjeve të largëta historike, ndërsa i kërkoi Kunderës të mos mërzhitej nga furia mediatike që do të pasonte, e cila në mënyrë të pashmangshme do të dëmtonte reputacionin e tij.

Në Europën Qendrore, intelektualëve tradicionalisht u është caktuar një mision i veçantë. Ndryshe nga homologët e tyre perëndimorë, ata luajtën rol vendimtar në ndërtimin e kombit në shekullin e 19-të dhe pritej të kontribuonin në betejat politike të kombeve të tyre në kohët e vështira të shekullit të 20-të. Historia çeke është e pasur me shembuj të tillë: historiani František Palacký ishte një udhëheqës politik kyç në shekullin e 19-të, sociologu Tomáš G. Masaryk u bë presidenti themelues i Çekosllovakisë, shkrimtari Karel Čapek mbrojtëti demokracinë çekosllavake përpara

Luftës së Dytë Botërore dhe filozofi Jan Jan Patočka shmangu politikën gjatë gjithë jetës së e tij, vetëm për t'u bërë teoricien, zëdhënës dhe martir i Kartës 77.

Por ka edhe shumë shembuj të intelektualëve që u akuzuan për neglizhencë të misionit të tyre duke i dhënë përparësi artit mbi politikën ose duke dështuar të pasqyrojnë kombin në veprat e tyre: këtu përfshihet poeti më i madh çek i shekullit të 19-të, Karel Hynek Mácha, poezitë e të cilit kishin të bënin me dashurinë dhe vdekjen, dhe jo me virtutet çeke dhe Antonín Dvořák, muzika e të cilit u konsiderua shumë kozmopolite.

Havel, dramaturgu i kthyer në president, i përmbushi qartë pritshmëritë kombëtare, duke iu bashkuar traditës së Masaryk-ut dhe Patočka-s, por të shumtë ishin ata që e qortuan Kunderën që nuk i përmbushi këto pritshmëri. Ai jo vetëm që u largua nga vendi në vitin 1975, gjë që disa e panë si dezertim nga lufta kundër tiranisë, por edhe shprehu vazhdimisht skepticizëm për aktivitetet disidente të ish miqve të tij dhe u tha se ishte tërhequr nga çdo aktivitet politik për t'ia kushtuar jetën plotësisht letërsisë. Kundera e bëri të qartë se nuk do të shkruante letërsi të angazhuar politikisht, për të cilën kishte një opinion shumë të ulët dhe kritikët e tij nuk besonin se librat e Kunderës, plot ironi, intriga qesharake dhe marrëdhënie dashurie, përbënin ndonjë sfidë të vërtetë për regjimin.

Kjo mund të shpjegojë pse botimi i "Lehtësia e papërballueshme e qenies" pati një pritje entuziaste pothuajse kudo, por jo në qarqet opozitare çeke. Ashtu si Dvořák, Kundera shihej si kozmopolit (ky kishte qenë tashmë një nga qortimet e Havelit në vitin 1969); si ato të Mácha-s, temat e Kundera-s nuk ishin sa duhe hapur politike.

Këto qortime ishin të padrejta. Në vend që të braktiste politikën dhe të harronte atdheun dhe miqtë e tij, siç mëtonin detraktorët e tij, Kundera punoi me një koncept tjetër për politikën. Sigurisht, nuk pranoi të firmoste asnjë nga peticionet dhe deklaratat e shumta të Havelit, ndoshta ende duke dyshuar për ekzibicionimin e tij moral. Por ai ndërmoi edhe veprime praktike që i shihte si të dobishme: botoi një artikull në mbrojtje të një zëdhënësi të burgosur të Kartës 77 në *Libération*; ofroi i ndihmë financiare të pabujë për miqtë në nevojë në atdhe; dhe mbrojti nocionin e Europës Qendrore në një ese të lexuar gjerësisht të vitit 1984.

Autoritetet çeke i hoqën Kunderës nënshtetësinë pas botimit në vitin 1978 të "Libri i të qeshurës dhe harresës", i cili tallte udhëheqësin e lartë të partisë. Pavarësisht censurës zyrtare, disidentët kryesorë të vendit nuk e shihnin librin si të denjë për shumë vëmendje. Ata prisnin një vepër që shprehej më hapur dhe më të angazhuar politikisht, sesa ajo që ata e shihnin si një seri aventurash erotike. Në këtë aspekt, opozita antikomuniste çeke ishte në të njëjtën linjë me neokonservatorët amerikan: Redaktori i komenteve Norman Podhoretz shprehu zhgënjimin e tij të përmbajtur për librin në një letër të hapur drejtuar Kunderës.

Gjatë Luftës së Ftohtë, disidentët çekë dhe ata në ekzil nuk mund t'i shpëtonin lojës gjeopolitike të dy superfuqive dhe disa arritën të luanin një rol të rëndësishëm. Pavel Tigrid ishte shembulli i duhur. Ai u largua nga Çekosllovakia pas grushtit të shtetit komunist në vitin 1948. Duke filluar nga fundi i viteve 1950, jetoi në Paris si qytetar amerikan. Me financim nga qeveria amerikane, më konkretisht nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA), financoi dhe redaktoi të përmuajshmen *Svědectví* (Dëshmia), revista më e rëndësishme antikomuniste çeke në qarkullim. Nga Parisi, ai organizoi një rrjet të frikshëm të mbledhjes së informacionit dhe rekrutimit.

Qysh në mesin e viteve 1960, Tigridi u

interesua për Havelin, familja, pikëpamjet antikomuniste dhe talenti letrar i të cilit duhet t'i jenë dukur premtuese. Përfundimisht, ata u takuan në Paris në vitin 1968. Ishte fillimi i një bashkëpunimi dhe miqësie të përrjetshme. Tigridi u bë promovues i qëndrueshëm i Havelit si në Çekosllovakia ashtu edhe në Perëndim. Sipas Jaroslav Vrzala-s, bashkëpunëtor i vjetër i Tigridit dhe botuesi i *Svědectví*, karriera politike e Havelit ishte produkt i përpjekjeve të mentorit të tij, të sponsorizuara nga SHBA. Këto përpjekje dhanë rezultat në vitin 1989. Përpara Revolucionit të Kadifenjtë, Tigridi filloi të pretendonte që Haveli të bëhej presidenti çekoslovak dhe porositi postera *Havel për president*. Më pas ai u transferua në Pragë për të shërbyer si këshilltar kryesor i presidentit të ri, dhe më vonë si ministër i tij i kulturës.

Si e shikonte Tigridi Kunderën? Luftëtari i ftohtë i linjës së ashpër ka të ngjarë ta konsideronte intelektualin me mendje të pavarur, i cili nuk kishte nevojë për rrjetin e tij ose nuk pajtohej me ndarjen ideologjike të Luftës së Ftohtë, deri diku si të dyshimtë. Tigridi me gjasë nuk donte që Kundera të shihej si një zëdhënës i opozitës çeke, duke lënë në hije Havelin më të besueshëm politikisht. Ai u takua me Kunderën menjëherë pasi mbërriti në Paris në vitin 1975 dhe i ofroi këshillë miqësore për t'u larguar nga politika. Kundera e zbatoi me kënaqësi, duke mos pasur asnjë ambicie politike.

Tigridi, një operativ me përvojë i shërbimeve inteligjente dhe grumbullues i informacionit që qarkullonte midis opozitës antikomuniste çeke brenda dhe jashtë vendit, u kujdes shumë që imazhet e Havelit dhe Kunderës të qëndronin në përputhje me planet e tij politike. Prandaj, mund të imagjinohet se sa i shqetësuar ishte ai në vitin 1984, kur Kundera u katapultua në superyllin letrar global me suksesin e "Lehtësia e papërballueshme e qenies", që e bëri atë një kandidat për çmimin Nobel në Letërsi. Tigridi nuk ishte i vetmi që shqetësohej. Shumë disidentë të Pragës nuk e pëlqyen idenë. Sipas mendimit të tyre, një Nobel për Kunderën do të ishte një mospërfillje për Havelin dhe kështu një pengesë për kauzën e tyre.

Pikërisht në këtë sfond disidentët çekë i dërguan një peticion komisionit të Nobelit në mbështetje të Jaroslav Seifert-it, poetit të madh lirik, atëherë në të 80-at, i cili ishte praktikisht i panjohur jashtë Çekoslovakisë,

por që ishte ndër nënshkruesit e parë të Kartës 77. Disa nga ata që vendosën emrat e tyre në peticion më vonë u penduan, pasi nuk ishin në dijeni kur firmosën se arsyeja kryesore e tij ishte të devijonte çmimin nga Kundera. Peticioni ia arriti qëllimit. Dhënia befasuese e çmimit Nobel në vitin 1984 për Jaroslav Seifert-in ishte një fyerje për komunistët çekë, por edhe një triumf për projektin politik të Václav Havel-it.

Me përfundimin e Luftës së Ftohtë, Haveli dhe aleatët e tij u ndjenë të shfajësuar nga ngjarjet: ndryshe nga shpresat e mëparshme të Kunderës, përfundimi fitimtar nuk ishte i interesuar të diskutonte rrugët e treta midis socializmit dhe kapitalizmit, në vend të kësaj vendosi të impononte kapitalizmin liberal në të gjithë Europën Qendrore. Gjatë gjithë viteve 1990, dukej sikur Haveli e kishte kuptuar mirë në polemikën e tij kundër Kunderës më shumë se 20 vjet më parë. Një Uashington i guximshëm e vlerësoi shumë këndvështrimin pro-perëndimor të Havelit, pasi i përshtatej lehtësisht ndërhyrjeve të administratave të Klintonit dhe Bushit, nga zgjerimi i NATO-s deri te Lufta e Irakut. Nga ana tjetër, ish-disidentët e udhëhequr nga Haveli u nxorën dalëngadalë në prapaskenë nga pragmatistët ekonomik që ndërtuan kapitalizmin çek, të udhëhequr nga Václav Klaus.

Në këtë panoramë të re, Kundera ende nuk përshtatej: as moralistët e Havelit dhe as pragmatistët e Klausit nuk donin ta ftonin përsëri. Megjithatë, miqtë e përbashkët u përpoqën të pajtonin Kunderën dhe Havelin në fillim të viteve 1990. Ata patën një darkë kortezie, por të vakët në Paris. Kunderës iu dha "Nderi Shtetëror" nga Haveli, por Kundera dërgoi Verën për ta marrë ndërsa ai qëndronte në një hotel aty pranë. Artikulli në *Respekt* ishte goditja përfundimtare ndaj përpjekjeve për pajtim.

Më shumë se një dekadë më vonë, gjendja shpirtërore është e ndryshme në Çeki. Ka ende njerëz që besojnë se trashëgimia e Václav Havel-it duhet të mbrohet me çdo kusht, jo kundër Klaus-it, por kundër populizmit të lidhur me ish-presidentin Miloš Zeman, dhe me liderin e opozitës dhe ish-kryeministrin Andrej Babiš. Nga ana tjetër, pas pasojave katastrofike të ndërhyrjeve të SHBA-së jashtë vendit dhe korrupsionit dhe dështimeve të kapitalizmit çek, besimi se Haveli e kishte kuptuar mirë është më pak i përhapur se sa ishte në vitet 1990. Për më tepër, lexuesit çek tani e gjykojnë Kunderën për meritat letrare dhe


jo nisur nga kërkesat e politikës disidente, dhe atyre u pëlqen ajo që lexojnë. Librat e tij mbeten më të shiturit.

Dallimi kryesor midis Kunderës dhe Havelit është qasja ndaj humorit, një vlerë e rëndësishme çeke. Dramat e Havelit janë shpesh argëtuese pasi ekspozojnë absurditetin e botës burokratike, teknokratike dhe totalitare. Por esetë e tij janë fatalisht serioze, sepse Haveli besonte se ka një rrugëdalje nga i gjithë ky absurd: gjurmimi i së vërtetës dhe demokracia perëndimore. Ishte ky qëndrim që e bëri atë një aleat natyral të neokonservatorëve amerikanë.

E qeshura e Kunderës, krejt ndryshe, përshkoi të gjitha romanet dhe esetë e tij, duke u shfaqur gjithmonë në prani të tragjikes. E qeshura dhe tragjedia, për të, çuan përsëri në paqartësinë e pashmangshme të një bote që nuk mund të shëlbohet nga asnjë e vërtetë apo regjim politik. Por Kundera nuk iu nënshtrua nihilizmit, duke gjetur shpresë në traditat kulturore të Europës Perëndimore dhe Qendrore në veçanti, në muzikë, në artin e romanit, të hapja dhe te kthesat e papitura të historisë. E gjithë kjo e la atë të hapur ndaj ideve kundërthënëse për sa kohë që ato nuk ngurtësoheshin në dogma me të cilat nuk mund të qeshje.

Mund të përfitohet shumë nga rileximi i veprës së Kunderës, pra, më shumë sesa vetëm kënaqësinë e të lexuarit të një proze të shkëlqyer. Siguritë e bipolaritetit të vjetër SHBA-Bashkim Sovjetik janë tani larg në të kaluarën, epoka e unipolaritetit amerikan po zbehet dhe Europa Lindore është përsëri një fushë beteje gjeopolitike. Në këto kushte, ne duhet të gjejmë mënyra për të menduar përsëri për botën, duke shmangur gjatë gjithë kohës kurthin e absolutëve politikë – qoftë socializmi apo kapitalizmi, pragmatizmi ekonomik apo populizmi kombëtar – dhe duke përdorur fuqinë e ironisë kundër atyre që mëtojnë se kanë gjetur të vërtetën përfundimtare. Me pak fjalë, ne kemi nevojë ta rilexojmë Milan Kunderën.

Petr Drulák, ish-zëvendës ministër i Jashtëm i Republikës Çeke dhe ambasador në Francë, është profesor i politikës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Bohemisë Perëndimore.



Karikaturë nga Arben Mexsi

